

Alexander Giese

# Muratorët e Lirë Sot

Mënyrë e të jetuarit dhe të menduarit



radikal



Alexander Giese

Lindur me 1921. Programbërës  
i Televizionit shtetëror Austriak (ORF),  
Autor në Prozë, Lirikë,  
Film dhe Teatër; Autor i romaneve:  
„Si i huaj në Atdhe“, „Si bora në Shkretëtirë“,  
“Durojeni njëri-tjetrin vëllezër“,  
„Lerida ose hija e gjatë “. Nga 1990 deri  
1997 President i Klubit Austriak P.E.N,  
nga 1975 deri 1986 Kryemjeshtër  
i Kryelozhës së Madhe Austriake.

---

ALEXANDER GIESE

MURATORËT E LIRË SOT  
*Mënyrë e të jetuarit dhe të menduarit*

Shqipëroi dhe përshtati: Sh. Redo

Shtëpia Botuese: “Radical”

---

***Falënderime dhe mirënjohje të thellë Fondacionit  
“Lutz Huber –Stiftung”- Kryeoda e Madhe e Austrisë –  
që mundësuan përkthimin dhe botimin e këtij Libri.***

*Titulli i originalit:*

Freimaurer Heute – Lebens- und Geisteshaltung

1991 Copyright by hpt-Verlagsgesellschaft.mb.H & Co.KG.,  
Wien – Köln – Weimar

1996 Copyright by Böhlau Verlag Ges.mb.H & Co.KG.,  
Wien – Köln – Weimar

2005 Copyright by Böhlau Verlag Ges.mb.H & Co.KG.,  
Wien – Köln – Weimar

Për botimin në shqip copyright “Radical Multimedia”  
*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara*

*Redaktor: Ornela Kici*

*Perkujdesja grafike:*

**ISBN 952-54326-99-44-1**

*Botues: Saimir Gjini*

*Shtëpia Botuese MORAVA*

---

*Bëhu ai, që do të mund të ishe*

---

## PËRMBAJTJA

Parathënie

Muratoria e Lirë sot

Përse duhet Muratoria e Lirë ?

Strategjia e Muratorisë së Lirë

Inicimi. (Pranimi) Si bëhesh Murator i Lirë?

Theatrum Mundi dhe /apo Thesaurus Mundi?

Veprimet Operative të Muratorëve të Lirë

Simbolet para-verbale dhe shpjegimi i riteve të tyre

Prodhimet e Muratorisë së Lirë ose Rezultatet e

Andragogjisë së tyre

Çfarë është humaniteti e çfarë është toleranca?

Kufizimet ndaj fesë, shkencës dhe filozofisë

Gjenezat e normave të moralit

Simbolizmi Universal

Objeksione kundra Muratorisë së Lirë

Muratoria e Lirë dhe Politika, sqaruar me shembullin e

Austrisë

Veprat e Muratorëve të Lirë

Sinkretizmi si preferencë

Virtytet Muratorike

Muratoria e Lirë si mënyrë e të jetuarit e të menduarit

---

## Parathënie

Si Murator i Lirë që jam po marr përsipër që të shkruaj mbi Muratorinë e Lirë.

Nuk është qëllimi im që me këtë libër të vogël të marr rolin e një misionari, dhe njëkohësisht nuk shoh të nevojshme që të marr në mbrojtje Muratorinë e Lirë. Unë jam anëtar i kësaj Lidhjeje për gati një gjysmë shekulli, së cilës i jam jashtëzakonisht mirënjohës si në aspektin material, atë shpirtëror e intelektual. Në këtë Lidhje kam njohur miqësinë e vërtetë dhe vëllazërinë e sinqertë.

Synimi i vërtetë që i kam vënë vetes, është që të paraqes në mënyrë sa më objektive këtë degë të rëndësishme të shoqërisë sonë kulturore, dhe t'ia sjell atë sa me pranë një publiku sa më të gjerë. Në këtë libër nuk do të përmend emrat e Muratorëve të Lirë, të sqaroj vendet apo traditat e saja, por do të mundohem të karakterizoj përmbajtjen shpirtërore dhe botëkuptimin jetësor të kësaj Lidhje Burrash, e cila është e përhapur në të gjithë planetin tonë. Ekzistojnë me miliona Muratorë të Lirë dhe secili prej tyre, ka përjetimet e tij unike dhe një afërsi specifike me këtë Lidhje të pashoqe mbi këtë rruzull.

Oskar Virt (Wirth), një nga mendimtarët muratorik, arriti në përfundimin, që duke u bazuar në strukturën e saj, Muratoria e Lirë është në gjendje që të ndryshojë botën, nëse ju përmbahet principeve të saj.

Kjo është gjithashtu edhe bindja ime, sepse besoj fort, që situata në të cilën ndodhet bota sot e ka shumë te nevojshme Muratorinë e Lirë. Vëllazëria ndërmjet njerëzve, që mund të quhet edhe motëri, është sot më e nevojshme se kurrë ndonjëherë tjetër.

---

Përmbajtja e Muratorisë së Lirë si dhe veprimtaria e Muratorëve të Lirë, ka kohë që janë një „Sekret i zbuluar“.

Libra të tërë e shtjellojnë atë nga të gjitha anët. Por për një gazetar hulumtues është më interesante që të shkruajë mbi zakonet tradicionale të saj, si për shembull, mbajtja e sekretit nga anëtarët e saj, sesa të përshkruajë bërthamën e punës së tyre. Kjo e fundit nuk do të përbënte ndoshta një sensacion të vërtetë për lexuesin.

Muratoria e Lirë mundohet të trajtojë problemin kryesor që ka njerëzimi sot, domethënë bashkëjetesën e njerëzve me prejardhje të ndryshme, me arsim të ndryshëm, me fe të ndryshme dhe nga klasa e nivele jetese të ndryshme. Planeti ynë është i populluar dhe i drejtuar nga popuj dhe kultura të ndryshme.

Deri më sot nuk është bërë e mundur që të arrihet në një baraspeshë dhe të realizohet një paqe e qëndrueshme mbarëbotërore.

Muratoria e Lirë mund t'i ofrojë vetëm një ndihmesë të vogël kësaj detyre, nga e cila varet mbijetesja e njerëzimit në këtë planet. Prandaj, është e domosdoshme që përmbajtjet dhe bindjet e saja të bëhen të njohura – thënë më drejt – t'u sugjerojmë që mësimet e bindjet e saja t'i vini në zbatim në jetën e përditshme.

Në vitin 1960 u pranua ne Odën (Lozhën) „Moxart“ (Mozart), kam qenë tre herë Mjeshtër i Nderit (Mjeshtër Drejtues) i kësaj Lozhe dhe nga viti 1975 deri në vitin 1986 Kryemjeshtër i Kryeodës (Kryelozhës) së Austrisë. Gjatë këtyre viteve kam kaluar nëpër thellësitë e lartësitë që më ka sjellë profesioni im si gazetar radioje e televizori, si mësues e si shkrimtar, por ka qenë Muratoria e Lirë ajo që më ka mësuar t'i balancoj gjërat dhe të përjetoj avantazhet e një bashkësie vëllazërore. Edhe pse këto dhjetë vitet e fundit fuqia e



---

shikimit më ka lënë paksa, nuk jam i verbër ndaj kundërshtimeve që kanë të bëjnë me Muratorinë e Lirë. E them me një kënaqësi shumë të madhe, që ka qenë kjo Lidhje që i ka dhënë kuptimin më të mirë jetës time dhe ka ndihmuar shumë në zhvillimin njerëzor të saj. Bazuar në këtë që thash më sipër, ky libër mund të shikohet si testamenti im muratorik.

Me këtë rast e kam për kënaqësi që tu falënderohem shumë vëllezërve që më kanë shoqëruar gjatë gjithë rrugës sime muratorike si: Gynter Kodek (Günter Kodek), të cilin e falënderoj për rishikimin e manuskriptit të këtij libri si dhe këshillat e vyeshme që më ka dhënë. Ingrid Umek i detyrohem për redaktimin me përkushtim të lartë të këtij libri. Edhe asaj i takon falënderimi im.

Alexander Giese

---

## Muratoria e Lirë sot

Forma sotme e Muratorisë së Lirë evropiane dhe asaj amerikane, i ka rrënjët e saja në sistemet e zhvilluara në Britaninë e Madhe në vitet 1600, sisteme që u kurorëzuan me krijimin e Kryeodës<sup>1</sup> Angleze në vitin 1717. Po t'i hedhim një sy leksikoneve mbi Muratorinë e Lirë, veçanërisht atyre në hapësirat gjermanishtfolëse, siç është ai i Possner-Lennhof, shohim se ekziston një numër i madh shoqërisht muratorike. Mund të thuhet se që nga shekulli i 17-të e këtej ka pasur gjithmonë një tendencë të fortë për krijimin e shoqërive sekrete.

Arsyeja është e thjeshtkuptueshme: Qindra vjet pas Karlit të Madh, skena politike e Evropës pësoi një zhvillim në mënyrën e qeverisjes së një vendi. Baza e kësaj qeverisje ishte që secili person kishte vendin e tij të caktuar në një shoqëri sociale vazhdimisht të organizuar. Në majë të këtij organizimi social ishte perandori, ose mbreti apo prijësi. Pozicioni i peshkopëve dhe i priftërinjve ishte pothuajse në të njëjtin nivel ose ndiqte këta të parët nga pas. Një klasë e mesme e aristokracisë shtrihej në të gjithë Evropën, ndërsa klasa borgjeze ekzistonte në disa qytete të pakta dhe përmblihte zanatçinjtë dhe tregtarët. Masa e madhe e popullsisë që jetonte në fshat e kishte humbur lirinë e hershme dhe ishin kthyer në shërbëtorë të dëgjuar të zotërinjve të tyre. Hapësira për të menduar dhe vepruar ishte jashtëzakonisht e vogël. Betimi që jepej, për t'i shërbyer me devotshmëri të zotit, kufizonte në maksimum si lëvizjen e lirë të individit ashtu dhe mendimet apo veprimet e tija apo të saja. Me këto lloj veprimesh u vendos sistemi feudal në Evropë. Universitetet dhe shkollat i nënshtroheshin dhe i detyroheshin influencës së fesë

---

<sup>1</sup> Kryelozhës

---

katolike dhe asaj protestante (nga shek i 16-të). Luftërat, varfëria, uria, kolera dhe sëmundje të tjera zotëronin jetën e përditshme.

Lufta 30 vjeçare e zvogëloi popullsinë e Evropës në disa milionë njerëz, dhe jeta në këtë botë ishte e mundur vetëm për disa të përzgjedhur, ndërsa masave të popullsisë ju premtuhej parajsja në botën tjetër. Kjo është arsyeja që shpjegon, se përse një pjesë e intelektualëve të shoqërive ekzistuese, e ndjente nevojën për përmirësimin e kushteve të jetesës. Fillimi i një konflikti të hapur me klasën në fuqi ishte pothuajse i pamundur. Lëvizje revolucionare si ato të Albigenser-ve, të Katarëve, të Husitëve dështuan. Kjo situatë i hapi rrugën krijimit të „shoqërive sekrete“. Këto shoqëri nuk ishin gjë tjetër veçse pika takimi të njerëzve që mendonin, që ishin në kundërshtim me realitetin e përditshëm dhe që mblidheshin jashtë kontrollit të shtetit e të kishës për të këmbyer me njëri-tjetrin ide dhe mendime të ndryshme nga ato që predikonin ata që kishin fuqinë në dorë. Le të kujtojmë në këtë mes reformatorin e famshëm Komenius (Comenius).

Në shekullin e 18-të Evropa mbushet nga krijimi i qindra e qindra Odave, që nuk ishin gjë tjetër veçse vendtakime ku mblidheshin aristokratë, borgjezë e gjithashtu edhe klerikë për të diskutuar e hulumtuar mbi dhe për qëllimin e jetës. Këta njerëz ishin paksa në siklet sepse donin që takimet e tyre t'i legalizonin, dhe për këtë arsye filluan të kërkonin rrejtë historike të këtyre shoqatave që po rriteshin dita ditës. Sipas mendimeve të tyre, ky sistem i odave, që fillimet e tija i kish pasur në Angli, bazohej vetëm mbi fakte historike, dhe kështu ato krijuan historitë e tyre për odat (lozhat) dhe futën sistemin e posteve, të riteve e të simboleve, që drejtonte odën, dhe e bazuan të gjithë këtë sistem në shëmbëlltyra të hershme mijëvjeçare. Libri më i vjetër që ish i njohur për ta ishte Bibla, më konkretisht Dhiata e Vjetër<sup>2</sup>, ndërtimi i tempullit më të madh, atij të

---

<sup>2</sup> Testamenti i Vjetër

---

Solomonit, dhe si rrjedhojë Solomoni u quajt Kryemjeshtri i parë i njohur. Një histori e tillë, pjesë-pjesë me nuanca fantastike, u përpilua për herë të parë nga predikuesi klerik Xhejms Anderson (James Anderson) në vitin 1732 në Londër. Ky dokument ishte një material ushqyes për fantazinë e vëllezërve të odave në Evropë e në Amerikë. Në leksikat mbi Muratorinë e Lirë gjendet jo vetëm historia e Kryeodës së Anglisë, por edhe ajo mbi krijimin e obedience<sup>3</sup> të ndryshme në të gjithë botën e civilizuar, që funksiononin sipas riteve të ndryshme, punonin në shkallë (gradë) të ndryshme dhe mbi të gjitha kishin drejtime të ndryshme. Për shembull, ekzistonin oda që merreshin me alkimi e që kërkonin gurin e mençurisë, anëtarët e disa të tjerave ishin ngatërruar në mistikë, disa të tjerë merreshin me personalitete të ndryshme të historisë apo me Biblën, ose kishte nga ata që pasqyronin realitetin e shoqërive ku jetonin, si p.sh. Urdhrat kalorësiakë. Kështu në disa prej këtyre odave mund të bëheshe kalorës jo i privilegjuar, merrje tituj e grada, që më tepër ishin stoli vezulluese sesa të duheshin për diçka. Me fjalë të tjera, shoqata të tilla në të vërtetë nuk ndiqnin ndonjë qëllim të caktuar. Është e vetëkuptueshme që fuqitë legjitime, shteti dhe kisha, t'i zbulonin e t'i dënonin këto veprime subversive, t'u kundërviheshin e t'i ndalonin këto oda, dhe të ndiqnin anëtarët e tyre. Shkatërrimi më i madh i këtyre lëvizjeve të hershme muratorike ndodhi në një takim në qytetin Braunschvajg (Braunschweig) të Gjermanisë, kur „strikte Observanz“, një lidhje kalorësiake muratorike, që kish ofruar rreth vetes një numër të madh aristokratësh në këtë vend, kërkonte nga anëtarët e saj të jepnin sqarime për prejardhjen e vërtetë të Muratorisë së Lirë, të jepnin llogari për qëllimet dhe mjetet financiare të tyre. Në këtë takim „strikte Observanz“ u shpërbë. Si pasojë e këtij zhvillimi, u krijua një frymë e re që nuk lejonte mbirjen e këtyre „barishteve të egra“ nëpër të gjitha odat evropiane, që nuk ushqente fantazitë kalorësiake dhe që u përqendrua dhe mori si shembull metodat dhe mënyrën e organizimit të Muratorisë Angleze.

---

<sup>3</sup> Obedienat janë shoqëri muratorie në një region të caktuar

---

Që nga ky moment e pas kjo ishte rryma kryesore e lëvizjeve muratorike me disa krijime të vogla që morën drejtime të kundërta.

Në Muratorinë e Lirë bëhet dallimi ndërmjet dy drejtimeve aktuale të kundërta:

- Kryeodat apo Obedienat, që janë të pranuar nga *United Grand Lodge of England* dhe që kanë si bazë pune të ashtuquajturat „*Basic Principles*“, dhe si rrjedhojë quhen “të rregullta”. Këto Kryeoda përpunojnë tre shkallët e Muratorisë së Shën Gjonit të cilat janë: Nxënësi, Zejtari dhe Mjeshtri. Kushtet paraprake për njohjen e një Kryeode nga UGLE ndër të tjera janë: themelimi i rregullt i saj, pranimi i “Mjeshtrit të Madh të Ndërtimit të të gjitha Botëve”, përdorimi i “tri dritave të mëdha<sup>4</sup>”, ndalimi i diskutimeve politike e fetare, përmbajtja e principeve masonike<sup>5</sup> dhe së fundmi pranimi vetëm i burrave në këtë lidhje.
- Kryeodat apo Obedienat, që nuk ju përmbahen „*Basic Principles*“, dhe si rrjedhojë nuk janë të pranuar nga Muratoria e Lirë “e rregullt” ose që iu është tërhequr njohja sepse kanë devijuar nga principet bazë të kësaj Lidhje. Si rrjedhojë, këto Kryeoda quhen “jo të rregullta” (irregular). Pjesë e këtyre Kryeodave, të cilat e quajnë veten “Kryeoda Liberale” janë ndër të tjera Grand Orient de France, Urdhëri Internacional i Co-Muratorëve për burra e gra “Le Droit Humain”, Kryeoda e përbashkët për burra e gra “Humanitas” e shumë të tjera.

---

<sup>4</sup> Tri dritat e mëdha të Muratorisë së Lirë janë libri i ligjeve të shenjtja, goneja dhe kompas

<sup>5</sup> Në anglisht: Masonic Landmarks

---

Në Muratorinë e Lirë “të rregullt” pas përfundimit të tre shkallëve të para ekziston mundësia për të vazhduar me sistemin e shkallëve (gradëve) të larta që njihen edhe me emrin shkallët e diturisë, arritja e të cilave nuk është domosdoshmëri dhe qëllim i Muratorisë së Lirë. Dy sistemet më të njohura janë:

- ”Riti i vjetër dhe i pranuar Skocez” (4-33 shkallë, nga ku gjithashtu shkallët 1-3 ekzistojnë si shkallë skoceze)
- ”Riti i York-ut” me “Royal Arch” (4-7 shkallë), me “Koncilin” (8-9 shkallë) dhe “Komturei” (10-12 shkallë)

Përveç këtyre sistemeve ekzistojnë edhe sisteme të tjera “të rregullta” që janë të përhapura në vendet Skandinave, që janë të orientuara në sisteme kristiane, sisteme me të cilat punojnë edhe odat e njërës prej Kryeodave Gjermane.

Çfarë funksioni luan Muratoria e Lirë në shoqëritë moderne, çfarë pozicioni ka marrë ajo në këto shoqëri? Duke u bazuar tek rregullat e një Muratorie “të rregullt” e “të pranuar” na bëhet e qartë që diskutimet mbi fenë dhe politikën nuk mund të çojnë në krijimin e një mendimi të unifikuar e të mëvetësishëm. Pra, nuk është e domosdoshme që të rikthejmë vazhdimisht në vëmendje “Detyrimet e Vjetra”, të cilat ia ndalojnë një Muratori debatet në odë mbi fenë e politikën, sepse hapësira e odës për një Murator është një hapësirë ku dogmat nuk kanë vend dhe secili anëtar i ka mundësitë për të krijuar bindjet dhe qëllimet e tij të lira. Si rrjedhojë, nuk është e mundur që të ketë një mendim të përbashkët mbi çështjet politike e fetare. Profanëve (njerëzit që nuk janë anëtarë të një ode, pra që nuk janë Muratorë të Lirë) ju duket kjo si një dobësi, sepse përgjithësisht njerëzit janë të mendimit, që fuqia e njerëzimit qëndron në atë, që bashkimi i njerëzve me bindje të përbashkëta rezulton në krijimin e një uniteti të fuqishëm politik.

---

Një lidhje si kjo e Muratorëve të Lirë, e cila ka bërë të mundur bashkimin në odë të njerëzve me emër e me nam të mirë, pa i vënë rëndësi të madhe, pasjes së një mendimi të përbashkët për bindje apo pyetje të ndryshme, duket në jetën e përditshme si një fenomen i pakuptimtë ose e thënë ndryshe diçka jo praktike. Ky sistem i të punuarit duhet të shikohet si nga partitë politike ashtu edhe nga grupimet e ndryshme fetare si diçka shumë pozitive, ata vetëm mund të përfitojnë nga ky rast, në të vërtetë kjo është një ndihmë e madhe për to. Të habit fakti që nganjëherë ndodh e kundërta, e si politikanët edhe njerëzit e fesë besojnë që Muratoria e Lirë përbën një rrezik për to. E vërteta është, që Kryeodat e botës nuk janë aktive as në politikë dhe as në fe. E vërtetë është gjithashtu, që një Murator i Lirë me paraqitjen dhe sjelljen e tij, me karakterin e tij është në kundërshtim të plotë me fundamentalizmat, fanatizmat apo me egoizmat partiak, dhe si rrjedhojë shikohet si armik nga disa politikanë apo fanatikë fetarë. Muratori i Lirë nuk është as fanatik dhe as fundamentalist. Tendenca e tij, të cilën ai e fiton në odë, është që ambientin që e rrethon atë ta krijojë sa më human, sa më njerëzor që të jetë e mundur dhe të jetë tolerant e të sillet me respekt ndaj të tjerëve. Një botëkuptim të tillë e kanë të pamundur si sistemet politike njëpartiake ashtu edhe bashkësitë e ndryshme fetare që besojnë e janë të bindur që vetëm ata janë të shenjtë mbi këtë tokë. Pjesa më e madhe e grupimeve të ndryshme sociale në shoqërinë tonë janë të mendimit, që për të qenë më të fortë e për të qenë të bashkuar, duhet të ketë përkufizime ndaj grupimeve të tjera. Për njerëz e grupime të tilla, është e pakuptimtë, që ekziston një institucion, që edhe pse secili anëtar i këtij institucioni ka mendimin e vet, ky megjithatë e ndjen veten si pjesë e kësaj bashkësie. Muratoria e Lirë duke u bazuar në këtë ndjenjë të përbrendshme mund të shikohet si një udhërrëfyes, si një mundësi se si njerëzit mund të jetojnë në një botë, e cila nuk duhet të polarizohet nga antagonizmat dhe kundërshtimet dhe të mos jetë vazhdimisht burim i armiqësive të reja. Atyre që janë jashtë kësaj lidhje, do të thotë

---

profanëve, u duket e pakuptimtë që për Muratorin e Lirë, krijimi i armiqësive të tilla është i padëshirueshëm, dhe ai përpiqet që fenomene të tilla t'i largojë nga jeta e tij. Në lidhje me shoqërinë në përgjithësi, Muratoria e Lirë mundohet që të krijojë një teren të përshtatshëm ku të mbizotërojnë humaniteti, toleranca dhe respekti, por nga ana tjetër ajo edhe individit në veçanti i ofron pafundësisht shumë.

Për Kërkuesit<sup>6</sup>, që i ka vënë vetes si qëllim të bëhet Murator të Lirë, nuk përbën ndonjë ndryshim të madh se në cilën Obedience do të pranohen. Qëllimi i të gjithë Muratorëve është të përhapin humanitetin, tolerancën dhe respektin, dhe këto si brenda ashtu dhe jashtë odave. Secili e ka në dorë, se në ç'masë ka dëshirë të futet në materien e transcendencës.

---

<sup>6</sup> Kërkuesit janë ata të cilët kanë shfaqur interesimin t'i bashkangjiten Muratorisë së Lirë



---

## Përse duhet Muratoria e Lirë ?

Ju jeni lexues i një gazete ditore, ju mund të keni abonuar një revistë politike aktuale, ju ndiqni me vëmendje të madhe lajmet në media e televizione. Ne varësi të moshës që keni, mund të jeni në shkollim e sipër, i punësuar diku apo i keni mbyllur vitet e punës dhe jeni në pension. Bota në të cilën jetoni, ju duket sikur herë pas here (jo përherë) ka nevojë për përmirësim. Ka momente në jetë, kur secili nga ne mendon, që mund të ishte një njeri krejtësisht tjetër. Mund të keni pasur ose mund të keni probleme në fushën profesionale, me partnerin tuaj, me miq e shokë, mund të keni qenë e mund të jeni të pakënaqur me gjendjen aktuale në të cilën ndodhet shoqëria, politika ju duket e pafuqishme të menaxhojë situatat e vendit ku jetoni, krimet e terrorit e të luftës ju janë bërë të padurueshme.

Megjithatë ju jeni të detyruar, që të mbijetoni në këtë labirint të pafundmë dhe jo vetëm të mbijetoni, por edhe të ndërmerri vendimet e duhura në kohën e duhur. Gjithashtu, keni arritur në përfundimin që as një njeri nuk mund të jetojë i vetëm, secili prej nesh, në një mënyrë apo tjetër, ka nevojë për mbështetjen e dikujt tjetër, sepse i vetëm nuk do të jetë në gjendje që të lëvizë diçka në këtë jetë, dhe në princip nuk do të jetë në gjendje as t'i japë formën e duhur jetës së tij. Në botën tonë mbizotërojnë dy lloje tendencash:

Ne vlerësojmë individualitetin tonë<sup>7</sup>, por njëkohësisht jemi të detyruar dhe e kemi të domosdoshëm bashkëpunimin me njëri-tjetrin. I bie që këto të dyja, individualiteti dhe bashkëpunimi me të tjerët, të jenë në një marrëdhënie “tërhiq e mos e këput”. Ne kemi nevojë për ndihmën e të tjerëve, por nga ana tjetër distancohemi sa më shpesh që të jetë e mundur. Le të kthehemi pak prapa dhe të rikujtojmë

---

<sup>7</sup> qëllimi më i lartë i njerëzve të këtij planeti është krijimi i personalitetit

---

edukimin tonë, që tashmë e kemi shijuar<sup>8</sup>, dhe do të arrijmë në një përfundim shumë interesant: Sado që personat që e kanë pasur për detyrë dhe janë marrë me edukimin tonë<sup>9</sup>, mund të kenë qenë liberalë, të dashur e me një botëkuptim të hapur, shpeshherë, dhe kjo tek shumica e njerëzve, na është dukur sikur jemi nën zgjedhën e tyre e s'po na lejojnë që të bëjmë jetën tonë ashtu siç e dëshirojmë. Këtë lloj zgjedhe të të tjerëve dashje pa dashje e kemi bërë pjesë tonën, pra e kemi përvetësuar, dhe tentojmë vazhdimisht që në rastet apo momentet e duhura ta vëmë në zbatim. Mund ta marrim si të qenë, se që në kohët e lashta, njerëzit gjithmonë kanë tentuar që të arrijnë pavarësinë e tyre, duke zotëruar fuqi ndaj të tjerëve dhe duke i sunduar ata. Njëkohësisht, ne njerëzit e dimë dhe jemi të bindur, edhe këtë që nga lashtësia, që vetëm me dhunë e me forcë nuk është e mundur që të ndërtohet jetën tënde, por të nevojshme janë gjithashtu edhe bashkëjetesa, marrëdhëniet e mira me njerëzit e tjerë, mënjanimi i dhunës, dhe duke i zbatuar këto do të shikojmë që do të arrijmë përmirësimin dhe përsosjen e vetvetes. Vetëm duke menduar kështu, mund të arrijmë që të jetojmë një jetë në harmoni të plotë me mjedisin që na rrethon. Ndoshta nuk e teproj po ta them, por kam bindjen që një dëshirë për një jetë të tillë, ndodhet e fshehur në secilin nga ne. Po bëj edhe një hap më tutje: dëshira për të arritur përsosjen duhet të jetë një ligj themeltar jo vetëm brenda nesh, por në të gjithë ambientin që na rrethon. Segmente të tëra të shkencave natyrore e atyre sociale dëshmojnë tendenca të ngjashme kur merren me fenomenin e përshtatjes dhe seleksionimit natyror. Qëllimi i përmirësimit tonë duhet të jetë prodhimi i harmonisë kudo që jemi, një lloj gjendje, që nuk arrihet shumë shpejt, por që është e mundur duke ndjekur hap pas hapi rrugën nga një disnivel i paqëndrueshëm në një baraspeshë të qëndrueshme.

---

<sup>8</sup> Durimin që kanë treguar të tjerët me ne, dhimbjet dhe mundin që ju kemi shkaktuar atyre, përpjekjet e vazhdueshme që kanë ndërmarrë për të na bërë të aftë për jetën

<sup>9</sup> prindërit, shkolla, rrethi familjar e ai shoqëror etj.

---

Çfarë kanë të gjitha këto të bëjnë me pyetjen tonë: Përse na duhet Muratoria e Lirë?

Historia na ka treguar që si marrëdhëniet personale dhe ato shoqërore, kanë pasur gjithmonë nevojë për përmirësime. Popuj e shtete të ndryshme gjithmonë janë munduar që të krijojnë një botë sa më të mirë. Mjeti më i suksesshëm që nga lashtësia dhe deri në ditët tona, mjeti më efektiv dhe njëkohësisht më vdekjeprurës, ka qenë dhuna (lufta). Ka 300 vjet e këtej që nga përhapja e idesë, që për çdo qenie njerëzore duhet të ekzistojnë të drejtat themeltare, të drejtat e njeriut, që garantojnë ekzistencën dhe të drejtën për të jetuar. Këto të drejta u kodifikuat për herë të parë në vitin 1776 dhe u bënë gur themeli i pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Deklarata e të Drejtave të Njeriut është një fanar ndriçues për historinë e njerëzimit. Për herë të parë individi, fati dhe liria e tij, ndodhen në qendër të interesave politike. Shumica e atyre që përpiluan dhe nënshkruan Deklaratën e të Drejtave të Njeriut ishin Muratorë të Lirë. Edhe sikur kjo të ishte vepra e vetme që Muratorët e Lirë kanë bërë, do të ishte e mjaftueshme të përlligjej prania e tyre në këtë botë. Në të vërtetë, veprat e tyre janë të pafundme, dhe ky është dhe qëllimi i këtij libri të vogël, që të dëshmojë dhe të nxisë këdo që dëshiron të sqarohet mbi këtë institucion unik human, mbi këtë Lidhje burrash, që respekton me përpikëri etikën njerëzore.

Ju mund ta kundërshtoni këtë që u tha më sipër duke argumentuar se u desh shumë kohë nga nënshkrimi i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut në 1776, e deri sa këto të drejta u bënë realitet në politikë. Ju mund të kundërshtoni dukë thënë që në disa pjesë të globit, këto të drejta nuk njihen e nuk respektohen ende. Por veçantia e tyre qëndron në faktin, që pas shumë pak shekujsh ato janë të njohura, të pranuar, të fiksuara dhe të gjithë popujt duan që t'i

---

arrijnë. Kjo i ka bërë ato që t'i ndryshojnë fytyrën historisë së kësaj bote.

Historia e deritashme ka qenë të gjithë në luftë kundra njëritjetrit, shtypje, shkatërrim dhe eliminim të armikut dhe e gjitha kjo ka rezultuar, që herë pas here popuj dhe shtete të ndryshme janë munduar të zotërojnë të tjerët, gjë që dhe ja kanë arritur. Që nga periudha aksiale, do të thotë që nga shek. 5-të para Krishtit, kanë dalë herë pas here personalitete të mëdha si, udhëheqës, profetë, themelues religjionesh, të cilët patën arritur të zbulojnë parimet e natyrës njerëzore dhe që u munduan që këto parime t'i vënë në themel të shoqërive që krijuan. Që të bëhej e mundur përhapja e këtyre parimeve të moralit, këta njerëz qenë të detyruar që të përkufizoheshin ndaj grupimeve të tjera dhe si rrjedhojë ranë në grackën fatale që, parimet bazë të besimit t'i bashkonin me traditat e tyre të të jetuarit, dhe këto rregulla e ligje t'i quanin të vlefshme vetëm për veten e tyre. Religjionet e mëdha, të cilat kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e njerëzimit dhe që kanë një rëndësi të veçantë, janë nga ana tjetër pengesa më e madhe për një bashkim vëllazëror, ku të gjithë banorët e këtij planeti të jenë të barabartë.

Muratoria e Lirë është e bazuar në njohjen reciproke të ndërsjellët, në respektimin e traditave e zakoneve të të gjithë njerëzve, por nga ana tjetër nuk i njeh dogmat, është kategorikisht kundër urrejtjes raciale e asaj klasore dhe punon vazhdimisht për të ndërtuar – për ta thënë me gjuhën muratorike – “Tempullin e dashurisë së përgjithshme njerëzore”. Përhapja dhe vënia në zbatim e të Drejtave të Njeriut, të cilat nga viti 1776 e këtej janë rinovuar disa herë, është bërë tashmë qëllimi kryesor i shumë partive e shteteve. Përhapja e këtyre të drejtave akoma nuk është bërë e mundur që të realizohet në të gjithë rruzullin tokësor. Ka mungesë altruizmi, ka mungesë tolerance, ka mungesë humaniteti, ka mungesë respekti. Qëllimi i përhapjes dhe i vënies në zbatim i të drejtave të njeriut në

---

mbarë globin, mund t'u duket disave si diçka e paarritshme, si diçka utopike, por, po të vihet si qëllim për tu arritur, do të jetë vetëm çështje kohe deri sa kjo forcë pozitive sociale të arrijë qëllimin që bart në vete.

Bazuar në këto që u thanë më sipër do të na duhet të sqarojmë dy pyetje kryesore. E para: Çfarë strategjie po ndjekin Muratorët e Lirë për t'ia arritur këtij qëllimi dhe e dyta: Çfarë mundësish vepruese kanë ato në dispozicion, për ta realizuar këtë qëllim?

Përpara se të merremi me këto dy pyetje është mirë që të sqarohet që Lidhja e Muratorëve të Lirë ka lindur në botën perëndimore, është rritur në hapësirat fetare hebreje-kristiane dhe kjo jo vetëm në mënyrën afirmative, por dhe në atë kontradiktore nuk është ndjerë e nuk është parë as si fe e as si sekt, as si filozofi e as si shkencë, por si një mënyrë e të menduarit e të jetuarit, e mbështetur në elementet themeltare të etikës natyrale si: e vërteta, mirësia dhe bukuria, elemente të cilave Muratorët e Lirë e ndjejnë veten të obliguar t'ju përmbahen.

Qëllimi është se si të mundësohet krijimi i një harmonie sa më të madhe të mundshme. Natyrisht edhe Muratorët e Lirë e dinë që e keqja, ligësia, inati, urrejtja, sëmundjet dhe vdekja janë kundërshtarët e përpjekjeve të tyre, por vendimtare është që Muratoria e Lirë nuk mbështetet në mënyrën e të menduarit polar, manikeist (që vetëm ato e dinë dhe e zotërojnë të vërtetën), por ama mbështetet fort në mundësinë e harmonizimit të *Coincidentia oppositorum* (unifikimit të opozitave).

---

## Strategjia e Muratorisë së Lirë

Çdo lloj shoqërie burrash gjykohet në bazë të parametrave të ndryshëm. Në qoftë se këtë shoqëri e shikon nga jashtë, e ke shumë te kollajtë që të flasësh keq për të e ta quash atë një lloj klike, por ama me një farë sigurie duhet pranuar, që nga brenda kjo është një shoqëri kompakte. Në strukturën bazë të Muratorisë së Lirë dallohet ngjashmëria me klubet angleze, si për shembull, fakti që jo çdo kush mund të pranohet, edhe pse një nga tezat e tyre pohon, që ajo është e hapur për të gjithë njerëzit. Kundërshtarët e Muratorisë së Lirë, shpifin ndaj kësaj Lidhje të përhapur në të gjitha kontinentet, duke e akuzuar atë që ka dorë në të gjitha aktivitetet qofshin ato të natyrës politike apo të asaj ekonomike. Shpeshherë kësaj Lidhjeje i janë veshur teori konspirative nga më të ndryshme dhe është bërë përgjegjëse për atentate e krime të pasqaruara. Akoma më e përhapur është mendimi që Muratorët e Lirë në mënyrë të padukshme dhe të panjohur përzihen në politikën e përditshme të një vendi.

Komunistët dhe nacional-socialistët ishin të bindur që lëvizja muratorike mbarëbotërore drejtohej nga një celulë e vetme sekrete. Veçanërisht, nacional-socialistët ishin shumë të paqartë sa i përket materies së Muratorisë të Lirë, dhe e quanin atë një grupim të dëmshëm për shoqërinë.

Hainrih Himler (Heinrich Himmler) SS – Reichsführer, pasi i ndaloj dhe i mbylli të gjitha Odat e Gjermanisë, dhe me vonë gjatë luftës në Evropë, i mblodhi në një vend të vetëm të gjitha bibliotekat dhe protokollat e këtyre Odave. Përveç këtyre ai urdhëroi që t'i sillleshin edhe të gjitha orënditë që gjendeshin nëpër këto Oda. Hainrih Himler ishte zaptuar i tëri nga ethet për të zbuluar “sekretin” e kësaj Lidhjeje Vëllazërore, i motivuar nga kjo ide: Për të ishte e pakuptueshme fryma që i mbante të bashkuar Muratorët me njëri tjetrin, ai shpresonte që të zbulonte sekretin e tyre, dhe këtë fuqi që

---

ato zotëronin ta shfrytëzonte për skuadrat e tij të SS-ve. Natyrisht, Himler nuk arriti ta kuptonte, që këtu kishte të bënte me forca krejt të ndryshme nga ato që ai dëshironte t'i përdorte.

Muratoria e Lirë nuk jeton dot në inkubatorët e të vet-deklaruarve udhëheqës dhe nuk ju detyron anëtarëve të saj asnjë lloj botëkuptimi të parapërgatitur në ndonjë laborator partiak apo fetar. Meqë po flasim për strategji, atëherë bëhet fjalë për një strategji të një shoqërie të hapur, ku si model mbarëbotëror merret Oda Muratorike<sup>10</sup>, ku muratori parapërgatitet për punët në jetën e përditshme, një parapërgatitje që secili e ka në dorë vetë që ta bëjë. Strategjia – që ta themi dhe njëherë – qëndron në mënyrën e punës që nëpërmjet riteve dhe simboleve të krijosh një terren të përshtatshëm edukimi, ku secili anëtar përgatitet për jetën e përditshme, apo për jetën profane siç quhet ndryshe nga Muratorët e Lirë. Shumë nga Muratorët janë të mendimit, që brenda çdo njeriu ekzistojnë normat morale, norma që jo domosdoshmërisht duhet të jenë të lidhura me një konfesion të caktuar. Por që në këtë rast na shfaqet një lloj fenomeni i dykuptimtë që nuk mund ta anashkalojmë kollaj. Një pjesë jo e vogël e vëllezërve Muratorë, sidomos atyre të shkallëve të larta, mundohen, që njerëzve, që punojnë në lozhat e tyre, t'u sjellin sa më pranë përjetime transcendentiale, ndjeshmërinë ndaj vullnetit hyjnor apo ide të teorisë së monoteizmit. Një vëzhgues neutral mund të mendojë që kishat kristiane në një mënyrë indirekte të pa dokumentuar askund, ushtrojnë suksesshëm ndikimin e tyre mbi Muratorinë e Lirë. Por ky vëzhgues gabohet. Është një dëshmi e vërtetuar, që gjithashtu edhe Muratoria e Lirë mundëson ndjeshmërinë ndaj vullnetit hyjnor.

Muratoria humaniste, që përpunon vetëm tre shkallët e para, nuk merret shumë me problemet metafizike, që në Muratori njihen me emrin ezoterikë. Sipas kësaj Muratoria ndahet në dy rryma

---

<sup>10</sup> Tempulli i punës së Muratorëve të Lirë

---

kryesore: Muratoria humaniste e cila ka si strategji të përcjellë Muratorin në tre shkallët e para, t'i mësojë atij të kërkojë kuptimin e jetës, të arrijë qëllimet në jetë, ose të paktën ta udhëheqë atë në rrugën drejt perfeksionimit. Shkallët e larta – veçanërisht ato të Ritit Skocez – nuk mjaftohen vetëm me ato që u përmedën më sipër e me punën e pavarur mendore të një Muratori, por ky rit sjell energjikisht në lojë në shkallët e tija, jo vetëm arsyen metafizike (logos, zot), por mundohet të ankorojë personalitetin e Muratorit në kozmos. Nga këto që u thanë më sipër shihet qartë, që Muratoria e Lirë ka lindur dhe është rritur në rrethet e kulturave hebreje-kristiane, që ka marrë disa gjëra nga traditat dhe misteret e lashtësisë, por që ka kufizuar qenien e saj si me konfesionet e ndryshme që mbizotërohen nga dogmat, ashtu edhe nga sektet të çfarëdo lloji qofshin ato.

Ne kemi të bëjmë në këtë rast me një fenomen kulturor, që normat bazë të morali të paraqitura në Bibël, Kuran, Tora apo në çfarëdo lloj libri tjetër fetar e filozofik, jo vetëm që i njeh e i pranon, por edhe i vënë në zbatim në jetën e përditshme. Nga ana tjetër nuk është e gatshme t'i nënshtrohet burokracisë e hierarkisë administrative e dogmave të çfarëdo lloji bashkësie fetare që mund të ekzistojë.

Pikërisht ka qenë kjo afërsi, e shprehur në botëkuptimet shpirtërore, intelektuale e emocionale që ka krijuar, kohë pas kohe, një armiqësi vëllazërore, ndërmjet Muratorisë së Lirë dhe bashkësive të ndryshme fetare në të kaluarën. Liria, e cila zhvillohet dhe është pjesë e jetës shpirtërore të një Muratori, bie ndesh me krijesat dogmatike të feve. Si strategjia e Muratorisë humanitare ashtu edhe ajo e shkallëve të larta, janë të bazuara në vullnet, në ndërgjegje, në përgjegjësinë personale si dhe në mos-kufizimin e shkencës, gjithmonë kur kjo zhvillohet brenda kornizës së të pranueshmes e normave etike e morale. Pra, bëhet fjalë për strategji përparimtare të hapura, që nuk kanë si qëllim të krijojnë kundërshtarë, të bëjnë punë



---

misionare apo për të luftuar dikë. Ndër të gjitha shoqëritë e burrave që ekzistojnë, Muratorët e Lirë janë të vetmet krijesa sociale, që nuk mund të krahasohen me asnjë grupim tjetër.

Është e vërtetë që qëllimi i Muratorisë së Lirë është komploti, por bëhet gjithmonë fjalë për një komplot për të mirën. Meqë brenda secilit njeri banon dëshira për të mirën, për të vërtetën dhe për të bukurën, atëherë nuk përbën ndonjë problem që këto të arrihen nëpërmjet konspiracionit, me të cilat individit do të ndërtojë tempullin e pashoq të vetvetes. Muratorët e Lirë e shikojnë të gjithë njerëzimin si një familje të vetme. Çdo njeri e ka të drejtën që të marrë pjesën e lirisë e të fatit që i takon.

Vëzhguesi skeptik do të jetë i mendimit, që qëllimet që u përmendën më sipër nuk mund të jenë gjë tjetër veçse utopizma, që nuk kanë aspak të bëjnë me zhvillimet e deritanishme të historisë njerëzore dhe që nuk kanë aspak të bëjnë me gjendjen aktuale të shoqërive ku jetojmë, ku duken qartë anët negative që venë në pikëpyetje ekzistencën tonë mbi këtë planet. Pyetja mbi praninë e të keqes në këtë botë nuk anashkalohe dhe nuk injorohet aspak nga Muratorët e Lirë. Muratori i Lirë duhet të përvetësojë aftësinë, që ligësisë e të keqes t'i kundërpërgjigjet me mirësinë, të vërtetën e të bukurën, dhe këto tre të fundit t'i ketë si fanar ndriçues në rrugën e jetës së tij. Se si mund t'ja arrijë ai kësaj, kjo është punë e tij. Ai duhet të jetë në gjendje, që mendimet e kundërta apo armiqësore të mos i marrë si të mirëqena dhe njëkohësisht të jetë në gjendje të kuptojë larminë e mendimeve, ideve e pozicioneve jo të njëjta me ato të tijat, dhe të mos lejojë që nga kjo larmi idesh e mendimesh të lindin konflikte a armiqësi. Dhe së fundmi ai do të vijë në përfundimin, që ajo qenie e paarritshme hyjnore që ne e quajmë Zot, që ajo fuqi mbinatyrore, ajo arsye metafizike universale që ne nuk jemi në gjendje ta identifikojmë, jeton gjithashtu edhe brenda secilit nga ne.

---

Përmbledhurazi: Strategjia Muratorike udhëzon drejt një jete humane, një jete të denjë për njeriun. Kjo jetë duhet t'i japi atij atë ndjenjë, që ekzistenca e tij në këtë botë është gjithashtu pjesë e universit kozmik.

Nga këto që u thanë deri më tani vetëkuptohet, që Muratoria e Lirë në ndërgjegjen e saj kolektive është në mbrojtje të të drejtave të njeriut, dhe prerazi e vendosur kundër racizmit, luftës klasore dhe armiqësive fetare. Për Muratorinë e Lirë lufta nuk është gjë tjetër veçse fundi i njerëzimit.

Qëllimi i Muratorëve të Lirë është të mësojnë sesi të jetojnë e sesi të ndahen nga kjo botë. Gëte (Goethe) e ka formuluar më bindshëm këtë gjë në rreshtat e tij:

Përderisa nuk e ke akoma  
Vdekjen dhe ringjalljen në kokë  
Je veçse një mysafir në koma  
Mbi këtë të errëtën tokë.

---

## Pranimi

### Si të bëhesh Murator i Lirë?

Secili është i përshtatshëm të bëhet Murator i Lirë, përderisa është i gatshëm, ta ndjejë veten të detyruar për të respektuar normat e moralit absolut. Kërkuesi, që në disa raste mund të jetë edhe i Kërkuar (ai që nuk kërkon vetë për tu pranuar në Lidhje, por që dikush tjetër mund t'ia sugjerojë këtë), përjetimin kryesor të shkallës së parë e përjeton kur hyn në tempull. Nëse ai me të vërtetë përzgjedhet – dhe kjo përzgjedhje ndodh pasi tre vëllezër ta kenë intervistuar atë, dhe t'ju kenë bërë me dije anëtarëve të tjerë të Odës vendimin e tyre – atëherë bashkësia vëllazërore e shikon këtë Kërkues si të përshtatshëm për tu bërë Murator i Lirë, dhe pas kësaj organizohet një ceremoni festive për hyrjen e tij në tempull.

Sipas traditës së vjetër, që mjerisht, nga disa Kryeoda nuk ndiqet më me përpikëri të madhe, atij i lidhen sytë, është gjysmë i veshur e gjysmë i zhveshur, që do të thotë me pantallona ku njëra këmbë është e përveshur deri mbi gju, një bluzë të hollë me gjoksin jashtë, me një këpucë të mbathur dhe me një litar rreth qafës. Ai nuk mban asnjë lloj metali<sup>11</sup> apo para me vete. Të gjitha këto janë gjëra që duken nga jashtë, sepse në të vërtetë ajo që është më e rëndësishmja, është përjetimi i brendshëm që ai përjeton. Përpara se ai të trokasë në derën e tempullit, për të hyrë në të, do t'i duhet të kalojë disa kohë në Dhomën e Errët<sup>12</sup>, ku gjenden një kafkë dhe një orë rëre. Ne këtë dhomë Kërkuesi mediton për jetën e tij të deritanishme dhe ju përgjigjet pyetjeve që i janë shtruar. Pas kësaj Kërkuesi futet në Tempull, dhe ngaqë nuk shikon dhe vetëm pak dëgjon, ai shoqërohet nga një vëlla Murator i cili e mban Kërkuesin të kapur tek dy krahët, dhe e drejton atë nëpër Tempull gjatë tri

---

<sup>11</sup> varëse, unazë etj

<sup>12</sup> Chambre des reflexions

---

udhëtimeve që bëhen aty. Kërkuesit këto udhëtime brenda për brenda tempullit i krijojnë përshtypjen që ai po lëviz në formën e një rrethi, por në të vërtetë ai lëviz në formën e një drejtkëndëshi.

Shpeshherë ceremonia e pranimit është fotografuar, është përshkruar dhe është filmuar. Në muzetë muratorikë në Londër, Paris, Bayreuth dhe Rosenau janë të paraqitura jo vetëm orenditë e Odave Masonike, por edhe veshje të Muratorëve e disa simbole që mund t'i vizitojë çdokush që ka dëshirë.

Të gjitha këto sende të paraqitura nuk ta japin aspak përjetimin e vërtetë të Muratorisë së Lirë. Nga Kërkuesi kërkohen të dihen interesat e tij dhe njëkohësisht atij i sqarohet se çfarë e pret atë në këtë Lidhje. Oda, që ka vendosur për pranimin e këtij Kërkuesi, nuk është gjë tjetër veçse një Lidhje etike-humanitare. Gjatë ceremonisë së pranimit, ku Kërkuesi i ka sytë akoma të lidhur, i bëhet atij me dije që duhet të ndjekë rregullat dhe ligjet e Odës e të Kryeodës, të mos shkëputet nga Oda pa pasur arsye të forta, dhe njëkohësisht betohet që në të ardhmen çdo Murator të Lirë do ta pranojë e respektojë si vëlla të tijin. Njerëz, që Kërkuesi s'i ka parë e njohur asnjëherë në jetën e tij i premtojnë, që tani e tutje do të jenë përjetë miq e shokë të tij. Ai pranohet si një vëlla, me të drejta të barabarta me të gjithë ata që ndodhen në tempull. Pasi mbarojnë dialogjet festivë ndërmjet Neofitit<sup>13</sup> dhe vëllazërisë muratorike, akoma ekziston mundësia, që pas gjitha atyre që ai ka dëgjuar nga kjo vëllazëri, të tërhiqet nga pranimi i tij. Kërkuesit i sqarohet që Muratoria e Lirë nuk ka asnjë lloj sekreti tjetër përveç simboleve dhe shenjave të njohjes së saj. Akoma sytë e Kërkuesit janë të lidhur, pra ai akoma gjendet në errësirë. Më pas ai betohet që do t'i përmbahet këtij betimi, dhe për ta vërtetuar këtë, betimin e bën duke vendosur dorën e tij mbi Bibël, Kuran apo Tora, varësisht se cilës fe i përket ai.

---

<sup>13</sup> nga latinishtja, bimë e porsambjellë, në rastin konkret vëlla i sapo pranuar

---

Dalëngadalë ka ardhur momenti, që Kërkuesit t'i hiqet perçja pjesërisht. Përballë tij ndodhen vëllezër me shpata në duar. Shpatat i kanë të gjithë te drejtuara nga Kërkuesi, akt ky me të cilin simbolizojnë që ato do të jenë gjithmonë të gatshëm ta mbrojnë këtë vëlla të ri, deri në atë pikë që ua lejon nderi dhe morali i tyre. E gjitha kjo ndodh gjatë kohës që Kërkuesit i është hequr perçja<sup>14</sup> pjesërisht dhe ai e ka mundësinë që ta ndjekë këtë aksion, që ndryshe mund të quhet “dhënia e dritës së vogël”.

Pas kësaj i jepet “drita e madhe”. Në këtë moment i hiqet perçja komplet dhe vëllai i ri i sapo pranuar shikon një tempull të ndriçuar, dhe rreth rrotull tij një numër të madh vëllezërisht, që kanë krijuar një zinxhir duke lidhur duart me njëri tjetrin. Ai që deri më tani ishte Kërkues, tani e tutje është një vëlla i ri, një hallkë e re e këtij zinxhiri vëllazëror. Kjo që u sqarua në këto rreshta, me siguri që nuk është e gjithë ceremonia e pranimit, dhe nga ana tjetër kjo ceremoni në Oda të ndryshme nëpër botë mund të ndryshojë me variacione të vogla. Por, duhet thënë se që të gjitha format e Muratorisë së Lirë, i japin rëndësi shumë të madhe ceremonisë së pranimit. Ritualit, që përdoret në këtë rast, mund të ketë ndryshime të vogla, në varësi të vendit, gjuhës apo kulturës së vendit ku zhvillohet. Bërthama e kësaj ngjarje është gjithmonë e njëjtë, dhe shpjegon në mënyrë impresionuese, rrugën e një burri nga errësira në dritë. Drita është simboli kryesor i Muratorisë së Lirë, po njëkohësisht mund të thuhet që përjetimet dhe emocionet shpirtërore nëpër të cilat ka kaluar vëllai i ri, i krijojnë atij përshtypjen e një drite tjetër, dritës së miqësisë e të vëllazërisë.

Dielli, që të gjitha qeniet në këtë planet i falënderojnë jetën atij, shkëlqen gjithashtu si një simbol në krye të Odës mbi gjithë Odën.

---

<sup>14</sup> perçja është në rastin konkret një copë e zezë me dy shtresa njëra mbi tjetrën që i lidh sytë. Kur thuhet pjesërisht mendohet që hiqet vetëm shtresa e parë.

---

Një parantezë e shkurtër: Që nga lashtësia, ceremonitë e pranimeve, kanë qenë të njohura ndër fise e popuj të ndryshëm, por mosha e njerëzve që pranoheshin, në shumicën e rasteve ishte kur ata ishin në moshën e pubertetit dhe me këtë rast si vajzat ashtu edhe djemtë ngriheshin në nivelin e gruas e të burrit, pra quheshin të rritur. Në kohët e mëvonshme, ceremoni të tilla pranimi nuk i përjetonin më vetëm ata që ndodheshin në moshën e pubertetit, por u fillua që t’iu ofrohen edhe të rriturve kur pranoheshin në ndonjë lidhje mistike apo shoqëri të këtij lloji. Shoqëritë mistike të antikës, që ishin të shpërndara nga Mesopotamia, nëpër Egjipt e deri në Greqi, paraqisnin më së miri nevojën e njerëzve të pjekur në mendime e veprime për të kuptuar më mirë jetën e tyre si dhe për t’i zbuluar si kuptimin e kësaj bote ashtu dhe të botës tjetër. Këto shoqëri mistike të antikës harmonizonin polaritetet e shumëllojshme si dhe përvojat e ndryshme jetësore të njerëzve. Kjo arrihej duke ju përmbajtur riteve, të cilat kishin si qëllim demonstrimin dhe shpjegimin e simboleve të shenjta. Pjesa më e madhe e këtyre shoqërive mistike ju premtonte njerëzve jetë te pafundme, rilindje, fat dhe liri.

Për ato, për të cilën në jetën e përditshme kishte me shumë nevojë, dhe që historia mijëra vjeçare e kish treguar që s’kishte mundur t’i arrinte, pra për paqen dhe harmoninë, këto shoqëri mistike i ofronin disi ose të paktën ngjallnin shpresa, që do të arriheshin në një perandori të përjetshme. Në qendër të punës të këtyre shoqatave mistike ishte shpjegimi i sekreteve nga një zot ose një perëndi ose nga ndonjë hierofant<sup>15</sup>. Në këto hapësira i përkushtohej një vëmendje e madhe gjuhës e veçanërisht simboleve, të cilat e japin efektin e tyre më mirë se gjuha, gjithashtu luhej muzikë, bëheshin surpriza e përjetime të frikshme.

Njerëz me një botëkuptim të lartë, njerëz racionalë si për shembull Ciceroni ishin pagëzuar nëpër shoqëri të tilla dhe ju ishin

---

<sup>15</sup> nga greqishtja, zbulues i sekreteve të shenjta, prift i lartë

---

shumë mirënjohës këtyre shoqërive për përjetimet e larta harmonike që ju kishin mundësuar. Kishte një kusht, që të gjithë anëtarët e këtyre shoqërive ishin të shtrënguar e të detyruar që ta mbanin: Ai deri në fund të jetës së tij duhej të mbante sekret, procesin, simbolet si dhe ritualin e kësaj shoqërie. Është për tu vlerësuar serioziteti me të cilin u mbajtën të fshehura të gjitha këto ceremoni e rite gjatë periudhës antike. Falënderimet ju takojnë hulumtuesve të shkencave fetare, që na kanë ofruar një pasqyrë të ngjarjeve e ndodhive gjatë kësaj periudhe. Të gjitha këto zbulime kishin dy përbërës kryesorë: ritin dhe simbolin. Ritet më të njohura të antikës janë ato të Eleusis<sup>16</sup> (Elefsina) dhe të Samothrakit<sup>17</sup>.

Me këto i jemi ofruar disa shpjegimeve jo aq të parëndësishme, pra me mënyrat se si mund të komunikohen përmbajtje të rëndësishme. Ne, që në shoqëritë tona kemi si bazë komunikimin me njëri tjetrin, jemi mësuar që nëpërmjet rrugëve e mundësive sa më të shkurtra e më të shpejta – të paktën në forma verbale – të dërgojmë e të marrim masa të mëdha informacionesh e faktesh. Ky këmbim informacionesh e faktesh, nuk ka garanci në vetvete, që a u kuptua më të vërtet nga ai tjetri, a u morr seriozisht nga ai, dhe së fundmi a u arrit me të vërtetë qëllimi final i mesazhit që bart në vetvete ky lloj komunikimi. Përbërja e informacionit nuk garanton efektin e parashikuar. Fjalët dhe gjuha duket që si kanë bindur plotësisht paraardhësit tanë, edhe ato e kanë kuptuar, që çdo përjetim i ri, çdo përvojë e shpjeguar me fjalë kuptohet shumë më mirë kur është e lidhur apo e shpjeguar me sa më shumë emocione e sa më shumë sensacione. Përjetimet e reja duhet t'i adresohen jo vetëm mendjes por edhe shpirtit, dhe të mbeten të rrënjosura në trurin tonë. Edhe neuronet e trurit tonë këmbajnë me njëri-tjetrin mesazhe që pasqyrojnë botën tonë të ndjenjave. Këto procese psikike,

---

<sup>16</sup> vend në Greqinë e sotme

<sup>17</sup> Shih fusnotën e mësipërme

---

shfrytëzohen më së miri nga shtypi sensacional, ritet fetare, organizatorët e festave të ndryshme apo nga organizimet partiake.

Në kohën që jetojmë dhe që e kemi bazuar në fenomene të komunikimit gjuhësor, fjala dhe gjuha janë shpesh burim i mosmarrëveshjeve e i keqkuptimeve që ndodhin. Kjo vjen edhe si rrjedhojë që me përdorimin vazhdimisht në rritje të gjuhës, përherë e më shumë kemi harruar përdorimin e simboleve universale, që paraqesin gjithë natyrën tonë, e cila ka nevojë të shikohet, të zbulohet e të kuptohet.



---

## Theatrum Mundi dhe/apo Thesaurus Mundi?

Vëllai i ri i sapo pranuar është pak si i ç'orientuar nga të gjitha ato përshtypje e përjetime që sapo kaloi. E gjen veten në një vend që ndriçohet nga qirinj, shikon një grup të madh burrash që e rrethojnë, e që të gjithë duan të jenë vëllezërit e tij, që kanë vënë nga një përparëse përpara dhe që kanë të varur në qafë nga një medaljon. Atij i shpjegohet se si të sillet në Odë, një lloj discipline e veçantë kërkohet prej tij, i shpjegohet si të lëvizë, si të ngrihet e si të ulet brenda në tempull, pozicionin që duhet t'i mbajë duart të cilat duhet të formojnë një kënd të drejtë me këmbët, dhe mbi të gjitha një fjali e shkurtër i rrënjoset mirë në mendje: "Njih vetveten."

Vëllait të ri i jepet një përparëse e bardhë, një medaljon për ta varur në qafë, një palë doreza të bardha dhe një trëndafil, të cilin duhet t'ia dhurojë asaj gruaje që e ka më të përzemërt. Ceremonia e pranimit ka zgjatur rreth një orë e gjysmë, vëllai i ri është i lodhur, i impresionuar, por nuk e din akoma, që pas shumë e shumë vitesh për pranimin e tij do të thotë: "Ai ka qenë momenti i rilindjes time."

Për nder të tij shtrohet një darkë pas punës (tavolina e harmonisë), ku dhe ngrihen dolli të ndryshme – një dolli për atdheun, një për Kryeodën, për gratë dhe artistët si dhe për vëllanë e ri. Pas dollisë për të, vëllai i ri ngrihet dhe mban një fjalim të shkurtër falënderues. Nga të gjitha këto ngjarje, vëllai i ri, është të paktën i impresionuar e shpirtërisht i emocionuar. Por, ai akoma nuk e din se çfarë ka bërë dhe ku është përfshirë. Ai ka njëfarë sigurie në vetvete që ka bërë shumë shokë e miq në këtë mes, por nuk mund t'i imagjinojë gjërat që i thuhet, gjëra që i tregojnë atij rrugën drejt individualitetit të tij, ose e thënë ndryshe: rrugën e mënyrën për të punuar me vetveten.

---

Për çka dhe për çfarë punojnë Muratorët e Lirë? Sipas intensitetit më të cilin ai e ka filluar këtë punë, do të kalojë të paktën një vit, që ai ta kuptojë se ku ndodhet e çfarë rruge i ka hyrë. Prej tij pritet që të jetë një burrë i matur, një burrë me nam të mirë, një burrë që i ka hyrë një rruge, rrugë që deri më tani se kish shkelur kurrë.

Në mes të Odës ndodhet i shtruar një qilim, ku në tre cepat e tij janë te vendosura nga një kolonë në majën e secilës ndodhet një shandan me një qiri. Vëllait të ri i shpjegohet që këto tri drita quhen dritat e vogla dhe që e para simbolizon mençurinë, e dyta fuqinë dhe e treta bukurinë. Atij këto gjëra i duken të lashta e të panjohura. Besimin do ta fitojë kur të kuptojë domethënien që është e lidhur me secilin prej tyre. Në të vërtetë ato janë një kërkesë dhe nxitje e trefishtë:

1. Ta njohësh vetveten
2. Ta zotërosh vetveten
3. Ta përsosësh vetveten

Këto nuk janë gjë tjetër veçse pjesë të normave të moralit e të etikës që për herë të parë mund t'i ketë dëgjuar edhe në shkollë, në kishë apo në xhami. Ai akoma nuk e ka të qartë që këto norma janë bazamenti i të gjithë botës, e cila është tejprtej e përshkuar nga logjika hyjnore, logjikë që përshkon gjithashtu të gjitha marrëdhëniet tona e që është e rrënjësuar tek ne që kur kemi lindur dhe sipas të gjitha gjasave është shkaku dhe qëllimi i të qenit tonë njeri.

Tri fjalitë “njih vetveten”, “zotëro vetveten”, dhe “përsos vetveten” duhet t'i bëjnë atij të qartë, që tempulli në të cilin ai ka hyrë, është një thesar i vërtetë – dhe kjo e thënë në kuptimin më të lartë të fjalës. Dalëngadalë ai do të zbulojë, që gjithë mençuria dhe zgjuarsia e paraardhësve tanë nga Mesdheu e nga gjithë Evropa,

---

rigjendet në këtë tempull. Atij do t'i kujtohet që gjatë ceremonisë së pranimit, ju shpjegua që tempulli simbolikisht shtrihet mbi të gjithë rruzullin tokësor, nga lindja në perëndim, nga veriu në jug, dhe arrin deri në qendër të tokës, nga nadiri deri në zenit<sup>18</sup>. Këto përkufizime atëherë i janë dukur si të ekzagjeruara. Sa më shpesh që ai do ta vizitojë Odën, aq më shumë do t'i qartësohet prezenca e simboleve në të.

Përpara karriges së Mjeshtrit të Nderuar<sup>19</sup> gjendet një altar, mbi të cilin janë të vendosura librat e shenjtë<sup>20</sup>, goneja dhe një kompas. Në një shpjegim të parë që i jepet vëllait të ri, ai kupton që arsyeja se përse ndodhen librat e shenjtë në një Odë Muratorike është, sepse për Muratorët e Lirë këto libra simbolizojnë trashëgiminë e traditave e zakoneve të shenjta të njerëzimit, dhe që njëkohësisht është një traditë e madhe që ruhet akoma sot e kësaj dite. Në Odat ku përdoret Bibla, ajo hapet në faqen ku fillon kapitulli mbi Gjonin evangjelist, dhe mbi të vihen goneja dhe kompasit në një pozicion të caktuar. Ky është hapi i parë i futjes së vëllait të ri në thellësi të simbolit Bibël, sepse ai aty lexon: “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi!” Këtu ai fillon të kuptojë domethënien e falës Greke “Logos”.

Siç u përmend edhe më sipër mbi altarin e Odave të ndryshme gjenden libra të ndryshëm, Kurani, shkrimet e Budës, Veda e hinduistëve apo thjesht një libër me faqe të pashkruara. Në mënyrë të pashmangshme, vetëm nga prania e këtyre librave në Odë, vëllai i ri do fillojë të merret me mënyrën e tij të perceptimit të Zotit. Do të mbështetet vetëm tek besimi naiv që ka pasur si fëmijë? Do të marrë në konsideratë edhe njohuritë e zbuluara nga shkencat natyrore, të cilat mbrojnë tezën e një shumëllojshmërie universesh? Si e

---

<sup>18</sup> koordinata vertikale gjeografike

<sup>19</sup> Mjeshtri që drejton Odën

<sup>20</sup> Bibla, Kurani dhe Tora, ose vetëm njëra nga këto

---

imagjinon ai Zotin? Çfarë është Zoti për të? Një fjalë? Simboli i një fjale, si çdo fjalë që simbolizon një fakt, që ne vetëm mund përshkruajmë, por që nuk mund ta kuptojmë?

Kompasi do të tërheqë gjithashtu vëmendjen e tij. Mjeshtri Përgatitës ndoshta do t'ia shpjegojë që kompas simbolizon rrethin, atë rreth që ai ka krijuar me vëllezërit e tij. Duke u futur sa me thellë në kuptimin e simboleve ai do të kujtohet që rrethi simbolizon gjithashtu përsosmërinë. Po t'i hedhë një shikim gonesë, formën e saj do ta lidhë me simbolikën e të qenit i drejtë në jetë, i saktë, i sinqertë e të ketë dashuri ndaj drejtësisë. Atij i është, thënë që këto tri sende libri i shenjtë, goneja dhe kompas, janë *tri* dritat e mëdha.

Në të vërtetë ato janë objekte – megjithatë me famë botërore – një libër, një gone prej druri dhe një kompas prej tunxhi. Një trekëndësh prej druri ju shërben nxënësve në klasë për të vizatuar figurat gjeometrike. Një trekëndësh prej llamarine nuk më lejon që të shkoj më tej në trafikun rrugor. Një trekëndësh mbi altarin e lartë të kishës simbolizon trininë. Një kuptim më të lartë se ky i fundit nuk besoj se mund ta arrijë një trekëndësh. Por trekëndëshi në filozofinë e Hegelit mund të nënkuptojë trehapëshin e tij të famshëm, që nga teza dhe antiteza formohet sinteza, dialektika.

Papritur, vëllai ynë i ri që ne e quajmë nxënës, është futur nëpër shtresat e ndryshme kulturore të Thesaurum Mundi-t tonë. Hap pas hapi ai ka filluar që vlerat e kulturës sonë, që tashmë simbolikisht i shikon para vetes, ose t'i zbulojë nga e para ose t'i risjellë përsëri në vëmendje. Ai prek problemet që kanë të bëjnë me besimin, ato që kanë të bëjnë me filozofinë, me formimin e karakterit, dhe sa më shumë që merret me këto tema, aq më shumë i bëhet e qartë, që Muratoria në të cilën ai punon, nuk është as fe, as filozofi, as sekt, por është një institucion i veçantë, që ia lejon atij, të zhvillojë mënyrën e vet të pavarur të të jetuarit e të të menduarit. Në këto

---

momente ai ka kuptuar se çfarë do të thotë në Muratori fjala “i lirë”<sup>21</sup>. Meqë tani i ka hyrë rrugës së vetedukimit, vëllai i ri, do ta përjetojë këtë udhëtim në dy lloj mënyrash. Në këtë rrugë ai tashmë ndjen flladin e lirisë e pavarësisë personale dhe medoemos kjo ndjenjë e bën të lumtur atë. Lexuesit të kuptueshëm nuk ka nevojë që t’i tërheqim vëmendjen e t’i sqarojmë, që këtu bëhet fjalë për rrugën dhe veprimtarinë e një njeriu që e shikon përjetimin e simboleve si një përjetim **vetëm të tijin** dhe jo domosdoshmërisht duhet të jetë edhe përjetimi tipik edhe për miliona Muratorë të tjerë në këtë botë.

Shpjegimet dhe sqarimet që ju sapo i përjetuat duke lexuar këto rreshta, dhe që tregojnë deri në një farë mënyre pranimin e një Kërkuesi në Muratorinë e Lirë, nuk do të thotë, që në këtë rast një Murator i Lirë po e tradhton këtë Lidhje duke nxjerrë sheshit sekretet e saja. Siç e kam përmendur edhe njëherë më përpara në këtë libër, ekzistojnë një numër i madh dokumentesh, librash e filmash, që përshkruajnë apo paraqesin skenat që u treguan në këto dy kapituj. Që në mesin e shek. të 18-të, një farë Samuel Prichard pat publikuar disa shkrime<sup>22</sup> që njihem me emrin “shkrimet e tradhtarit”, që do të thotë, që ai edhe pse nuk qe vetë Murator i Lirë, arriti të “zbulojë” të fshehtat e kësaj Lidhje. Pak a shumë ai përdori mënyrat e punës të një gazetari hulumtues.

Por Muratori i Lirë e din shumë mirë, që Muratoria e Lirë e tij nuk mund të tradhtohet, por që të kuptohet më mirë, ajo vetëm përjetohet. Pra, ato që u thanë më sipër janë vetëm shpjegime nënkuptuese të mbresave, që vetëm një Muratori të Lirë i përjeton.

---

<sup>21</sup> sigurisht që kjo fjalë mund të ketë edhe kuptime të tjera

<sup>22</sup> Masonry dissected

---

## Veprimet Operative të Muratorëve të Lirë

Qëllimin që vëllai i ri mori përsipër gjatë ceremonisë së pranimit, do ta arrijë në tre hapa. Muratoria e Lirë ka tri shkallë që çdo Murator duhet të kalojë nëpër to, shkallën e nxënësit, shkallën e zejtarit dhe së fundmi shkallën e mjeshtrit. Nga emrat e shkallëve të mësipërme duket qartë, që sistemi i punës që është marrë për këtë Lidhje, është i njëjtë me strukturën e sistemin e funksionimit të brigadave të artizanatit. Jeta jonë gjithashtu kalon nëpër shkallë apo gjendje të ndryshme. Por, jo vetëm jeta jonë i kalon këto shkallë si fëmijëria, rinia e të qenit i rritur. Edhe natyra pa jetë, ajo fizike, kalon vazhdimisht nga një gjendje në tjetrën.

Nxënësi, i cili ndodhet në shkallën e parë të Muratorisë së Lirë, ka përjetuar një shumëllojshmëri përshtypjesh, të cilat dalëngadalë fillon që t'i gjykojë në veten e tij. Sfida, që ai me ngulm dëshiron që ta arrijë, është ajo, që propagandohet në dritën e parë të tri dritave të vogla.

Ky simbol, që në vetvete është një simbol drite, e paralajmëron atë që të njohë vetveten. Kjo lloj sfide, na është e njohur që në kohët e lashta, pasi Sokrati e kërkonte këtë, ndërsa Platoni fliste rreth saj. Çfarë do të thotë ta njohësh vetveten?

Sigurisht që ky si vëlla i ri do të mendojë rreth vendit të tij në këtë jetë, në çfarë pozicioni ndodhet ai, dhe po të merret pak me filozofi, do ta pyesë veten, nga ka ardhur e ku po shkon. Do të mësojë që ai në të njëjtën kohë është, si subjekt ashtu edhe objekt. Simbolet, të cilat janë të vendosura në vende të ndryshme në Odë, janë për të akoma të huaja, akoma të pakuptueshme. Këto simbole do t'ia shpjegojë atij Mjeshtri Përgatitës, siç mund të jenë domethëniet mbi gurin e pagdhundur, çekiçin me majë, diellin, e shumë e shumë të tjera, e që në fillim këto shpjegime verbale do t'i duken vetëm si

---

një informacion mendërisht i kuptueshëm, por emocionet e lidhura me këto simbole dhe kuptimin transcendent të tyre do ta përvetësojë dalëngadalë.

Në këtë vëllazëri, nxënësi në shkallën e parë e ndjen një përkujdesje të madhe ndaj tij nga vëllezërit e tjerë, dhe njëkohësisht vëren që në Odë ekziston një lloj hierarkie. Ai vëren që Mjeshtri i Nderit është edhe drejtuesi i Odës dhe që gjatë punës, asnjëri nuk e ka të drejtën ta kundërshtojë. Për të ngritur sa më shumë efektivitetin në punë, Mjeshtri i Nderit ndihmohet nga dy ndihmësit e tij, që janë Mbikëqyrësi i Parë dhe Mbikëqyrësi i Dytë, të cilët gjithashtu si Mjeshtri i Nderit mbajnë nga një çekiç ne dorë. Vendi i nxënësit në Odë është në pjesën veriore të saj. Ky është vendi që i është caktuar atij.

Në pamje të parë të krijohet përshtypja që këtu kemi të bëjmë me një disiplinë shumë të rreptë, nxënësi, brenda në Odë duhet të lëvizë sipas një rregulli të përcaktuar dhe në momente të caktuara duhet të marrë qëndrime që i kemi sqaruar më parë në këtë libër. Në të njëjtën kohë, atij i krijohet përshtypja, që si lëvizjet dhe qëndrimet e tija ashtu edhe ato të vëllezërve të tjerë, bëhen në mënyrë vullnetare dhe hierarkia e sqaruar më sipër nuk është gjë tjetër veçse një vetë-imponim i thellë simbolik i realitetit harmonik që mbizotëron jetën e brendshme të Odës. Gjithashtu është e rëndësishme që të përmendet që zyrtarët e Odës (Mjeshtri i Nderit, Mbikëqyrësi i Parë dhe Mbikëqyrësi i Dytë, e të tjerë), zgjidhen në mënyrë demokratike.

Nxënësi mëson të kuptojë që pa rregull brenda Odës nuk është e mundur të arrihet liria. Rregull pa liri quhet diktaturë, liri pa rregull quhet kaos.

Në parim, nga vëllai i ri nuk kërkohet gjë tjetër veçse të mësojë se si të gjejë vendin e tij dhe të bëhet pjesë e kësaj bashkësie të re,

---

dhe njëkohësisht këshillohet që të mënjanojë sistematikisht paragrykimet dhe agresionet që mund të ketë. Gjithashtu është e mundur që kjo mënyrë sjellje të jetë një ngarkesë për vëllanë e ri që ndodhet në shkallën e parë, e në rastin më ekstrem të jetë e papranueshme. Në këtë rast, duke filluar nga Mjeshtri Përgatitës, garantuesi<sup>23</sup> e të gjithë vëllezërit e tjerë të kësaj Ode, mund të thuhet që kanë dështuar. Sepse ajo që një nxënës duhet të përjetojë në shkallën e parë është, ndjenja e të qenit me fat, që i është dhënë mundësia të jetë me njerëz që i beson, që i vlerëson e që i respekton si vëllezërit e tij. Që në shkallën e parë Oda duhet të jetë për të si vendlindja e tij, si shtëpia ku është rritur. Do të ishte gabim në qoftë se ai do ta shikonte Odën si një klub, si një lokal apo si një vend për të kaluar kohën e lirë.

Në fund të kohës së tij si nxënës, që zgjat rreth një vit, vëllait të ri do t'i duhet që të mbajë një referat. Në Muratorinë e Shën Gjonit, leksione të tilla janë zemra e ritualit. Në këtë referat muratorik, nxënësi ose mund të flasë mbi veten dhe jetën e tij ose mbi eksperiencat e tij të deritanishme dhe përvojën që ai ka fituar që nga momenti që u bë pjesë e kësaj Lidhje. Mbikëqyrësi i Parë, pasi e dëgjon këtë leksion vendos se a është i gatshëm ky nxënës që të ngrihet në shkallën e dytë. Përveç këtij për këtë vendim duhet të jenë dakord të gjithë vëllezërit e Odës.

Çfarë rezultatesh ka pasur ai gjatë këtij viti? Brenda kontekstit të vëllazërisë ai ka fituar njohuri, në një mënyrë të re për të, mënyrë e bazuar kryesisht në mbresa e përjetime. Kjo është një nga format e mënyrat më të lashta për të fituar njohuritë.

Në brigadat e ndërtimit të Mesjetës ka pasur përpos nxënësve dhe zejtarëve edhe mjeshtrë katedralesh, të cilët me punëtorët e këtyre brigadave ndërtonin katedrale shpeshherë deri në fund të jetës

---

<sup>23</sup> vëllai apo muratori që ka garantuar për këtë nxënës



---

së tyre. Njohuritë që fitoheshin gjatë punës nëpër këto brigada, ishin njohuri empirike, që mund të fitoheshin vetëm nëpër shoqëri e vende të tilla ndërtimi dhe askund tjetër. Kjo brigadë ndërtimi, më saktë mjeshtrit dhe zejtarët e saj, zotëronin njohuri tepër të vlefshme e të veçanta, e përpara se këto njohuri t'ia jepnin një të riu, i bënëin atij shumë prova dhe më pas ia tregonin gjërat pjesë-pjesë. Që ta mbronin veten nga kureshtarët, të paafitt e nga bezdisësit, ata kishin zhvilluar një lloj sistemi sekret shenjash dalluese. Përveç kësaj, personi që kish shprehur dëshirën për tu pranuar në këtë brigadë ndërtimi, duhej të sqaronte vendin dhe rrethanat që kish rënë për herë ta parë në kontakt me zanatçinj të tillë. Kjo bënte të mundur që një nxënës apo zejtar që ishte pranuar në një brigadë të Strasburgut, të identifikohet gojarisht pranë një brigade të Vjenës, që merreshin me ndërtimin e katedrales së Shën Stefanit.

Me këtë rast është e rëndësishme që të bëhet e qartë që Lidhja e Muratorëve të Lirë është krijuar – të paktën – në Angli nga Mjeshtër të njëjtin profesion. Ekziston një teori që shpjegon domethënien e fjalës Freemason<sup>24</sup>, teori e cila sqaron se, sipërmarrësit e asaj kohe për të ndërtuar objektet e tyre, merrnin në punë vetëm Mjeshtër që ishin të lirë (free) e nuk i përkisnin asnjë lloj korporate (sindikate). Pikërisht këto ishin ato që krijuan Odat e para. Një domethënie tjetër e fjalës Freemason mendohet që mund të rrjedhë nga lloji i gurit, te cilët Muratorët e përdornin për ndërtimin e objekteve të ndryshme<sup>25</sup>. Ky gur në të shumtën e rasteve ishte një gur gëlqeror, shumë i kollajshëm për tu punuar, dhe që gjendej në gjendje të lirë, kudo në natyrë. Domethënia e saj mund të jetë cilado nga këto.

Rëndësia më e madhe e Muratorisë së Lirë qëndron në faktin, se nga një shoqëri vepruese në terren, pra nga një bashkësi burrash me të njëjtin profesion, u kthye në më pak se disa dekada në një

---

<sup>24</sup> Murator i Lirë

<sup>25</sup> kisha, katedrale, pallate perandorake e mbretërore etj

---

bashkësi shpirtërore, ku trajtoheshin tema me përmbajtje intelektuale, etike, morale e shkencore. Ky tranzicion, sipas të gjitha gjasave ndodhi në shek. e 17-të. Brigadat Angleze të ndërtimit, duke mos gjetur më punë në ndërtimin e objekteve të mëdha, për arsye se objekte të tilla nuk ndërtoheshin më, kërkuan që të merren me diçka tjetër dhe kaluan nga puna operative në atë spekulative<sup>26</sup>. Tanimë nuk ekzistonte mundësia që në pushimet e punës t'i linin veglat mënjane e të luteshin, por takimet filluan t'i mbajnë në disa ambiente të mbyllura që i quajtën Oda, vende ku shpeshherë ftonin edhe aristokratë, filozofë e personalitete të nderuara. Këto qenë Lozhat e para simbolike, të cilat më së miri i ka përshkruar e dokumentuar fizikani Francez me famë botërore John Theophilus Desaguliers<sup>27</sup>. Kjo i hapi qe një dritare të re historisë kulturore e intelektuale të Evropës. Tashmë jo vetëm shkollat e universitetet zotëronin terrenin për të arsimuar e edukuar njerëzit. Njohuritë e fituara nëpër shkolla e universitete filluan të plotësoheshin në mënyrë integrale, që nënkupton ndjekjen e procedurave për të formuar më mirë intelektin, arsyen, shpirtin dhe karakterin.

Në të gjitha Odat e hapësirës Evropiane të shek. të 19-të vihej re një shumëllojshmëri temash që diskutoheshin, duke filluar me problemet shoqërore, fenomenet sociale e deri tek temat me përmbajtje ezoterike.

Ne akoma jeni tek vëllai ynë i ri në shkallën e parë. Mund të thuhet që ai tashmë është vetndërgjegjësuar, që jeta e tij pa reflektim mbi vetveten, pa rregull dhe disiplinë, pa normat e etikës e të moralit, nuk është më ajo që ka qenë dikur. Si Kërkues ai ishte vazhdimisht në kërkim të kuptimit të jetës së tij, dhe tani ka gjetur vendin edhe njerëzit, që janë në të njëjtën rrugë me të për t'ia arritur këtij qëllimi.

---

<sup>26</sup> nga latinishtja *speculari*, - mënyrë filozofike e të menduarit për të arritur tek dija, njohuritë, zbulime të reja etj.

<sup>27</sup> asistent i Sir Isaac Newton – Isak Njuton

---

Është e mundur që disa simbole në Lozhë t'i duken atij akoma si të pakuptimta, por mbi qilimin e shtrirë në mes të tempullit janë të qëndisura ato vegla që dikur janë përdorur nga gurgunuesit e vjetër. Ai tashmë e din që dy gurët e vendosur pranë altarit në pjesën lindore të tempullit, simbolizojnë shpirtin dhe karakterin e tij. Me çekiçin me majë ai do ta gdhendë gurin e palatuar të personalitetit të tij deri në atë formë, që ky gur të ketë marrë formën e duhur për tu vendosur në murin e tempullit të dashurisë së përgjithshme njerëzore.

Gjatë këtij viti ai mund ta ketë pyetur veten shpeshherë, se a do të ishte e mundur që si individ i vetëm të kishte arritur të njëjtin qëllim apo diçka të përafërt me të. Por, ai në të njëjtën kohë e ka përjetuar që formimi i një njeriu në aspektin intelektual (mendor), është i lidhur ngushtë me krijimin e kontakteve të singerta me të tjerët, ku reflektimi ndaj një personi tjetër është një mjet shumë i domosdoshëm për të formuar e përsosur vetveten. Ai gjithashtu ka mësuar që një individ, i fokusuar vetëm në vetveten e tij, kurrë nuk do të jetë në gjendje që të bëjë gjëra vendimtare në jetë. Ai ka mësuar, dhe për këtë është plotësisht i ndërgjegjësuar, që për të siguruar më së miri ekzistencën e tij, çdo njeri e ka të domosdoshme që të ketë një hapësirë apo ambient social në dispozicion. Ai ka fituar vëllezër, ku ai ka besim dhe siguri të madhe që mund të mbështetet tek ta. Në një botë të konkurrencës së pamëshirshme, të lakmisë të paskrupullt për të nxjerrë përfitime të pafundme, në një botë ku ftohtësia dhe indiferenca janë në rend të ditës, si në profesion, në familje, në parti apo në ndërmarrjen, Oda ku ai është anëtar, do t'i duket si një vend, që gjithashtu është pjesë e kësaj bote, por në të njëjtën kohë pasqyron modelin e një bote më të mirë se kjo.

Ai ndoshta do të shtrojë pyetjen, që Oda dëshiron të jetë imazhi apo modeli i kësaj bote dhe do të kuptojë, që anëtarët e një Ode do ta kenë shumë më të lehtë që ta menaxhojnë ditën e tyre, nëse futen thellë e më thellë në idetë dhe konceptet e Muratorisë së Lirë. Hapi i

---

dytë operativ është ngritja e vëllait nga rangu i nxënësit në rangun e zejtarit. Oda me të drejtë mund të mendojë, që vëllai i ri, në periudhën kohore të një viti, është në rrugë të mbarë të njohjes së vetvetes. Me një te drejtë akoma më të madhe, kjo Odë mund të mendojë që ky vëlla tashmë është ambientuar më këtë vëllazëri, dhe në momentin që ai tregon interes, Mbikëqyrësi i Parë e propozon ngritjen e tij në shkallën e zejtarit.

Në traditën shekullore të artizanëve është zakon, që kalimi nga nxënësi në zejtar të behët sipas dokeve të caktuara, që në atë kohë degjeneronin edhe në parodi. Ceremonia e kalimit të nxënësit nga shkalla e parë në atë të zejtarit është një ndër festat e mëdha në Muratorinë e Lirë. Zakonisht kjo ceremoni mbahet një Odë të zbukuruar me lule, ku mbizotërojnë lumturia, gëzimi e hareja. Megjithatë vëllait që do të ngrihet ne shkallën e dytë, gjatë udhëtimeve të tija në tempull, i rikujtohet herë pas here vdekja, veprime që janë pjesë e ritualit.

Tashmë i ngritur në rangun e zejtarit, Muratori ynë, e ka të drejtën që edhe i vetëm, i pashoqëruar, të vizitojë të gjitha Odat e rregullta të kësaj bote, që duhet të jenë 40.000 deri në 45.000 në numër. Shkalla e dytë është e fokusuar ne një tezë kryesore të veçantë që quhet: Marrëdhëniet Vëllazërore.

Në Odat gjermanishtfolëse, zejtarit i jepet një letër e përpiluar nga Johan Wolfgang fon Gëte (Johann Wolfgang von Goethe), dhe që i dhurohet Vilhelm Meister-it (Wilhelm Meister) nga anëtarët e shoqatës së kullave në romanin me të njëjtin titull. Kjo është një përmbledhje aforizmash jetësorë të rëndësishëm dhe është tej për tej e përshkruar nga një mençuri e thellë njerëzore.

*“Mjeshtëria është e gjatë, jeta është e shkurtër, gjykimi është i vështirë, mundësia është kalimtare. Të veprosh është lehtë, të*

---

*mendosh është vështirë; të zbatosh ato që ke menduar është bezdi. Çdo fillim nisët me qejf, pragu është vendi i pritjes. Djaloshi habitet, përshtypja është destinimi i tij, duke luajtur mëson, serioziteti e befason.*

*Imitimën e kemi të lindur, por e imituara nuk njihet kollaj. Rrallë e gjejmë më të mirën, akoma më rrallë e vlerësojmë atë. Lartësia na tërheq, por jo shkallët që të çojnë atje; me Majën e malit parasysh, po për të lëvizur lëvizim në fushë. Vetëm një pjesë e mjeshterisë mund të mësohet; por mjeshtrit ama i duhet e gjitha. Kush e njeh vetëm gjysmën, është i marrë dhe flet shumë; kush e zotëron të gjithën, vetëm vepron dhe flet pak ose flet vonë. Këta nuk kanë sekrete dhe nuk kanë forcë, mësimet e tyre janë si një bukë e pjekur, e shijshme ngopëse vetëm për një ditë.*

*Por miellin nuk mund ta mbjellësh dhe farat e mbjelljes nuk duhen bluar.*

*Fjalët janë të mira, por nuk janë më e mira. Më e mira nuk del në pah përmes fjalëve. Intelekti, me të cilin ne veprojmë, është më i larti. Veprimi në fillim kuptohet vetëm nga intelektin e më pas shpaloset. Askush nuk e din se çfarë bën ai (intelekti), kur ai vepron drejt e kur jo; por jemi gjithmonë të vetëdijshëm kur ai vepron padrejtësisht. Kush vepron vetëm me shenja, është një njeri pedant, sharlatan dhe hipokrit. Ka shumë prej tyre dhe kënaqen kur janë së bashku. Thashethemet e tyre i mbajnë të frenuar nxënësit dhe këmbëngulja e tyre mediokre frikëson më të mirët. Domethënia e mësimëve më të mira të mjeshtrit përmblihen si vijon; ku mungon fjala, flet vepra. Nxënësi i vërtetë mëson që nga e njohura të ndjekë të panjohurën dhe dalëngadalë t'i afrohet mjeshtrit.*

*Lartësimi në shkallën e tretë bëhet zakonisht pasi zejtarin të ketë punuar rreth një vit në shkallën e dytë. Ai si dhe vëllezërit e tij e kanë*

---

të qartë, që domethënia e këtyre tre shkallëve është një lloj simbolike dhe simbolizon proceset shpirtërore që kalon ky vëlla pasi është pranuar në këtë Lidhje. Shkalla e parë i mundësoi atij pranimin, e dyta vërtetoi angazhimin e tij të vlerësuar në Odë, dhe në të tretën i kthehet përsëri vetes së tij.

Ai ka mësuar se si ta njohë vetveten, se si ta zotërojë vetveten, dhe tani duhet të marrë rrugën se si ta përsosë vetveten. Ai e ka të qartë që këto janë kërkesa postulate, që sipas karakterit e fatit të tij, pak a shumë duhen përmbushur. Edhe dinjiteti mjeshtëror i jepet atij në mënyrë simbolike. Çdo Murator i vërtetë e ka të qartë që gjithë jetën e tij ka për të qenë nxënës, dhe që objektivave të shkallës së dytë e asaj të tretës, do t'u afrohet në asimptotë<sup>28</sup>, pa i arritur ato ndonjëherë deri në fund.

Shkalla e tretë është pothuajse një dramë psikike e karakterit Shekspirian, e mbështetur mbi një legjendë, përmbajtja e së cilës rrjedh nga Bibla. Në qendër të ceremonisë të shkallës së tretë është mjeshtri Hirami, një personazh i përmendur në “Librin e Mbretërve” dhe “Librin e Kronikave” të Biblës. Ai ishte mjeshtri që ndërtoi Tempullin e Salomonit, dhe që u vra nga zejtarët kryengritës të tij. Ata deshën që me dhunë t'i nxirrnin sekretin (fjalën) e mjeshtërit. Sekretin e mjeshtërit, qoftë ai emri i Zotit, apo ndonjë aftësi teknike ndërtimi, apo ndonjë gjëgjëzë e fshehtë, nuk mund të mësohet kurrë me dhunë. Këta zejtarë tradhtarë janë nga njëra anë vrasës dhe nga ana tjetër nuk qenë në gjendje të mësonin sekretin e vërtetë të jetës, sekretin e përbërë nga: Puna, përlujta, durimi dhe mirësia.

---

<sup>28</sup> Nga matematika: Asimptote – një vijë e drejtë, që i afrohet një vije të lakuar të pafundme, por që nuk e arrin kurrë atë

---

Ky rit, që njihet me emrin riti i lartësimit, simbolizon arritjen e mjeshtërisë të përkryer. Simbolikisht rruga e individuacionit<sup>29</sup> mbyllet me këtë shkallë. Vëllai Murator, pas kësaj shkalle, është tërësisht i mirinformuar dhe mund të quhet i futur në brendësi të Artit Mbretëror.

Njohësit e historisë, të artit e të kulturës janë të qartë që miti i ringjalljes është pjesë e historisë njerëzore i mijëvjeçarëve të fundit. Qe para pesë mijë vjetësh në hapësirat e gjysmëhënës, nga Gjiri Persik e deri në Mesdhe, ekzistonin kultet e ringjalljes, kulte dhe imagjinata që përbënin bërthamën e fesë egiptiane të Osiris-it.

Mjeshtri e ka kuptuar se përse Muratoria e Lirë quhet gjithashtu Arti Mbretëror apo Mjeshtëria Mbretërore. Për një mjeshtër si kjo e Muratorisë së Lirë është lehtë e kuptueshme se kush qëndron në qendër të dramës psikike, që zhvillohet në shkallën e tretë gjatë ndërtimit të tempullit të Solomonit, që është njëkohësisht tempulli i dashurisë së përgjithshme njerëzore. Misterioz qëndron fakti, që vetëm me fuqitë e tua nuk mund të bëhesh kurrë nga zejtari në mjeshtër. Në të vërtetë një fenomen i tillë ndodh edhe në jetën tonë të përditshme. Për të arritur tek mjeshtëria kemi nevojë gjithmonë për ndihmën e të tjerëve, që në të shumtën e rasteve janë mësuesit apo mjeshtrit tanë. Asnjëri nuk e ka të mundur që i vetmuar të arrijë mjeshtërinë në ndonjë fushë të caktuar, pa pasur ndihmën dhe mësimet e njerëzve që e rrethojnë. Një i vetëm s'je askush. Njeriu është një zoon politicon, që do të thotë një qenie politike sociale. Me shkallën e tretë përmbillet sistemi edukativ i Muratorisë së Lirë. Shkallët e tjera që vijnë mbi këto tre shkallë, dhe që quhen shkallët e larta, thellohen më tej në domethënien e simboleve dhe të rriteve të mësuara në këto tre shkallë, përmbajnë më shumë drama

---

<sup>29</sup> Nga latinishtja *individuare*, që do të thotë rruga drejt tërësisë vetanake, rruga drejt krijimit të individit të plotë

---

psikike dhe i japin një rëndësi të madhe përjetimeve dhe depërtimeve në fushën e transcendencës.

Me të drejtë mund të thuhet që tre shkallët e para janë ato shkallë që përmbajnë dhe ofrojnë njohuritë themeltare të Muratorisë së Lirë. Këto shkallë me ritualet e tyre paraqesin një lloj teatri botëror, *Theatrum Mundi*, ku luhen skenat nga lindja deri në vdekje.



---

## Simbolet para-verbale dhe shpjegimi i riteve të tyre

Shoqëritë e sotme kanë tendenca, që periudhën në të cilën po jetojmë, ta quajnë epoka e komunikacionit. Ne vazhdimisht flasim për një shoqëri të bazuar mbi informacionin, që dalëngadalë po zhvillohet si shkencë më vete, dhe jemi mësuar që në jetën e përditshme të komunikojmë me anë të sinjaleve, shenjave dhe të simboleve.

Mënyra e përdorimit të pjesës më të madhe të pajisjeve tona shtëpiake, të aparateve të ndryshme elektrike e elektronike, shpjegohet me anë të shenjave. Qarkullimi rrugor, në pikat e kryqëzimit, rregullohet me anë të tabelave, të përbëra nga piktograme (shenjave të vizatuara mbi to). Këto sinjale dhe shenja përbëjnë në vetvete një lloj komunikimi para-verbal, por nuk janë simbole.

Në një pjesë tjetër të këtij libri kemi shpjeguar pakëz se çfarë është një simbol. Ndoshta Gëte (Goethe) ka gjetur formulimin më të shkurtër rreth kësaj fjale: “Simboli është një objekt në kuptimin më të lartë të tij.” Dhe ne u munduam që ta shpjegojmë këtë më anë të shembullit të trekëndëshit, që përdoret në orën e gjeometrisë e të vizatimit teknik, por që gjithashtu ka edhe kuptime të tjera si në qarkullimin rrugor apo në paraqitjen e trinisë mbi altarin e kishës.

Që t’i afrohem sa më pranë kuptimit të vërtetë të një simboli, duhet të dimë, që ekzistenca e këtij simboli varet nga kuptimi i tij, nga mënyra se si ky simbol interpretohet nga ato që duan ta përvetësojnë kuptimin e këtij simboli. Që një simbol të kuptohet ka nevojë që të shpjegohet e të sqarohet. Pas këtij procesi ai do të shfaqë shumëllojshmërinë e dimensioneve të tij.

Le t’ia nisim me simbolin më të lartë të të gjitha simboleve. Muratorët e Lirë me qëllim nuk e përmendin emrin “Zot”. Ata këtë

---

emër e kanë zëvendësuar me simbolin “Mjeshtri i Madh i Ndërtimit të të gjitha Botëve”. Meqë anëtarët e një Ode janë ose mund t’ju përkasin konfesioneve nga më të ndryshmet, është parë e domosdoshme, që përfytyrimi mbi Zotin të shprehet me anë të këtij simboli, duke mënjeluar me këtë mënyrë botëkuptimet e ndryshme apo ndonjë zënkë të mundshme brenda në Odë.

Praktikisht simboli është si një petk brenda të të cilit secili mund të imagjinojë Zotin e tij siç dëshiron ai. Kjo do të thotë që si ai që beson vetëm në shkencë, si ai që është gnostik, gjithashtu edhe ai që është i lidhur pas një feje të caktuar, e pranojnë simbolin e “Mjeshtrit të Madh të Ndërtimit të të gjitha Botëve”, pa pësuar ndonjë dëmtim të bindjeve apo ndërgjegjes së tij.

Kush ka arritur të kuptojë që bota jonë, universi ynë, natyra e gjallë dhe ajo e vdekur janë mrekulli të pashpjegueshme, ka kuptuar gjithashtu që vetë ekzistenca jonë është pothuajse e pashpjegueshme. Por, ky njeri është në gjendje të gjykojë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën tonë.

Nuk është qëllimi im që me këto pak rreshta, të përshkruaj historinë e besimit në një apo në shumë Perëndi. Është e parëndësishme se si quhet krijuesi i gjithësisë. “Zot” gjithashtu do të ishte vetëm një fjalë po të mos ishim në gjendje për të ndërë e kuptuar shumëllojshmërinë e fuqisë së pafundme që lidhet më këtë fjalë. Fuqi pa të cilën jeta jonë nuk do të ishte aspak e mundur.

Besimtarët, të gjitha fenomenet që ndodhin në këtë botë, ia dedikojnë Zotit. Shkencëtarët nga ana tjetër mundohen që hap pas hapi t’ju ofrohen sekreteve të universit. Këtë afirm mundohen që ta bëjnë me anë të eksperimenteve të drejtuara nga logjika e intelektit, eksperimente të cilat herë pas here i kontrollojnë për vërtetësinë e tyre. Por, të dyja palët, si shkencëtarët ashtu dhe besimtarët, vijnë në

---

një pikë, ku intelektu individual i tyre ndeshet me një lloj fuqie që ata nuk janë më në gjendje që ta shpjegojnë më tej. Gjithësia jonë është e krijuar nga katër forca të ndryshme: forca e dritës, forcat tërheqëse ose gravitacioni dhe forcat magnetike e atomike të yjeve të gjithësisë. Ajnshtajn (Einstein) u përpoq që të krijonte një formulë të përgjithshme ku të ishin të përfaqësuara të gjitha këto forca. Ndoshta kjo nuk ka për tu arritur asnjëherë, sepse kjo formulë njëkohësisht do të ishte ajo që njerëzit e quajmë thjeshtë, Zot.

Edhe njëherë, që një simbol të kuptohet më mirë, duhet të shtjellohet e sqarohet deri sa të jetë e mundur. Por nga ana tjetër, vetëm me anë të gjuhës, që do të thotë, me anë të intelektit racional, kjo nuk do të arrihet kurrë. Simboli përmban në vetvete edhe ndjenjat e emocionet e atij që e shikon, ose e formuluar ndryshe, njeriu projektin shpirtin dhe ndjenjat e tij në simbol ose mbi të. Ndërkohë është shumë e mundur, që me anë të gjuhës, njerëzit të mos afrohen por të largohen me njëri-tjetrin, sepse formulimet gjuhësore shkaktojnë në trurin tonë opinione e mendime të kundërta. Simboli nga na tjetër është një forcë më vete, që ka aftësinë të pranojë një interpretim të shumëllojtë të diçkaje, por që njëkohësisht i qëndron besnik përmbajtjes së tij të përcaktuar.

Brenda në Odë, që njëkohësisht simbolizon botën tonë, gjenden një numër i madh objektesh simbolike, që në princip nuk bëjnë gjë tjetër veçse na shpjegojnë arritjet kulturore të racës njerëzore.

Kjo ka qenë një arritje e veçantë e homo faber-it<sup>30</sup>, që kualitetet profesionale, t'i shikonte papritmas si kualitete morale të tij: si për shembull, metrin, mistrinë, çekiçin, niveluesen, plumbçen etj. Këto simbole u morën nga hapësirat jetësore të mjeshtërve të brigadave të ndërtimit të mesjetës.

---

<sup>30</sup> nga lat. “njeriu krijues” ose njeriu që me zanatin e tij krijon diçka

---

Pasuria intelektuale dhe filozofike e kësaj bote manifestohet gjithashtu në simbolet dhe në bisedat mbi ritet e saja.

Siç tashmë e dimë, në mes të Odës është i shtrirë qilimi, mbi të cilin janë të qëndisura dielli, hëna, një yll si dhe shtatë shkallë, të cilat simbolizojnë shtatë artet e lira, të cilat mësoheshin në universitete në periudhën e mesjetës. Simbolet e lartpërmendura zbukurojnë gjithashtu tempullin gjatë punës në shkallët (gradat) e ndryshme. Gjatë ritit (ritualit), Mbikëqyrësi i Parë, kërkon nga vëllezërit e tjerë që gjatë punës të ndriçojnë mendjet dhe shpirtin e tyre dhe t'i përgatisin ato për çdo gjë të mirë, të bukur e të drejtë. Ky është një udhëzim i qëllimit platonik të filozofisë antike dhe njëkohësisht një princip i periudhës së përndritjes (iluminizmit) të mendjeve njerëzore<sup>31</sup>. Lista e simboleve mund të plotësohej edhe më tej, por qëllimi im është që të bej sa më të qartë, se Oda është vendi ku ndërmjetësohen elementet bazë të moralit, etikës, filozofisë, elemente të cilat janë përpunuar shekuj me radhë nga kulturat që ka kaluar raca njerëzore.

Mund të thuhet me plotë gojë, që Muratoria e Lirë është në vetvete një përmbledhje mendimesh të vyera, të cilat janë vazhdimisht në lëvizje për të mundësuar shkuarjen përpara të shoqërisë, duke qenë në harmoni të plotë me forcat e lashta të natyrës.

Qëllimi i arsyes më të lartës mbi-individuele duket të jetë krijimi i një gjendje harmonie të plotë për botën në përgjithësi. Qëllimi i të gjitha zhvillimeve botërore është harmonia. Ky zhvillim është një lloj procesi, dhe si çdo proces ka shkallët e veta përpara për t'i kaluar. Shpeshherë arrihet vetëm një balancë e lëkundshme, por pothuajse kurrë nuk arrihet harmonia. Por nga ana tjetër, mendimet

---

<sup>31</sup> Përndritja, iluminizmi apo fillimi në gjermanisht njihen me termin “Aufklaerung” ose në anglisht me termin “Age of Enlightenment”

---

mbi zhvillimet në të ardhmen, janë pjesë e pandarë e të gjitha universeve. Yjet krijohen nga retë e zeza, ekzistojnë me miliona apo miliarda vite dhe pastaj shpërbëhen në të ashtuquajturën supernova. Këtyre forcave konstruktive të universeve, ju qëndron në anën tjetër si kundërpeshë ai lloj principi, që është sqaruar në disa pika nga Bolcman-i (Boltzmann), e që njihet me emrin principi i entropisë<sup>32</sup>. Mund ta themi edhe më thjeshtë – principi i shkatërrimit dhe asgjësimit. Përjetësia e ekzistencës tonë, duket sikur qëndron në pjesën më të vogël të atomit, në elektronin. Ky elektron nuk humbet asnjëherë, dhe sipas disa fizikanëve, me mendimin e të cilëve unë pajtohem, elektroni nuk është vetëm materie, pra vetëm material natyror, por në një farë forme zotëron gjithashtu pjesë të asaj që ne njerëzit se shpjegojmë dot e që e quajmë, logjikë apo arsye e mbinatyrrshme. Vetëm në organizmat e gjalla formohet një lloj ndërgjegje, si dhe kërkesa e vazhdueshme ndaj vetvetes për tu përsosur më tej, kërkesë që vihet re si tek njerëzit ashtu edhe tek kafshët. Evolucionin e miliona viteve mund të quhet si një perfeksion në vazhdimësi, e që do të thotë, që kjo të cilën ne e quajmë botë, natyrë, mjedis, ndodhet vazhdimisht në një proces ndryshimesh e zhvillimesh, dhe është filozofia jonë ajo që do të paguajë haraçin për të.

Ka mendimtarë muratorie që janë të mendimit, se bota jonë mund të kuptohet, vetëm duke u bazuar në simbolikën universale. Kjo mund të jetë një imagjinatë e tepruar.

Sigmund Freud projektoi një botë, e cila zotërohej nga Libido<sup>33</sup> dhe nga Thanatos-i<sup>34</sup>. Ideja e zhvillimit modern, ide e bazuar në mësimet e Darvinit, flet mbi krijimin e llojeve dhe zotësisë së tyre për të mbijetuar. Shkencat natyrore kanë arritur të provojnë lindjet dhe vdekjet e universeve të tjera. Si në mikrokozmos ashtu dhe në

---

<sup>32</sup> Shpërbërje nëpërmjet nxehtësisë

<sup>33</sup> instinkti, kënaqësia, epshi

<sup>34</sup> vdekja, nga greqishtja, zoti i vdekjes

---

makrokozmos ka një lloj zhvillimi të vazhdueshëm, që mund të quhej perfeksion ose përsosmëri. Në të njëjtën kohë ndikojnë edhe forca të kundërta me to, forcat destruktive – forcat shkatërruese. Rruga e forcave konstruktive, apo të perfeksionuara, kryqëzohet vazhdimisht nga rruga e forcave destruktive apo shkatërruese. Si rrjedhojë krijohen shpeshherë balanca të lëkundshme, deri diku dhe të qëndrueshme, dhe që mbajnë një lloj baraspeshe për kohë të shkurtra apo edhe të gjata. Siç duket, çdo ekzistencë në gjithësinë tonë ka nevojë të arrijë gjendjen e harmonisë. Çdo përsosmëri përmban brenda vetes dhe shkatërrimin. Liriku Rainer Maria Rilke shkruan në rreshtat e tij: “E bukura është fillimi i së frikshmes”.

---

## Produkte të Muratorisë së Lirë apo Rezultate të Andragogjisë së tyre

Me andragogji nënkuptojmë udhëheqjen e njerëzve. Por Muratoria e Lirë nuk e ka qëllim të saj in që të udhëheqë njerëzit, ajo i udhëzon ata, që të edukojnë vetveten. Ky lloj edukimi ndodh kryesisht në tri shkallët që i shpjegojmë më përpara dhe vazhdon më tutje në shkallët e larta. Cilat janë rezultatet e këtij vetedukimi, apo cilat duhet të jenë ato?

Ai person, që edukon vetveten mund të llogarisë që Muratoria e Lirë prodhon me të vërtetë diçka të mrekullueshme: humanitet, tolerancë dhe respekt.

Unë mësoj të dëgjoj të tjerët, unë mësoj t'i lë të tjerët të falsin e të përfundojnë mendimin e tyre, mundohem t'i kuptoj mendimet e tjetrit, edhe kur nuk janë të njëjta me mendimet e mia. Mundohem që t'i kuptoj e t'i pranoj motivet që e kanë shtyrë tjetrin të veprojë ashtu siç ka vepruar, edhe pse ka qenë në kundërshtim me principet e mia. Mundohem që të mos e shikoj si kundërshtar e si armik atë person që nuk është i një mendje me mua. Dhe mundohem që sa të jetë e mundur personin që më kundërvihet e më trajton mua si armik, të mos e trajtoj si të tillë.

Që me zbulimin e bombës atomike, ne e kemi vetë në dorë që ta shuajmë jetën mbi këtë planet. Për herë të parë në historinë e njerëzimit jemi në gjendje të eliminojmë çdo gjallesë në rruzullin tokësor, duke pasur parasysh që do të eliminonim dhe veten tonë. Si rrjedhojë e kësaj, mirëkuptimi ndërmjet të gjithë popujve të kësaj bote, ndërmjet të gjitha feve, partive, shteteve, është më i domosdoshëm se kurrë. Fuqitë e mëdha, të cilat zotërojnë bombat atomike, nuk e kanë më në dorë që ta ndalojnë plotësisht, që shtete të vogla agresive apo individë të veçantë, siç janë terroristët, të bien në kontakt e të venë në përdorim armët bërthamore, dëmi i të cilave do

---

të ishte i pariparueshëm. Të merresh vesh e të kuptohesh me miqtë e me shokët është shumë e lehtë, po të kuptohesh me armikun jo dhe aq, për të mos thënë e pamundur. Duhet t'i shtrojmë pyetjen vetes, se si do të ishte e mundur që t'i eliminonin armiqësitë ndërmjet njëri tjetrit, apo akoma më mirë, të mos e lejonim fare lindjen e tyre.

Nga se lindin armiqësitë në këtë botë? Siç duket nga përplasjet me njëri-tjetrin, e ku asnjëri nuk dëshiron të "hapë rrugën." Apo siç duket kur dikush është në zotërim të mallrave, lëndëve të para, energjisë, etj, e tjetri do që t'i zotërojë ato, duke ia marrë atij me dhunë. Paragjykimet, inatet e neveritë, akoma luajnë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërmjet popujve. Urrejtjet racore, ngjyrat e ndryshme të lëkurës, bindjet dhe perceptimet e ndryshme fetare, traditat e zakonet e ndryshme, të gjitha këto mbjellin armiqësi dhe mund të çojnë në fillimin e luftërave të ndryshme. Urrejtjet racore, lufta ndërmjet klasave dhe dallimet fetare janë akoma sëmundje të trashëguara të racës njerëzore.

Një pyetje që diku më sipër u shtrua mbi Odën mund të shtrohet edhe për Muratorinë e Lirë në përgjithësi: Si e ndien veten Muratoria e Lirë, si imazh apo si model të kësaj bote? Me sa duket ajo është edhe njëra dhe tjetar. Anëtarët e saj vijnë nga jeta e përditshme, e që në fëmijërinë e tyre kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me fenomene sociale e ekonomike, me të cilat dhe janë rritur. Ata kanë qëllimet e tyre në jetë, ose janë në kërkim të kuptimit të jetës së tyre. Në të njëjtën kohë ata janë qytetarë të shteteve të tyre, anëtarë të familjeve të tyre dhe i përkasin një klase të caktuar në shoqëritë ku ata jetojnë. Në Odë atyre ju bëhet e qartë, që i kanë hyrë rrugës drejt përsosmërisë, rrugë të cilën duhet ta shkelin vetë me këmbët e tyre. Atyre gjithashtu ju bëhet e ditur, që këtë botë mund ta përmirësojnë e mund ta perfeksionojnë, vetëm nëse në radhë të parë përmirësojnë e perfeksionojnë veten e tyre. Kuptimin e vërtetë mbi tolerancën dhe respektin, që Muratori i Lirë e mëson në Odën e tij,



---

humanitetin, nga i cili ndjehet i tërhequr, janë veti të çmuara, që mund të përdoren si ilaçe kundër sëmundjeve të barbarizmave të kësaj bote, veti të cilat për shekuj me radhë nuk kanë arritur të zhvillohen në atë masë që duhet të ishin zhvilluar. Vetive të tilla nëpër Odat Muratorike ju përkushtohet një vëmendje e veçantë, sepse ato janë mënyra e vetme për të kapërcyer ndasitë polare që ekzistojnë.

Ai burrë, që ia ka mundësuar vetes që të jetë tolerant, njëkohësisht i ka mundësuar vetes përmirësimin e vet dhe vetëm atëherë ai i ka mundësitë të përmirësojë ambientin ku jeton, vepron e punon dhe për njerëz të tillë kanë nevojë të gjitha shoqëritë në të cilat jetojmë. Në realitet, njerëzit harxhojnë shumë më tepër energji duke u marrë më sporte të ndryshme, duke ju përkushtuar aktiviteteve të ndryshme për kalimin e kohës së lirë, se sa t'i bashkohen një bashkësie apo një shoqate që merret me problemet që ka shoqëria ku ata jetojnë, probleme që direkt apo indirekt ju përkasin edhe atyre. Shumë situata e qëndrime të gabuara krijohen vetëm sepse njerëzit më parë vepronë e pastaj mendojnë. Në raste të tilla, përmirësimi i asaj që ka ndodhur është shumë i vështirë.

Gëte (Goethe) kishte si parim të tijin shprehjen “mendo dhe vepro”, parim të cilin e zbatonte sipas këtij rregulli – çdo veprim tëndin, mendoje njëherë përpara. Fjala e urtë antike “çfarëdo që të bësh, bëje me mend dhe mendo fundin”, ka vlefshmërinë e vet në të gjitha kohërat.

Rryma e dytë kryesore, që i mundëson Muratorit të Lirë, vetedukimin e tij është mbajtja në Odë e një referati<sup>35</sup>. Kjo “pjesë ndërtimi” diskutohet më vonë nga të gjithë anëtarët e Odës. Përmbajtja e këtyre pjesëve është shumë e gjerë, ku trajtohen tema nga më të ndryshme. Tema që kanë të bëjnë pothuajse me të gjitha problemet shoqërore që ekzistojnë duke filluar nga problemet sociale

---

<sup>35</sup> në gjuhën Muratorike quhet pjesë ndërtimi ose skicë ndërtimi

---

ato ekonomike e deri tek fushat e ndryshme të shkencave. Me një fjalë, tema të tilla, mbulojnë të gjitha aspektet jetësorë të shoqërive tona. Këto mijëra referate që mbahen në të gjitha Obedienat e botës, janë jo vetëm kontribute akademike të vëllezërve muratorë, por njëkohësisht ndihmojnë në formimin e gjendjes së tyre shpirtërore e mendore.

Nuk është e thënë që këto leksione të përmbajnë patjetër gjëra të reja, të pazbuluara më parë, edhe pse këto do të ishin të mirëseardhura e të dëshirueshme. Mbi të gjitha e rëndësishme është që temat e trajtuara në to të përforcojnë harmoninë dhe mirëkuptimin ndërnjerëzor. Në shumë raste ndodh që e njëjta temë të trajtohet nga këndvështrime të ndryshme, gjë që ndihmon në njohjen më mirë të një vëllai tjetër. Këndvështrime të ndryshme nga vëllezër të ndryshëm janë më se të mirëseardhura në Muratorinë e Lirë sepse sjellin me vete njohuri të dyfishta: e para ti njeh më mirë vëllanë tënd, njeh më mirë veten dhe e dyta janë një shtytje e madhe përpara për kreativitetin e çdo kujt.

Muratorët e Lirë janë të mendimit që çdo njeri në këtë jetë është dhe mund të jetë kreativ. Për t'ja arritur kësaj, është kusht i domosdoshëm që ta pranosh tjetrin ashtu siç është, t'ia njohësh vlerat që ka, dhe mbi të gjitha ta marrësh atë seriozisht. Nuk luan ndonjë rol të madh, nëse je apo nuk je dakord me mendimet dhe idetë e tij – dhe nëse ato nuk janë në kundërshtim me etikën e moralin njerëzor – e mira do të ishte që t'ia respektoje mendimet dhe idetë që ai ka.

Muratorët e Lirë mundohen gjithmonë që të mënjanojnë mendjemadhësitë e t'ju largohen agresioneve e fyerjeve ndaj njëritjetrit. Lozha është një grupim njerëzish, që së bashku kanë si qëllim, që ta njohin njeri-tjetrin më mirë, jo vetëm si persona apo si përfaqësues të shtresave të tyre, por gjithashtu si intelektualë e si personalitete humane e me vlera njerëzore. Sipas mendimeve e

---

vlerësimeve të psikologëve të ndryshëm, ky diskurs i vazhdueshëm ndihmon në arritjen e qëllimit për të cilin Muratorët e Lirë punojnë gjatë gjithë jetës së tyre: transformim në qenie humane.

Ka pak rëndësi se nga cili nivel i personalitetit të nxënësit, zejtarit apo mjeshtrit nis ky transformim apo ky konvertim. Janë ritet dhe simbolet ato që e perfeksionojnë këtë proces. Ndryshime të tilla, në të vërtetë, nuk njohin kufij. Gëte (Goethe) mbronte teorinë, “që për të arritur në përjetësi, duhet t’i përshkosh të gjitha rrugët në këtë jetë”.

Globalizimi, që në kohën që po jetojmë e përshkon të gjithë ekonominë botërore, në radhë të parë ju shërben industrive të mëdha, korporatave ndërkombëtare si dhe bankave. Ky lloj sistemi ka sjellë me vete edhe ndërkombëtarizimin e ekonomive, të cilat kanë si qëllim kryesor krijimin e një rrjeti sa më të madh fitimprurës, e që mundësisht të ketë kosto sa më të vogla. Individit në vetvete dhe statusi i tij social përherë e më shumë po dalin në plan të dytë. Në të gjitha kontinentet ekzistojnë masa të mëdha të papunësh, që i kanë mundësitë tepër të vogla për tu punësuar dhe kjo mundësi mund t’ju jepet vetëm nëse janë në gjendje dhe shprehin vullnetin e tyre që t’i futen një procesi edukimi të mjaftueshëm. Stadi i zhvillimit në të cilin gjendemi, i jep më shumë rëndësi përfitimeve materiale që nxjerrin këto institucione globale, sesa jetës së njerëzve. Këto mund të krahasohen me ata ushtarakë, që i nisin ushtarët e tyre në fushë të betejë pa pyetur sa çfarë humbesh do të pësojnë. Kjo mënyrë e të menduarit krijon vetëm të plagosur dhe të vdekur, të varfër, të sëmurë, të uritur dhe të pastrehë.

Në kohët që po jetojmë si dhe në të ardhmen duhet të jetë detyrë e Muratorëve të Lirë, që t’ju kundërvihen zhvillimeve të tilla sociale. “Armët” që Muratorët kanë në dispozicion, siç janë morali, etika, humaniteti, toleranca dhe respekti, janë më se të përshtatshme në këtë lloj ballafaqimi.

---

## Çfarë është humaniteti e çfarë është toleranca?

Në fillim le të përqendrohemi në kuptimin e këtyre dy fjalëve. Fjala humanitet përfaqëson sjelljet pozitive të një njeriu në të gjitha rrethanat e jetës ku ai gjendet. Çuditërisht fjala latine *human*, po të përkthehej do t'i përshtatej më mirë termit *njerëzor*, term që përdoret vetëm për anët më të mira të njeriut. Krimet, luftërat, sjelljet e këqija, lakmia, urrejtja, dhuna, brutaliteti – të gjitha këto veti që për fat të keq njeriu i zotëron të gjitha, quhen nga ne si dhunti çnjerëzore, si dhunti jo-humane, që duke u bazuar tek këto terma gjuhësorë, arrijmë në përfundimin se brenda njerëzve ekziston tendenca e vazhdueshme drejt përsosmërisë e drejt perfeksionit, tendencë që nxjerr në pah vetitë e virtytet më të mira të racës njerëzore.

Humaniteti është një produkt i kulturës. Me humanitet gjithashtu nënkuptojmë përkujdesje, përfillje, ndjeshmëri për të tjerët, mirëkuptim, butësi dhe durim. Human nuk duhet të tregohesh vetëm brenda për brenda familjes, në ndërmarrjen ku punon, në lagjen ku banon apo në shtetin ku jeton. Human duhet të tregohesh edhe ndaj njerëzve të racave e popujve të ndryshëm, edhe ndaj të tjerëve që si ke njohur asnjëherë. Kush ushtron dhunë në familje, nuk është human. Kush nuk ju ofron ndihmë njerëzve që janë në rrezik, e kush nuk ndjen me ta, është jo-human. Luftërat janë dështimet më të mëdha të njerëzimit, megjithatë ato ekzistojnë që në fillimet e tija dhe ato mund të kapërcehen vetëm nëpërmjet metodave e mjeteve humane.

Mund të thuhet, që humaniteti është shëmbëlltyra e përsosur, që zotëron njeriu brenda vetes. Do të ishim arrogantë të mëdhenj, aftësia nuk na mungon që të jemi të tillë, që anët e këqija të karakterit tonë ti quanim mizori – shtazët janë kafshë dhe kafshët nuk mund të jenë mizore.

---

Muratorët e Lirë mundohen që ato gjëra që i mësojnë nëpër Oda, nëpërmjet fjalëve dhe riteve, t'i venë në zbatim e t'i praktikojnë në jetën e përditshme jashtë Odave. Një Murator i Lirë mundohet, që si në familjen e tij ashtu dhe në mjedisin që e rrethon atë, të krijojë një atmosferë humane, të krijojë një ambient ku të mos jenë të mundur arroganca, sherret e mosbesimi. Të gjithë e dimë që lufta fillon në familje. Grindjet përhapen shumë shpejt. Në pamje të parë të duket, që humaniteti është një armë e dobët në kaosin e mbarëbotëror që ekziston. Kjo nuk është e vërtetë.

Përshkrimi, se çfarë mund të jetë humaniteti, do të mbetet i paplotësuar, sepse ne njerëzit, që ta përmbushim këtë, duhet t'ja vëmë të gjithë jetën tonë në dispozicion, që t'i afrohemi këtij qëllimi. Njeriu human duhet të jetë edhe tolerant.

Fjala tolerancë gjithashtu rrjedh nga latinishtja dhe nuk do të thotë gjë tjetër veçse durim. Në rrjedhat e historisë ka ndodhur shpeshherë, që pakicat të kenë kërkuar, pritur, shpresuar, që të duroheshin (toleroheshin) prej shumicave. Nuk është ndonjë shëmbëlltje pozitive e marrëdhënieve ndërnjerëzore, që vetëm ta durosh tjetrin. Muratorisë së Lirë, që dëshiron që ta shohë gjithë njerëzimin si një familje të vetme, durimi i duket i pamjaftueshëm. Marrëdhëniet tona ndër njerëzore mund të përshkruhen sipas këtyre shkallëve shumë të thjeshta për tu kuptuar. Së pari ta pranosh, pastaj ta durosh, ta respektosh, ta vlerësosh dhe në fund ta duash tjetrin.

Jo për çdokënd është e lehtë që ta praktikojë këtë lloj hierarkie. Prandaj me e rekomandueshme do të ishte, që marrëdhëniet tona me të tjerët, t'i ndërtojmë mbi mundësi e praktika të njohura. Toleranca, edhe pse në vetvete është e pamjaftueshme, mund të jetë shumë e dobishme në këtë mes.

---

Toleranca është një material ngjitës i mirë, për të gjitha situatat e jetës. Është vetëm absurditet nëse ai që ka fuqinë në dorë, të kërkojnë nga ai që është i pafuqishëm, që të jetë tolerant ndaj tij. Toleranca gjithashtu ka kufijtë e saj. Që t'i zbulosh këta kufij nuk është e thjeshtë, përkundrazi është shumë e vështirë. Por nëse mundohesh vazhdimisht që me mençuri, me fuqi e me bukuri të qëndrosh në rrugën e përsosmërisë që ke nisur, atëherë do të jesh shumë i kujdesshëm, që në raste konfliktesh të veprosh në mënyrë të tillë, që të mos vijë puna kurrë deri atje sa të ketë nevojë të përdoret dhuna. Siç duket, raca njerëzore që në krijimet e saja, qoftë individit në vetvete apo grupi në tërësi, janë të predispozuar, që të sundojnë mbi njëri-tjetrin. Duke u bazuar në këtë mund të themi, që “njerëzit normalë”, e kanë të mundur që të mbijetojnë në këtë botë, botë që sipas Fridrih Shiler-it (Friedrich Schiller), udhëhiqet nga urrejtja dhe dashuria.

Në kohët e hershme, të fuqishmit, njëkohësisht dhe të plotfuqishmit, nga vetëdija, bamirësia apo nga bujaria, tregoheshin tolerantë ndaj pakicave. Në kohët që jetojmë dhe në të ardhmen, mbijetesë e shoqërive dhe e njerëzimit në përgjithësi, do të jetë e mundur, vetëm nëse individit do të mësojë që të jetë tolerant në mjedisin ku jeton e vepron. Në Odë secili nga vëllezërit mëson që të kuptojë e ta tolerojë vëllanë e tij e si rrjedhojë dhe të ketë respekt të madh ndaj tij.

Një pengesë e madhe që ju del përpara si Muratorëve të Lirë ashtu edhe jo-Muratorëve është: njeriut jo tolerant nuk mund t'i kundërvihesh me tolerancë. Dhuna dhe terrori nuk mund të pranohen ashtu siç janë. Megjithatë, sa të jetë e mundur duhet të praktikohen, si dialogu, diskursi, diskutimet ndërmjet dy kundërshtarëve, pse jo edhe ndërmjet dy armiqve.

---

Nuk është e thënë që toleranca e humaniteti të mësohen e praktikohen vetëm në Oda. Jo vetëm Muratorët e Lirë duhet të jenë e të sillen tolerantë e humanë. Ne duhet të arrijmë në atë shkallë, që opinioni i gjerë publik, shteti e shoqëria civile të vlerësojnë në maksimum kualitetet që ofrojnë toleranca e humaniteti. E vërteta qëndron krejt ndryshe: Humaniteti e toleranca njihen si veti të dala jashtë mode, që ju ka kaluar koha, shikohen si dobësi, politikisht të papërdorshme. Por nga ana tjetër, qëndrimet humane e tolerante, janë të vetmet veti që garantojnë mbijetesën tonë.

Humaniteti dhe toleranca nuk janë rruga e vetme që mundësojnë humanizimin e shoqërive tona, por kanë një vlerë shumë të madhe në këtë proces, dhe sa më herët të fillohet me vënien në jetë të tyre, aq më mirë është për njerëzimin.

---

## Kufizimet ndaj fesë, shkencës dhe filozofisë

Për dikë që nuk është anëtar i kësaj Lidhje, është e vështirë që ta kuptojë, se me se merren Muratorët e Lirë gjatë qëndrimit në Odat e tyre dhe çfarë është ajo që ata e quajnë “punë”. Edhe pse bibliotekat janë plot e përplot të mbushura me literaturë masonike, edhe pse të gjitha sekretet e saja janë publikuar, edhe pse kundërshtarët e kësaj vëllazërie e kanë përshkruar dhe janë munduar ta shpjegojnë këtë Lidhje me të gjitha mënyrat që kanë pasur në dispozicion, me fjalë, me shkrim, me foto e me filmime, ata prapëseprapë nuk kanë mundur kurrë ta zbulojnë këtë Lidhje. Me Muratorinë e Lirë është si me dashurinë apo me udhëtimet nëpër vende të ndryshme. Që t’i kuptosh sa më mirë, duhet t’i përjetosh vetë njëherë.

Kjo gjë i shpjegohet Kërkuesit që me hyrjen e parë të tij në Odë. Atij i bëhet e qartë se Muratoria e Lirë nuk ka asnjë lloj sekreti tjetër përveç simboleve dhe shenjave të saja dalluese. Prapëseprapë ajo shpeshherë shikohet si një lloj feje zëvendësuese apo si një shkollë filozofie. Ajo nuk është asnjëra nga këto.

Secila fe i ka të përcaktuara bazat e besimit të saj, që duhet t’ju përmbahesh, por mbi të gjitha duhet të besosh në to. Në të shumtën e rasteve, fetë janë krijuar mbi shpalljet hyjnore, ofrojnë misteret dhe njëkohësisht administrojnë sakramentet e tyre. Fetë njohin viktimat, lutjet, mëkatet dhe rrëfimet. Ato gjithashtu njohin pelegrinazhet, shenjtorët dhe mrekullitë. Por, vendimtare është që ato njohin edhe dogmat, të cilat besimtari duhet t’i ndjekë me përpikërinë më të madhe. Fetë që besojnë në një Zot të vetë, si Judaizmi, Kristianizmi dhe Islami i kanë marrë shpalljet e tyre nga shkrimet e shenjta hyjnore, që janë fjalët e Zotit. Këto shkrime të shenjta, janë për Muratorët e Lirë, dëshmi të nderuara të traditave të mëdha. Muratoria e Lirë nuk ofron mistere.



---

Tri shkallët e Muratorisë së Lirë nuk duhet të kuptohen apo shikohen si një lloj transformimi që ndodh sa herë që ngrehesh në shkallën tjetër. Tri shkallët më tepër simbolizojnë punën që çdo Murator i Lirë bën me veten e tij, punë e cila zgjat deri në fund të jetës së tij. Njeriu mëson deri në grahmat e fundit të jetës së tij. Parapërgatitja për vdekjen është qëllim i përsosmërisë dhe kjo gjë theksohet në të tri shkallët. Si rrjedhojë e kësaj mund të thuhet, që Muratoria e Lirë është një shkollë për jetën dhe një parapërgatitje për vdekjen, dhe në momentin që e humbet frikën rreth kësaj, e shikon këtë si një fenomen natyror, gjithmonë duke pasur parasysh rrugën tënde drejt përsosmërisë, drejt perfeksionit. Pra siç shihet, parapërgatitja për vdekjen, është një nga qëllimet e rëndësishme të Muratorisë së Lirë, që do të thotë që Muratori mundohet të hedhë spirancën e tij në gjithësinë kozmike ose të bëhet pjesë e saj.

Megjithatë Muratoria e Lirë nuk ka zhvilluar kozmogoninë<sup>36</sup> e saj. Edhe në këtë aspekt, ajo i ka lënë fushë të lirë veprimi, ndjenjave dhe kërkesës për dije të secilit nga ne. Ajo është e hapur kundra të gjitha shkencave dhe ju sugjeron të gjithë anëtarëve të saj, që të merren me shkencë. Kjo gjë ndodh edhe gjatë ligjëratave e referateve gjatë punës në tempull. Sa më tepër vëllezër kreativë e intelektualë ka një Odë, aq më interesante e aq më të larmishme janë temat që trajtohen në të. Ka Oda që në përbërjen e tyre kanë shkencëtarë, artistë, shkrimtarë, arkitektë e muzikantë të rangjeve të larta, dhe që janë pjesë e elitave në disiplinat e tyre.

Mënyra më e mirë për t'ua bërë njerëzve sa më interesante Muratorinë e Lirë është duke përmendur emrat e anëtarëve të saj më të famshëm, duke vërtetuar në këtë mënyrë famën dhe nderin e kësaj shoqërie. Unë jam i mendimit që Muratoria e Lirë duhet ta ndjejë veten shumë krenare, që personalitete të tilla me famë botërore, e kanë ndjerë veten shumë mirë në radhët e saja.

---

<sup>36</sup> Nga greqishtja κοσμογονία, që do të thotë lindja e botës

---

Duhet të theksojmë gjithashtu faktin, që Muratoria e Lirë nuk është shkollë filozofie, në kuptimin e një sistemi të mirëfilltë, të mirë formuar e të mbyllur filozofik. Ajo nuk zotëron ndonjë sistem që të zhvillohet brenda tij pa kundërshtime. Si “shkencë urtësie” që është, Muratoria e Lirë ju ofron anëtarëve të saj këndvështrime të ndryshme filozofike. Muratoria e Lirë nuk është ndonjë institucion që është kundër ndonjë feje apo ndonjë filozofie ekzistuese. Pra ajo nuk është kundër institucioneve. Ka pasur periudha që qëndrimet e saja ishin kundër katolicizmit, sepse ato vetë ndiqeshin nga kisha katolike. Por, ia vlen të përmendet se që nga koncili i dytë i Vatikanit, ekziston një lloj vetëpërbajtje nga të dyja palët. Gjatë këtij koncili, kisha katolike largoi nga Codex Iuris Canonici (CIC) mallkimin që kish shprehur në të ndaj Muratorëve të Lirë.

Një ditë përpara se vendimet e këtij koncili të hynin në fuqi, Papa Benedikti i XVI, në atë kohë kardinal dhe drejtuesi i kongregacionit në Vatikan, ishte i mendimit se çdo katolik që është bërë Murator i Lirë, jeton në mëkat. Pavarësisht nga kjo, asnjëra nga Obedienat në mbarë botën nuk ka përkufizime mbi pranimin deri sa këto përkufizime nuk kanë të bëjnë me bindjet fetare.

Në këtë kontest ia vlen që të flasim pak edhe për mbajtjen sekret, apo mbulesën, e të qenit Murator i Lirë. Çfarë nënkupton të jesh i “mbuluar”? Secili Murator e ka të drejtën që të prononcohet publikisht mbi anëtarësinë e tij në këtë vëllazëri. Gjatë ceremonisë së pranimit kërkohet prej tij që të ruajë fshehtësinë dhe të mos ia tregojë askujt emrat e vëllezërve të tij. Kjo mënyrë sjellje i ka nxjerr namin e keq kësaj vëllazërie si të qenit një Lidhje e fshehtë e sekrete. Kjo nuk është aspak e vërtetë. Si Odat në vetvete, ashtu edhe Kryeoda janë shoqata të regjistruara pranë organeve kompetente të shteti ku ekzistojnë. Kryetarët, sekretarët dhe arkëtarët e tyre janë zyrtarisht të regjistruar. Lutja që ta ruajnë fshehtësinë ka të bëjë vetëm me faktin që ata këto tre shekujt e fundit janë përndjekur si heretikë nga kisha

---

katolike, dhe aty këtu akoma mund të kenë probleme nëse merret vesh anëtarësia e tyre në këtë Lidhje. Akoma ekzistojnë fanatikë, të cilët janë të mendimit se Muratoria e Lirë është një konspiracion mbarëbotëror. Ne tashmë e dimë që ajo është një konspiracion për të mirën.

---

## Gjeneza e normave të moralit

Shumica e njerëzve janë të mendimit, që normat e moralit absolut nuk mund të ekzistojnë pa religjionet. Dhe i bie që ai që nuk është i lidhur pas ndonjë konfesionit fetar, të jetë njeri pa Zot apo njeri i pamoralshëm. Prindërit dhe edukatorët besojnë që edukatën e mirë dhe mirësjelljen për fëmijët e tyre mund t'i arrijnë vetëm nëse janë anëtarë të një besimi të caktuar fetar. Teologët dhe udhëzuesit e ndryshëm fetarë, mundohen që të vërtetojnë, që pa kuptuar qenien e Zotit, nuk është e mundur të kuptosh domethënien e normave të moralit. Ka shumë të ngjarë, që si koncepti mbi ekzistencën e Zotit ashtu si dhe normat e moralit, të jenë krijuar paralelisht.

Le të mbështetemi për një çast tek urtësia e gjuhës sonë. Fjala “mall” ka si kuptim atë që ndjen për dikë apo për diçka, “më ka marrë malli”, “më merr malli”, “e kam për mall” etj. Por, njëkohësisht ka gjithashtu kuptimin mbi mallin si pronë tënden, plaçkë, prodhim apo pronë e jotja. Përshkrimet apo sqarimet e fjalëve mund të na udhëzojnë të shpjegojmë gjenezën e normave të moralit. Fjala “mall” në të njëjtën kohë nënkupton edhe pronësi edhe një ndjenjë njerëzore. Kur ke mall për dikë, kur dikush të mungon, je në gjendje të bësh shumë për të, dhe kur e takon, në shenjë gëzimi ndaj tij apo saj i dhuron diçka nga vetja. Kjo mund të jetë një ndjenjë, por mund të jetë edhe një mall (dhuratë) nga “malli” yt. Marrëdhëniet ndërmjet familjeve të para njerëzore ishin të bazuara mbi rregulla të cilat kishin të bënin me shqetësimet mbi gjetjen e ushqimit, mbrojtjen nga koha e keqe, ndërtimin e një strehe mbi kokë, rritjen e fëmijëve, mbrojtjen nga kafshët e egra apo mbrojtjen nga grupet rivale. Zhvillime të tilla kanë lënë gjurmë në gjuhët që përdorim. Të gjithë e kishin pak a shumë të nevojshme që të shprehnin gjërat që mendonin. Me anë të gjuhës filluan të dallonin të mirën nga e keqja, të këndshmen nga e pakëndshmeja, gjërat që ju duheshin nga ato që s'iu hynin fare në punë. Ato e bënin këtë në mënyrë subjektive. Të

---

gjitha ndodhitë e përjetimet i thithin në vetvete, dhe më pas, dalëngadalë nën ndikimin gjithmonë e në rritje të altruizmit (ky ndikim ka shumë të ngjarë që të këtë ardhur si rrjedhojë e dashurisë nga nëna), filluan të mbanin një lloj qëndrimi të vakët egoist.

Studiuesit pesimistë janë nga ana tjetër të mendimit se në epokën e gurit njeriu i hershëm ka qenë më tepër një majmun i zbuluar, një bishë mishngrënëse, pra me fjalë të tjera një lloj individ i dhunshëm. Paleontologët, besojnë që kanë arritur të zbulojnë se si homo sapiensi, si homo erectusi e si neandertaleri të kenë jetuar krah njëri-tjetrit apo pothuajse në të njëjtën kohë.

Ndryshimi ndërmjet të mirës dhe të keqes, ndërmjet të drejtës dhe të gabuarës, ndërmjet të përdorshmes dhe të papërdorshmes u zhvillua në bashkëpunim me gjuhën, që do të thotë me zhvillimin e trurit të madh.

Sa më shumë që një bashkësi njerëzore largohej nga një bashkësi shtazore, aq më shumë kjo bashkësi përsoste aftësitë e saja përgjithësuese.

Mund të merret shume mirë me mend, që përpara disa mijëvjeçarëve sendet, kafshët, bimët, gurët apo në një farë mënyre, mënyrat e sjelljes së anëtarëve të tjerë të klanit, vlerësoheshin sipas situatës së rastit. E gjithë bota dhe mjedisi ku jetonin paraardhësit tanë, ishte një konstrukt karakteresh e substancash jashtëzakonisht të ndryshme, qofshin këto të gjalla apo pa jetë. Vetë ata, paraardhësit tanë, endacakë e në të njëjtën kohë banues të këtij mjedisi kaq të vështirë, bënë përpjekjet më të mëdha për të kaluar nga ky ambient shtazarak në një ambient njerëzor. Ndryshimet gjenetike, rastësia apo përshtatja, i lejuan kësaj qenie defektoze, që nuk ka as kthetra e as flatra, e që nuk mundet të vrapojë shpejt, e që i duhet të bëjë armë

---

për të mos u zhdukur komplet, të jetë njëkohësisht shumë e pafuqishme por në të njëjtën kohë shumë krijuese.

Kjo qenie e pajisur me trurin e madh është në gjendje të zhvillojë ndërgjegjen. Njëkohësisht të zhvillojë kujtesën, fantazinë, memorien dhe intuitën në një masë shumë më të madhe se sa kafshët dhe të ketë kreativitetin dhe fuqinë imagjinuuese, që i mundësojnë të këtë pjesën e tij në atë që ne e kemi quajtur intelektin hyjnor.

Normat e sjelljes se njeriut, gjithashtu mund të jenë krijuar thjeshtë nga marrëdhëniet materiale ndërmjet njerëzve dhe mund të shpjegohen edhe në këtë kontekst. Në rrjedhën e mijëvjeçarëve të ndryshëm familja apo grupi, grumbullonin përherë e më shumë pronësi, çfarë e bënin njeriun të ndjehej mirë.

Ka shumë të ngjarë, që me grumbullimin e pasurisë të krijohet dhe morali. Këto rregulla mbi moralin u shumëfishuan aq shumë, saqë ishte e nevojshme lindja e normave të moralit. Mund të themi që këto norma akoma gjenden në moshën fëmijërore dhe do të duhet akoma shumë kohë që të bëhen ligje të vërteta. Me fjalë të tjera, të bëhen norma përcaktuese të jetës sonë.

Ideja që normat e moralit mund të jenë zhvilluar edhe pa imagjinatën e Zotit, është e mundur. Nga ana tjetër ka mendime, që besimi dhe imagjinata që ka vetëm një Zot të vetëm ka ekzistuar që në fillimet e para të njerëzimit. Gjithashtu dimë që kanë ekzistuar e ekzistojnë totemët, shamanët, magjistarët, gurutë e shumë grupe të tjera të llojit të tyre.

Por nismëtarëve të feve të ndryshme, të cilët pretendonin të ju jetë shfaqur Zoti, shumë shpejt arritën ta kuptojnë se një shoqëri sociale e kishte shumë të vështirë të ndiqte normat e moralit, pa vënë në përdorim sanksione të ndryshme. Ne kemi njohuri mbi një kolonë

---

të mbishkruar, që mendohet t'i përkasë Hamurabit dhe ku janë të shënuara të gjitha veprat e këqija dhe krimet dhe dënimet që duhen dhënë për to.

Këtë katalog gjithëpërfshirës e zëvendësuan më vonë me dy rrasa me dhjetë urdhëresa, të cilat ju dhanë Moisiut në malin e Sinai nga Perëndia. Në njërën nga këto rrasa, në atë të majtën, gjendeshin tri urdhëresa, që kishin të bënin me autoritetin e vetëm ekzistues, me një Zot, emri i të cilit nuk dihej. Më anë të kësaj, Moisiu krijoi autoritetin e duhur, me të cilin ai shpresonte t'i bashkonte të gjithë hebrenjtë në një trung të vetëm, pasi ata ishin shumë të shpërndarë pas largimit të tyre nga Egjipti. Shtatë urdhëresat e tjera në rrasën tjetër të gurtë shpjegonin marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin. Këto shtatë urdhëresa, nuk janë gjë tjetër veçse, normat e moralit njerëzor, që natyrshëm gjenden te të gjithë njerëzit e kësaj bote dhe që ndiqen nga njerëzit, duke pasur si qëllim krijimin e harmonisë me njëri-tjetrin.

Metoda e feve të mëdha ka qenë dhe është, që këto norma të moralit njerëzor t'i dogmatizojë dhe t'i lidhë sa më shumë me besimin që e kanë njerëzit tek Zoti. Në të njëjtën kohë, me anë të këtyre praktikave, fetë i frikësojnë e ju fusin tmerrin besimtarëve të tyre. Zoti i vetëm ekzistues, Zot në të cilin besojnë si hebrenjtë, si kristianët e si myslimanët, është kthyer në një gjykatës mbarëbotëror që vetëm dënon e hakmerret. Sipas tyre, shpërblimin njeriu do ta marrë në botën tjetër. Dobësia e të gjitha feve të mëdha mbarëbotërore qëndron në faktin, që nuk kanë qenë kurrë në gjendje, e nuk janë akoma, të zvogëlojnë pak a shumë potencialet agresive të besimtarëve të tyre. Megjithëse po flasim për një periudhë 5000 vjeçare të historisë fetare, kurrë nuk është bërë i mundur eliminimi i luftërave të ndryshme si ndërmjet feve të ndryshme ashtu edhe ndërmjet besimtarëve të të njëjtës fe. Nuk e teprojmë po ta themi, që pretendimet e feve mbi zotërimin e diturisë absolute, misionet e tyre

---

fanatike, inkuizicionit e çmendura të tyre, të kenë ushqyer të keqen tek njerëzit apo ta kenë nxjerrë atë në sipërfaqe. Këto mendime nuk mënjanojnë aspak domosdoshmërinë e pakundërshtueshme të feve. Në natyrë nuk ekziston as e keqja as e mira. Ato marrin format e tyre në momentin kur ndodh konfrontimi me njeriun. Shekuj me radhë, njerëzit besonin në polaritetin e ditës me natën, dritës dhe errësirës, të mirës dhe të keqes, fenomeneve që ato nuk mund t'ju largoheshin. Një nga religjionet e para të kësaj bote, feja e Zaratustrëvë, projektoi perandorinë e errësirës, perandori të cilës i kundërvihet perandoria e dritës. Ahriman luftonte kundër Omucit – errësira kundër dritës. Njeriu ishte i pafuqishëm ndaj këtyre forcave. Ishte Perëndia Mitras e para që ia mundësoi njeriut të dilte nga pasiviteti në të cilin kishte rënë. Mitras, si Perëndia e Diellit që ishte, jo vetëm që e luftonte errësirën, do të thotë të keqen, por i kërkoi njeriut që të ishte në krah të saj e ta ndihmonte në këtë luftë që po bënte. E njëjta gjë është edhe me fenë egjiptiane të Osirisit, që i mbijetoi kohës për tremijë vjet me radhë. Po e marrim parasysh që themeluesit e feve, dijetarët e tyre, të përndriturit të cilëve iu dha shpallja hyjnore, gjithmonë kishin në konsideratë se marrëdhëniet sociale të besimtarëve të tyre mund të rregulloheshin vetëm nëpërmjet rregullave të etikës e të moralit.

Siç duket, prania e shumë feve është njëkohësisht pasuri dhe fatkeqësi për njerëzimin. Ndoshta nuk është ide e keqe ideja sikur të kishte pasur vetëm një fe të vetme për të gjithë botën. A do të kishte qenë një diçka e tillë një avantazh apo një disavantazh për botën, këtë s'mund ta marrim me mend. S'na mbetet gjë tjetër veçse të pranojmë ekzistencën dhe shumëllojshmërinë e besimeve të shumta fetare në këtë botë.

Siç u tha edhe më sipër, në anën tjetër tyre qëndrojnë normat morale natyrore të njerëzimit, që janë të njëjta në të gjithë botën dhe që të gjithë njerëzit e ndjejnë vetën të detyruar që t'iu përmbahen. Është e vështirë të përcaktosh proceset e zhvillimit të moralit për



---

periudha të gjata kohore, por nga ana tjetër ato ndodhin në çdo kohë në brendësinë e secilit prej nesh. Në Muratorinë e Lirë kanë vendin e tyre besimtarët e të gjitha feve dhe sa më shumë të thellohen në këtë Lidhje, aq më fortë do të ankorohen rreth besimit të tyre.

Unë gjithashtu mendoj se edhe në fushën e moralit ka tendenca drejt përsosmërisë, drejt perfeksionit. Gjithmonë në momentin që arrihet një lloj balance pak a shumë e qëndrueshme, ndodh rikthimi, nga i cili nisemi sërish drejt arritjes së harmonisë përfundimtare. Muratori Erih Kestner (Erich Kaestner) thoshte: “E mira s’ekziston, atë vetë ti e krijon”. Sipas Sokratit, është Daimoini, apo zëri i brendshëm, ai që jep alarmin, kur njeriu bën një veprim të keq. Por kur njeriu ia arrin që të bëjë diçka të mirë, Daimoni nuk thotë asgjë.

Përherë dhe gjithandej gjendemi në të njëjtat situata: Si të veprojmë? Të veprojmë drejt apo të bëjmë kundërtën? Gjithmonë behët fjalë që të vendosim për të mirën, për të drejtën e për të bukurën.

Një pyetjeje pothuajse të pazgjigdhur akoma si kemi dhënë drejtim. Pse ndodh e keqja në këtë botë, pse ka njerëz të këqij, pse ka veprime të këqija, apo e thënë ndryshe, pse ekziston e keqja? Teologët dhe krijuesit e feve të ndryshme kanë gjetur një rrugë shumë praktike për t’iu përgjigjur kësaj pyetje. Sipas tyre, Zoti s’ka të bëjë farë më të keqen, ai është i përkryeri, më i miri, më i drejti e më i bukri.

Mos përzierja e Zotit me të keqen të lë të kuptosh, që kjo botë na qenka krijuar nga një lloj Nën-Zot apo një lloj Krijuesi që i paskan ndodhur gjithë ato gabime gjatë punës, gabime me të cilat Zoti s’ka pasur fare të bëjë. Nga ana tjetër, njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Zotit, bie në mëkate, bën veprime të këqija, për të cilat më vonë dënohet, dënim që e merr në këtë botë apo në botën tjetër. Meqenëse Zoti është shumë bujar, atëherë ai duhet ta çlirojë njeriun nga

---

mëkatet e tij, në momentin që njeriu vdes, do të thotë, që sakrifikon jetën me vdekjen e tij ose të korruptohet nga lutjet dhe sakrificat që bën njeriu për nder të tij.

Siç duket, fetë ë mëdha e kanë gjetur më kollaj që të gjitha mëkatet e të këqijat e kësaj bote t'ia ngarkojnë në kurriz njeriut, duke pretenduar, që njeriu nga natyra dhe nga sjelljet e tij është mëkatar. Ky lloj shpjegimi, që vetëm njeriu na qenka burimi i së keqes e i mëkateve, na bënë që të jemi vazhdimisht në një tension të përditshëm duke pyetur pa fund veten, çfarë kam bërë mirë e çfarë kam bërë keq sot, që edhe kur mundohemi të bëjmë diçka mirë mund të na dali për të keq. Dhe në rastet më ekstreme e personifikojmë të keqen me dreqin.

Nëpërmjet edukimit që marrim në jetë dhe nëpërmjet zakoneve e traditave që kemi, na është rrënjosur në mendje, që e ashtuquajtura “e keqe” ekziston. Po ta shikojmë më vëmendje këtë lloj diskutimi që bëmë deri më tani, arrijmë në përfundimin që veprimet tona ditore, përbëjnë në vetvete një proces shumë të ndërlikuar, që nuk do t'i kuptonte apo shpjegonte dot as mendja më e mprehtë. Duke u bazuar në këtë lloj logjike i largohemi përherë e më shumë ekzistencës së të mirës apo të keqes. Fridrih Niçe (Friedrich Nietzsche) ka shkruar një ese të shkëlqyer mbi këto fenomene me emrin: “Përtej të mirës e të keqes” (Jenseits von Gut und Boese). Nuk është patjetër e thënë që të jesh dakord më sugjerimet dhe konkluzionet e tij, por mund të arrish vetë në përfundimin, që edhe në moral mund të arrihet në perfeksionim. Në këtë rast, skeptiku do të thotë, që e keqja nuk mund të shkulet kurrë nga brendësia e njeriut, që në çdo kohë ka pasur e do të ketë krime dhe vrasje, deri në krime e vrasje të pafalshme, luftëra e gjenocid.

A është e mundur që të përputhen me njëra tjetrën, teoria jonë e perfeksionit të vazhdueshëm të njeriut me realitetin ekzistues të së

---

keqes? Kjo është njëkohësisht një pyetje sa psikologjike aq sa dhe teologjike, me të cilën janë marrë dijetarë të shumtë për shekuj me radhë. Teologët mbrojnë Zotin, i cili në mënyrë të pashpjegueshme lejon që të ndodhë e keqja, ndërsa filozofët shtrojnë pyetjen, se si mund të arrihet në krijimin e një sistemi harmonie, ku e mira dhe e keqja të jetojnë përbri njëra-tjetrës. Dyshimet e lartpërmendura dalin në sipërfaqe, vetëm në momentin kur procesin e krijimit të kësaj bote e shikojmë si proces të përfunduar. Në qoftë se mendojmë ndryshe, dhe procesin e krijimit të kësaj bote e shikojmë si një proces në zhvillim e sipër, një proces që është akoma shumë larg finalizimit të tij e që vazhdimisht ka nevojë të punohet në të me një punë të bazuar në harmoni e në rregull, e që nga ana tjetër ekziston vazhdimisht rreziku i dështimit dhe kjo edhe ndodhë, por edhe kur kjo ndodhë ia nisim përsëri nga e para rrugës drejt perfeksionimit, atëherë e kemi më lehtë ta shpjegojmë, e deri në një farë mase dhe ta kuptojmë, ekzistencën e të mirës e të keqes në këtë botë. Dështimet që na ndodhin, përfshirë këtu dhe ato që i mendojmë për mirë e na dalin për keq, mund të shpjegohem me shumëllojshmërinë e aktiviteteve njerëzore, që vazhdimisht jo vetëm ndërthuren por edhe përplasen me njëra-tjetrën, e si rrjedhojë, njeriu për të dalë nga ky labirint mundohen që të ndjek fillin e Ariadnës.<sup>37</sup>

Le të kthemi pas tek morali: Porosia kryesore e normave të moralit për njerëzit është shumë e thjeshtë dhe përbehet nga katër fjalë. Këto fjalë Mahatma Gandhi i kish marrë nga babai i tij hinduist, e që janë: “Mos i bëj keq askujt”.

Nga kjo tezë qendrore e moralit, rrjedhin të gjitha mënyrat e tjera të sjelljes, mënyra që përmbledhin të gjitha normat e moralit të

---

<sup>37</sup> Sipas mitologjisë Greke, Princesha Ariadna, vajza e mbretit Minos, i dhuroi një fill Tesusit të cilin e kishin futur në një labirint ku gjendej dhe Minotaurusi. Tesusi pasi vrau Minotaurusin, duke ndjekur fillin arriti të dilte përsëri nga labirinti

---

të gjithë popujve të civilizuar. Nuk ka urdhëresë apo rregull fetar që t'ia kalojë këtij ligji të moralit.

Kjo është një bindje e imja dhe unë jam shumë i vetëdijshëm që jo të gjithë Muratorët e Lirë mund të jenë të të njëjtit mendim. Brenda për brenda sistemit muratorik, i cili nuk njeh dogma, secili gëzon lirinë e tij që t'i interpretojë gjërat sipas bindjeve të tij.

Ne si pjesëtarë të racës njerëzore, e cila ka 250 mijë vite që e ka populluar këtë planet, akoma nuk kemi mësuar se si mund të ndikojmë në katastrofat natyrore që ndodhin. Tajfune, hurrikanë, tërmete, stuhi, vullkane, thatësira dhe përmytje janë jashtë kontrollit të ndikimit njerëzor. Ne si qenie njerëzore jemi të pafuqishëm ndaj tyre. Sapo kemi filluar të mendojmë e të ndërtojmë strategji mbi luftën kundër katastrofave klimatike që ndodhin. Është e vërtetë që natyra me forcat e saj i ka sjellë njerëzimit vdekje, mjerim e shkatërrime të pafundme, por kjo nga ana tjetër nuk legjitimon që edhe ne të bëjmë të njëjtën gjë.

Revolucionari francez Louis-Antoine-Léon de Saint-Just tentoi që ekzekutimet e anëtarëve të opozitës me prerje koke përmes gijotinës, t'i arsyetonte duke marrë shembullin e natyrës. Në një fjalim të famshëm të tij ai pat thënë, që kur natyra ia lejon vetes që të ushtrojë dhunë, pse jo dhe njeriut, i cili dëshiron të bëjë ndryshime, të mos i lejohet përdorimi i dhunës.

Udhëheqësit e drejtuesit e luftërave në historinë e deritanishme kanë bërë gjithashtu të njëjtën gjë, shpeshherë me ndërgjegje të pastër e të shtyrë nga ndjenjat patriotike. Kampet naziste të përqendrimit, si dhe pasojat e tjera që sjell lufta e kundërshtojnë këtë këndvështrim. Përderisa ti ja jep të drejtën vetes të bësh luftë, rregullat e së cilës nuk bazohen aspak mbi normat e moralit e të humanitetit, atëherë mund të themi që këtu kemi të bëjmë me një

---

moral të dyfishtë. Dhe mjerisht, ky moral i dyfishtë durohet ose shfrytëzohet në një masë të gjerë si nga shtetet ashtu edhe nga fetë.

Çfarë kanë të gjitha këto të bëjnë me Muratorinë e Lirë? Krahasuar me shtetet apo me fetë e ndryshme, ajo është një organizatë shumë e dobët, pa një udhëheqje centrale të vetme dhe pa ndikim në politikë. Megjithatë, në përmbajtjen e saj gjenden mjetet që ndihmojnë në kapërcimin e këtij morali të dyfishtë. Përderisa Muratoria e Lirë i përjeton parimet dhe principet e saja, ajo gjithashtu është në gjendje të ndryshojë botën.

Filozofi Imanuel Kant (Immanuel Kant), me anë të imperativit kategorik, na e ka treguar rrugën që duhet të ndjekim: “Vepro vetëm sipas asaj maksime, që në të njëjtën kohë do të dëshiroje, që të bëhej ligj për të gjithë njerëzimin”.

---

## Simbolizmi Universal

Sipas hulumtimeve e njohurive tona të deritanishme, mendohet që njeriu është e vetmja qenie frymore, që e din se duhet të vdesë. Si pasojë e kësaj ndërgjegje njeriu është vazhdimisht në kërkim të zgjidhjes së kësaj të panjohure. Ka qenë një rrugë shumë e gjatë, nëpër të cilën duhet të kalonte njeriu, deri sa arriti të besojë, që jeta e tij vazhdon edhe pas vdekjes së tij. Jetë, që sipas tij, vazhdon në botën tjetër. Pothuajse në të gjitha kulturat gjenden varreza, ose ndërtime monumentale siç janë për shembull piramidat, që janë ndërtuar për të siguruar mbijetesën në botën tjetër. Në të shumtën e rasteve, të vdekurve u jepeshin me vete zbukurime, vegla pune, ushqime e sende të tjera. Në rastet kur bëhej fjalë për njerëz të plotfuqishëm si mbretër, perandorë apo faraonë, ata varroseshin së bashku me gratë, shërbëtorët e kuajt e tyre. Hapat që janë bërë nga varrimi në tokë e deri tek djegia e kufomës, janë një lloj revolucioni në mënyrën e të menduarit të njerëzve. Varrimi në tokë premtonte një lloj mbijetese. Disa fe të ndryshme shkojnë akoma më tej duke premtuar ringjalljen me anë të varrimit në tokë, nga ana tjetër, djegia e kufomës zhdok të gjithë organizmin, dhe në këtë rast mund të pritet vetëm një mbijetesë shpirtërore ose frymore, pra që shpirti apo fryma të jetojë më tej. Të gjitha mitologjitë dhe fetë ekzistuese sillen rreth këtij fenomeni real, por njëkohësisht të pashpjegueshëm të vdekjes. Është më se i pranuar fakti, që për njerëzit e lashtë, vrasja e kafshëve duhet të ketë qenë një lloj përjetimi emocionues, një akt, për të cilin ato në të shumtën e rasteve kërkonin edhe falje. Edhe në kohët e sotme gjahtarët e kanë ruajtur këtë traditë, që pasi e kanë vrarë kafshën bëjnë bekimin mbi të. Ky është një gjest pajtimi, që duhet të ketë lindur si një ndjenjë e bashkëjetesës dhe në shenjë respekti ndaj të gjitha qenieve ekzistuese në mjedisin që na rrethon. Ekziston një shprehje e bukur indiane, ku thuhet: "Shpirti flenë në gurë, në bimë ëndërron, në kafshë zgjohet dhe tek njeriu zotëron veprimet e tij". Edhe pse në pamje të parë na duket sikur fenomenet në këtë botë

---

kundërshtojnë vazhdimisht njëra-tjetrën, si për shembull dita e nata, i nxehti e i ftohti, uria, etja e ngopja, ndarja e gjinisë njerëzore në burrë e grua, fenomene që duhet të kundërshtojnë njëra-tjetrën, se fundmi jeta e vdekja, po aq e madhe është nevoja dhe dëshira e njeriut, për t'i kapërcyer këto pole të kundërta.

Pothuajse është një përjetim mistik kur imagjinon që të gjitha këto janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Mbi një tabelë të famshme egjiptiane – tabela e smaragdinës – gjendet e shënuar kjo shprehje misterioze: “si lartë poshtë, si poshtë lartë”. Kjo shprehje është bërthame e atyre këndvështrimeve që zhvillojnë vazhdimisht simbolizmin universal.

Sapo përmbush domosdoshmërinë e tij primare të mbajtjes së vetvetes, njeriu fillon të shikojë rreth e rrotull tij se ç'mund të bëjë diçka tjetër. Fillon të shenjtërojë ndonjë pemë, të nderojë ndonjë gur, kafshë të veçanta si totem i bën të shenjta për fisin e tij, vëren ndryshimet ndërmjet të mirës e së keqes, të dëmshmes e të dobishmes. Që nga lashtësia ekziston mendimi, që në një farë mënyre të gjitha sendet, kafshët dhe njerëzit varen nga njëra-tjetra ose tërheqin njëra-tjetrën. Dëshira për të qenë në unitet me njëra-tjetrën, ose të paktën parandjenja për këtë lloj uniteti, duhet të jetë zhvilluar që në kohët e hershme. Pra që në këto kohë shumë pjesë të mjedisit ku ne jetojmë, kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme me njëra-tjetrën. Në qoftë se kafshët na paskan qenë origjina ose perënditë mbrojtëse të njeriut, bimët apo pemët na qenkan të shenjta, atëherë duhet të pranojmë që e gjithë bota qenka në një lidhje të brendshme të ndërsjellët, lidhje e cila në mënyrë të pavetëdijshme, garanton siguri për të gjithë. Çdo gjë mund të bëhet simbol për çdo gjë tjetër. Të jetë një simbol i mbijetesës pas vdekjes, një simbol i pjellorisë, një simbol i ringjalljes, një simbol i fatit apo një simbol i vdekjes. Kjo lloj tendence e njeriut, që dëshiron ta shohë botën si një unitet të pandarë, ka çuar në krijimin e konceptit të kozmosit,

---

koncept që i ka rrënjët e tija në klasicizmin grek. Natyrisht që në rrugën drejt përsosmërisë takohen fenomene nga më të ndryshmet, duke filluar që nga shamanizmi, kult ku të përzgjedhurit hyjnë në një gjendje ekstaze, duke krijuar përjetësime të veçanta, e që shikohen nga anëtarët e tjerë të këtij kult si profetë, si falltarë apo dhe si udhëheqës, e deri tek shoqëri sekrete si ajo e Pythagorianëve, të cilët patën krijuar një urdhër, ku mësonin artin e përlogaritjeve dhe mbanin sekret mënyrën e tyre të të jetuarit.

Dituria jonë është zhvilluar në rrjedhën e mijëvjeçarëve që kanë kaluar. Dituri e cila ka të bëjë si me botën në tërësi ashtu edhe me mjedisin që na rrethon. Rezultatet e ndryshme që janë arritur ose kanë qëndruar ashtu siç kanë qenë, ose janë tejkaluar nga rezultat e mëvonshme të arritura. Por nga ana tjetër asgjë nuk ka humbur nga ndërgjegjia kolektive e njerëzimit. Sot ekziston një numër i pafundmë librash ezoterikë, që na tunden para syve njohuritë rreth fenomeneve misterioze, njohuri të cilat janë të shpërndara në çdo cep të rruzullit tokësor. Të gjitha këto njohuri do t'i quaja një lloj pluhuri që është ngritur gjatë proceseve për përfitimin e njohurive shkencore, e që si përfundim nuk i ka hyrë në punë askujt. Nga ana tjetër, nuk mund ta përgënjeshtrojmë ndjenjën e lashtë të njeriut, që në një farë lloji e mënyre enigmatike, të gjitha gjërat janë në varësi të njëra-tjetrës, por që ne nuk jemi në gjendje të shikojmë e kuptojmë të gjitha shkaqet dhe pasojat e tyre.

Bota si e tërë është një mrekulli e pakuptueshme për ne njerëzit, dhe gjatë gjitha kohërave dijetarë e mendimtarë, fetarë e filozofë janë munduar t'ia bëjnë të kuptueshme njerëzimit këtë lloj mrekullie. Si rrjedhojë e kësaj janë krijuar dy rryma kryesore të të menduarit. Njeriu që mendon në mënyrë racionale, dhe që mundohet të shpjegojë gjithçka në bazë të eksperimenteve nga disiplinat e pafundme të fushave të shkencave të ndryshme. Me këto mënyra ai ka arritur të depërtojë deri në bërthamën e atomit e deri në bërthamën



---

e qelizës. Ai ka zbuluar njësitë matëse nano, njësitë matëse më të vogla të jetës e të mjedisit, mënyrën se si ato veprojnë, veprime të cilat i ka vënë në përdorim të jetës së tij. Përbri tyre janë fetë e mëdha, të cilat fenomenet e ndryshme që ndodhin në këtë botë i shpjegojnë me anë të mistikës e të shpalljeve hyjnore që iu kanë ardhur. Në shekullin e 19-të e më pas, bota filloi të zhvillohej me ritme shumë të shpejta. Nga kjo kohë vihet re një lloj shërr ndërmjet kishës katolike dhe shkencave në përgjithësi, shërr që është quajtur shërr i modernizimit. Kisha katolike shkoi aq larg sa që doli në armiqësi të hapur ndaj këtyre shkencave. Të njëjtën gjë bënë edhe shkencëtarët ndaj besimtarëve. Në ditët e sotme, ku shkencat natyrore dhe ato të besimit po i afrohen përditë e më shumë njëra-tjetrës, u arrit të kuptohet, që si besimi ashtu edhe dituria janë pajisjet themeltare të njerëzve.

Sa i përket Muratorisë së Lirë, ajo ua ka lënë vetë në dorë anëtarëve të saj, që të vendosin se në cilën nga këto rryma t'i drejtojnë interesat kryesore të tyre. Edhe në këtë Lidhje, këto dy rryma janë të pasqyruara. Praktikisht në çdo Odë ka vëllezër që tentojnë më shumë nga ezoterika, e ka gjithashtu nga ata që tentojnë më shumë nga ekzoterika. Këto terma ja vlen që të shikohen më nga afër. Muratori ezoterik nuk merret vetëm me jetën shpirtërore e intelektin e njeriut, por edhe me interpretimin e simboleve e riteve muratorike, me domethënien psikike të tyre si dhe me historinë e tyre.

Me Muratorin ekzoterik, nënkuptohen ato vëllezër, që i japin veçanërisht një rëndësi të madhe çështjeve sociale e humane. Njëkohësisht ekzoterikët e drejtojnë vëmendjen e tyre mbi të ardhurat materiale të kësaj bote.

Një Odë e vërtetë i udhëheq e i drejton anëtarët e saj në atë mënyrë që të mësojnë se si t'i bashkojnë të dyja, si anën shpirtërore të brendshme ashtu edhe anën racionale të të menduarit. Tek

---

simbolika universale do të arrijë vetëm ai, që mendon në mënyrë analoge për këto që u tha më sipër. Peizazhet, metaforat, alegoritë janë ndër të tjera materialet që përdoren nga shkrimtarët, dramaturgët e artistët. Simbolet universale, siç duket, kanë rrjedhur nga nevojat e lashta të njerëzve dhe njëkohësisht na janë bërë bazamenti i jetës tonë emocionale.

Në anën tjetër, arsyen – akoma më shumë logjikën – secili nga ne duhet që ta përvetësojë me shumë mund, ose siç thoshte Imanuel Kant-i (Immanuel Kant), njeriu duhet të çlirohet nga papjekuria e vetëshkaktuar. Kjo është një detyrë për secilin nga ne. Sipas mendimit tim, Muratoria e Lirë gjendet në një fazë të periudhës së dytë të përndritjes së mendjeve njerëzore (iluminizmit), fazë ku nuk bëhet fjalë vetëm se si të vëmë në përdorim arsyen e logjikën, por gjithashtu edhe se si të vëmë në përdorim “inteligjencën emocionale”, mirëkuptimin social e aktivitetet bamirëse.

---

## Kundërshtimet ndaj Muratorisë së Lirë

Pothuajse secili grupim në këtë botë ka armiqtë e tij, ose të paktën kundërshtarët e tij.

Jo vetëm kisha ka qenë kundërshtarë e Muratorisë së Lirë, sepse kjo i kundërshtonte strukturat feudale kishtare, por edhe nacional-socialistët, fashistët e komunistët e kanë luftuar këtë Lidhje, sepse Muratoria ka qenë e do të jetë gjithmonë kundër racizmit e kundër luftës së klasave.

Kundërshtarët e Muratorisë së Lirë kritikojnë faktin, që kjo si Lidhje misterioze burrash është marrë e merret me makinacione të errëta politike ose gjithashtu bën biznese pa përgjegjësi. Në historinë e saj shekullore padyshim që aty-këtu gjëra të tilla kanë ndodhur. Sipas mendimit tim, edhe sot e kësaj dite brenda për brenda kësaj Lidhje ka segmente që kanë nevojë për një përmirësim të vërtetë. Për shembull, vite me radhe ka qenë bërë zakon, që shtetasit afro-amerikanë të pranoheshin vetëm në Muratorinë e Princ Hall, sepse Kryeodat Amerikane të influencuara nga kristianizmi, refuzonin të pranonin zezakë në Odat e tyre. Për fat të mirë ky lloj diskriminimi po eliminohet dalëngadalë.

Gjithashtu është një përvojë shumë e dhimbshme për Muratorinë e Lirë, që në kultura e kombe të ndryshme po shfaqen dukuri, që kundërshtohen me forcë nga Muratorët rreptësisht humanitarë, si për shembull tradicionalizmi i tepruar.

Kundërshtime sipërfaqësore janë p.sh. akuzat mbi mënyrën e takimit të anëtarëve të kësaj Lidhje. Shumë veta janë të mendimit që Muratorët e Lirë takohen fshehurazi e mblidhen në vende të fshehta. Apo pyetja, çfarë nënkuptojnë ata kur thonë që “jemi në punë”. Disa

---

prej tyre, që nuk janë anëtarë të kësaj Lidhje ose që nuk janë pranuar në të, mundohen të shpifin kundër saj.

Më tutje, kundërshtarët e saj kritikojnë faktin që Muratorët e Lirë i zgjedhin anëtarët e tyre me anë të një përzgjedhjeje të veçantë, dhe si rrjedhojë jo çdokush mund të bëhet Murator i Lirë. Pretendimet, që kjo Lidhje bën makinacione të fshehta janë absurde, sepse Muratorët e Lirë janë njerëz autodidakt që merren me edukimin e vetes së tyre, njëkohësisht “detyrimet e vjetra” që janë pjesë e kushtetutës më të vjetër të Kryeodës Angleze, ndalojnë politikën ditore dhe mosmarrëveshjet fetare nëpër Oda.

Sigurisht që ndërmjet shumëllojshmërisë së marrëdhënieve ekzistuese vëllazërore gjenden edhe marrëdhënie të natyrës së biznes-bërjes. Hyrja në Muratorinë e Lirë për interes biznesi, do të thotë tentim për përfitim të paskrupullt dhe çon deri në përjashtimin nga Lidhja.

Gratë ankohen mbi pamundësinë e anëtarësimit të tyre në Lozhat e Kryeodat e rregullta. Për këtë mund të themi se detyra që i kanë vënë vetes burrat, pra vetedukimit të tyre, do të vështirësohej shumë me praninë e grave në Oda. Ndërkohë, përveç Obediencave të rregullta, pothuajse në të gjitha kontinentet gjenden gjithashtu Oda grash, që janë treguar shumë të suksesshme e të dobishme me punën që bëjnë për emancipimin e gruas. Ndërkohë, ato gjithashtu përforcojnë solidaritetin ndërmjet grave.

Një obsesion tjetër kundër Muratorisë së Lirë ka të bëjë me strukturat e larta sekrete udhëheqëse që sipas tyre kjo Lidhje duhet të ketë, struktura këto të cilat paskan si qëllim të krijojnë një lloj qeverie mbarëbotërore. Gabimi në këtë mes qëndron ndoshta në njohuritë rreth Ritit Skocez, rit i cili në hierarkinë e tij ka një organ me emrin “Këshilli i të lartëve”, organ që shtrihet e ka kompetenca

---

vetëm brenda Obediencës së vet. Përmbledhurazi mund të thuhet, që të gjitha Kryeodat e Globit janë të pavarura dhe nuk ekziston një lidhje hierarkike ndërmjet tyre.

Unë personalisht gjithashtu jam i mendimit, që nuk është aspak e nevojshme, që të gjitha Kryeodat e botës të jenë të barabarta apo të krijohet një njësi globale muratorike. Gjithashtu edhe këtu duhet të zbatohet parimi i tolerancës dhe në rastin konkret edhe brenda për brenda Kryeodave. Një bashkëpunim i gjerë ndërmjet Kryeodave të Evropës, një lloj platforme pune, është aktualisht duke u zhvilluar dhe sigurisht do të përforcojë me shumë marrëdhëniet ndërvëllazërore, veçanërisht më Kryeodat e Odat e reja të vendeve të Evropës Lindore.

Kundërshtarët e Muratorisë së Lirë ofrojnë një tjetër argument kundër kësaj Lidhje kur thonë, që Muratorët e Lirë e ndjejnë veten si elita e një kombi. Këtë përshtypje ta krijon pa dyshim Muratoria e Lirë kur nuk je pjesë e saj dhe kjo përshtypje përbën një problem në vetvete për të. Akoma më e rëndë është akuza, që në kontinentin evropian, në pjesën më të madhe të rasteve, anëtarët rekrutohen vetëm nga klasat e mesme e nga ato të larta dhe në radhët e Muratorisë së Lirë nuk gjenden pothuajse fare punëtorë, artizanë apo të ashtuquajturit “më pak të arsimuar”. Kjo vërejtje është me vend dhe pranohet nga shumica e Muratorëve të Lirë. Të habit fakti që në radhët e një bashkësie që u krijua nga artizanët, me kalimin e kohës, artizanët të mos gjenden më në të. Në pjesën më të madhe të Odave të Evropës, shumica e vëllazërve kanë të njëjtin nivel arsimit që vihet re edhe nga komunikimi verbal ndërmjet tyre.

Epiqendra e punës së një Ode qëndron në dialogun ndërmjet anëtarëve të saj, shkëmbimin e mendimeve të ndryshme, thellimin e njohurive dhe arritjen e një shkalle pjekurie të hapur nga sipër, pjekuri që së fundmi do të duhej të përfundojë në stadin e një urtësie

---

të përjetshme. A do të jetë e mundur që në të ardhmen të përfitohen shtresa të reja për Muratorisë së Lirë, duhet të jetë një çështje e hapur e kësaj Lidhje për momentin, por le të shpresojmë që do të ndodhë kështu. Fakti, që klasa tradicionale e punëtorisë përherë e më shumë po shpërbëhet, dhe mundësitë e arsimimit, pavarësisht nga standardi social, secili i ka të hapura, na bën të mendojmë e të shpresojmë që në të ardhmen shtresa të tjera të shoqërive tona do ta gjejnë hyrjen e kësaj Lidhje. E do të jenë jo vetë të mirëseardhura, por njëkohësisht të dyja palët do të përfitojnë nga njëra-tjetra.

---

## Muratoria e Lirë dhe Politika sqsuar me shembullin e Austrisë

Odat e Britanisë së Madhe, të krijuara që në shekullin e 17-të, gjithmonë kanë abstenuar në përzjerjen e tyre në politike apo në çështjet fetare. Vetëm duke u bazuar në këto kushte ia arritën qëllimit që të mblidhnin rreth vetes burra me prejardhje të ndryshme. Pas vitit 1717, kur Muratoria e Lirë filloi të shpërndahet në të gjithë Evropën, kushtet e sipërpërmendura u mbajtën, por në të vërtetë Odat arritën një farë rëndësie politike, që dua ta shpjgoj duke u bazuar në shembullin e shtetit perandorak të Austrisë.

Odat e shekullit të 18-të ndryshonin nga shoqëritë e mëhershme, pasi brenda sistemit feudal ekzistues, përfaqësonin për herë të parë hapësira të lira demokratike, ku shteti edhe kisha ose nuk i kontrollonin dot ose kishin vështirësi shumë të mëdha ta bënin diçka të tillë. Borgjezia ambicioze dhe pjesa progresive e aristokracisë formuan një lloj elite që ishte njëkohësisht edhe elitë intelektuale dhe elitë morale, anëtarët e së cilës jo vetëm formuluan përmbajtjen e reformave politike e sociale të Evropës qendrore, por edhe i vunë në zbatim këto reforma.

Aktiviteti i Muratorëve të Lirë ishte aq shumë i frytshëm, sa që si në shtetin perandorak ashtu edhe në të gjitha vendet e tjera të përfshira në të, nuk e pa e nevojshme të organizojë një lloj revolucioni, revolucion si ai që u organizua në Francë. Shtrohet pyetja: reformat që u bënë nën drejtimin e perandorit Zef II (Joseph der II), reforma, që në pjesën më të madhe u ndërmorën nga Muratorët e Lirë, sollën fat apo ters për këtë Lidhje? Angazhimi i Muratorëve të Lirë në këto reforma perandorake pak të nxituara, që një dekadë më vonë u desh të kthehen mbrapsht, i sollën Muratorët e Lirë në rreziqe personale, pasi pas kësaj, regjimi ndërmori përsëri një

---

kurs autoritar, dhe viktimat qenë ata vëllezër, Odat e të cilëve u mbyllën.

A e arsyetoi mosn dodhja e revolucionit fundin e Muratorisë së Lirë në Austri? Rendi i ri i ndryshimeve demokratike shoqërore u arrit në shekullin e 19-të pas kryengritjeve të viteve 1848 e 1867, rend i cili për vëllezërit Muratorë ishte i deformuar e i papranueshëm. Vetëm pas rënies së perandorisë Habsburgiane u arrit zhvillimi i duhur i jetës Muratorike në Austri.

Reformat e Zefit të II- të e shndërruan shtetin perandorak në një shtet modern me administratën e tij, me të drejtën penale, me lirinë e fesë e me lirinë e shkencës e të artit. Këto reforma sollën me vete thjeshtësi të ndryshme në fushat sociale, eliminimin e gjyqeve private, barazi të të gjithëve para ligjit si dhe qasjet e para për liritë e të drejtat e fshatarëve. E parë në këtë këndvështrim, këto reforma i përmbushën idetë filozofike të shekullit të tyre. Këto ide më parë ishin diskutuar e bërë të njohura nëpër Odat Muratorike, dhe më pas rrodhën në realitetin politik të shtetit perandorak.

Nuk ishin të pakët Muratorët që influenconin klimën kulturore të Vjenës e të qyteteve të tjera të mëdha të perandorisë. Muratorët e Lirë zhgënjyen opinionin rreth një çështje të politikës së jashtme. Zefi i II-të dhe Leopoldi i II-të mbivlerësuan ndikimin e tyre gjatë projektit të këmbimit të Belgjikës me Bajernin. Për fat të keq, me kthimin mbrapsht të pjesës më të madhe të reformave, Kisha dhe aristokracia e lartë u kthyen përsëri në format e tyre tradicionale dhe shteti policor reduktoi përsëri të drejtat që iu kishte dhënë njerëzve më parë. Influenca e Muratorisë së Lirë në politikë nuk ekzistonte më fare, toleranca dhe humaniteti i Odave e gjeti vetveten më vonë të përfaqësuar në kulturën e Bidermajers<sup>38</sup>, ndërsa aktiviteti

---

<sup>38</sup> Biedermeier është periudhë kulturore 1815-1848



---

revolucionar ishte i pafuqishëm ndaj aparatit ushtarak perandorak. Politikisht Muratoria e Lirë kishte dështuar.

Kjo ishte një fatkeqësi e vërtetë. Shoqëria borgjeze humbi me këtë rast një udhëzues të rëndësishëm shpirtëror, dhe nuk ishte më në gjendje të ndërtonte një shoqëri moderne humanitare e tolerante. Idetë fillestare liberale të borgjezisë u humbën shumë shpejt në labirintin e zhvillimeve nacionale e etnike dhe në këtë mënyrë, praktikisht në të gjithë Evropën, përgatitën jo vetëm terrenin e krijimit të shteteve, por edhe konfliktet ndërmjet kombeve.

Muratoria e Lirë u gjend në këtë situatë: Luftë në prapavi, ku mundohej të mbronte vlerat e humanitetit e të tolerancës dhe njëkohësisht të krijonte një lloj laborator social ku mund të realizonte idetë e saj shoqërore në një shkallë sado të vogël.

Situata më paradokse ishte në perandorinë Austro-Hungareze. Perandori Austriak në vitin 1867 krijoi një ligj që lejonte krijimin e shoqatave për të gjithë qytetarët e perandorisë, por me një kusht, që një nëpunës i policisë së shtetit të ishte i pranishëm gjatë takimeve që ata mbanin. Duke u bazuar edhe në punët ritmike të tyre, Muratorët e Lirë nuk mund ta pranonin një gjë të tillë. I njëjti perandor Franc Zefi (Kaiser Franz Joseph) që ishte njëkohësisht dhe mbreti i Hungarisë, nuk e parandaloi dot krijimin e një Kryeode në Budapest, sepse në Hungari ligji mbi shoqatat ishte shumë më liberal. Muratorët e Lirë Vjenezë krijuan shoqata bamirësie në Austri dhe punimet me ritualet muratorike shkonin e i kryenin në vende si Noidërfl (Neudoerfl) Sopron (Oedenburg) dhe Bratislavë (Pressburg).<sup>39</sup>

---

<sup>39</sup> Noidërfl gjendet sot në territorin Austriak pranë kufirit me Hungarinë, në atë kohë territor Hungarez. Soproni është qytet Hungarez në kufi me Austrinë.

---

Influenca politike e këtyre të ashtuquajturave Oda të kufirit, që qëndruan të tilla nga viti 1867 deri në vitin 1918, është vështirë të përcaktohet. Sipas njohurive të mia, influenza e anëtarëve të këtyre Odave Muratorike mbi shoqërinë liberale borgjeze të perandorisë, nuk ka luajtur rol kryesor politik. Liberalizmi politik në historinë e brendshme të perandorisë pati një jetë apo epokë shumë të shkurtër.

Tendenca antiklerikale e Odave, një trashëgimi kjo nga Zefinizmi (Josephinismus), provokohej dhe mbahej në jetë vazhdimisht nëpërmjet reprezaljeve të kishës, shkoi krah për krah me zhvillimet gjithmonë e në rritje të shkencave pozitive, shkencave moderne të historisë, shkencave natyrore dhe arritjeve teknike. E parë në aspektin e politikave sociale, mund të thuhet që të gjitha Odat e kufirit kanë pasur një forcë e vullnet të çeliktë. Anëtarët e këtyre Odave krijuan e zhvilluan modele konkrete të bamirësisë, si jetimore, azile për pleq, qendra trajtimi për të sëmurë me të meta mendore e fizike e shumë projekte të tjera të këtij lloji. Pas Luftës së Parë Botërore qyteti i Vjenës i zhvilloi akoma më tej këto modele të cilat u përfaquan nga shumë vendet të tjera të Evropës Qendrore. Odat të kufirit, vërtetuan ne vetvete një lloj “politike” muratorike, “politikë” e orientuar në të ardhmen.

Kryeoda e Vjenës, në radhët e së cilës gjendeshin një numër i madh bashkëqytetarësh hebrenj, u kontrollua nga regjimi i Shushnigut<sup>40</sup>, i cili kërkoi edhe ndihma me të holla, për të luftuar nacional-socializmin që sa vinte e shtohej. Terrori nazist e shkatërroi këtë Kryeodë. Është e rëndësishme që të thuhet se Kryeoda e Vjenës zyrtarisht dhe publikisht ishte për ruajtjen e paqes mbarëbotërore. Këtë qëndrim ajo e manifestoi edhe në arenën ndërkombëtare.

---

<sup>40</sup> Schuschnigg ishte Kancelar i Austrisë nga viti 1934 deri në vitin 1938

---

Të mësojmë nga historia, kjo është një kërkesë, që Muratorët e Lirë ja bëjnë gjithmonë vetes. Duke u bazuar në këto që treguam deri tani në këtë kapitull, mund të shtrojmë pyetjet: A ka pasur Muratoria e Lirë austriake përvoja të mira në të shkuarën, kur ja ka lejuar vetes të përzihet në politikë? A janë këto eksperiencat mësimore për të qenë “politikisht” aktiv në të ardhmen? Për të bërë politikën e ditës?

Edhe në ditët e sotme principi i Muratorisë së Lirë është, që të mos japë konsensusin e marrjes me politikë anëtarëve të saj e të mos e promovojë marrjen me politikë të tyre. Kushdo që nuk bie në një ekstremizëm të papërgjegjshëm, mund të shpалosë lirisht aftësitë e idetë e tij.

Politika e vetme e pranueshme dhe njëkohësisht politika më e mirë e Muratorëve të Lirë është të mbledhë rreth vetes burra (gjegjësisht gra në odat e grave) humanë dhe tolerantë, dhe tu a përforcojë atyre këto qëndrime. Zhvillimet e ardhshme botërore, peizazhi i ardhshëm politik i Evropës e i të gjitha vendeve ka nevojë për njerëz të tillë. Njerëz që me vetitë e tyre që i zotërojnë e i zhvillojnë garantojnë jo vetëm një bashkëjetesë paqësore, por edhe mbijetesën paqësore të popujve e shoqërive ku ato jetojnë. Kësaj pjese të popullatës, që nuk mund të jetë kurrë mjaft e madhe sa duhet, duhet t’i adresohemi më shumë në të ardhmen. Muratoria e Lirë administron një thesar të madh të sjelljeve e qëndrimeve humane, të cilësive pa interes, që në çdo grupim demokratik, qoftë ky partiak apo institucional, janë në vendin e duhur ose duhet të jenë në vendin e duhur.

Që nga krijimet e tyre, detyrat e Muratorëve të Lirë janë bërë të shumëllojshme, jo në aspektin aritmetik, por në progresionin gjeometrik.

---

Është e vërtetë që nuk ka më feudalizëm që duhet kundërshtuar, nuk ka më klerikalizëm, që duhet marrë seriozisht, e nuk ka më fashistë të pajisur me pushtet. Skena politike në të cilën ne ekzistojmë është jashtëzakonisht komplekse dhe pjesërisht ideologjitet e kanë humbur kuptimin e tyre. Por akoma ekzistojnë fantazma të nacional-socializmit, të cilat duken qartë në shpërthimin e urrejtjen ndaj të huajve. Akoma ekziston mjerimi materialist e ai mendtor e shpirtëror, akoma ka luftëra. Muratorët e Lirë, këtyre fenomeneve ju kundërpërgjigjen më edukimin e vetvetes dhe me refuzimin e -izmave që akoma ndikojnë në jetën tonë<sup>41</sup>.

Edhe në Muratorinë e Lirë ka vëllezër muratorë, që mendojnë një aktivitet më të madh në arenën politike. Por, këta vëllezër gjenden në pakicë. Ne mësuam më sipër që Muratorët e Lirë ishin në gjendje të krijonin e zhvillonin modele sociale. Ata ishin në gjendje të edukonin burrat e lirë me virtytet e humanitetit, tolerancës e respektit. Por ata dështuan në dhunën e ushtruar nga fashizmi, nacional-socializmi e komunizmi. Megjithatë, Muratorët e Lirë akoma janë në gjendje të zhvillojnë modele që kanë të bëjnë me mënyrat e edukimit, sistemet sociale, çështjet e minoriteteve, dhe tolerancën e gjithanshme. Jo si një parti përbri të tjerave, jo si një klub filozofik përbri të tjerëve, por si një bashkësi aktive që mendon e punon në mënyrë humane.

Në shekullin 21, Muratoria e Lirë nuk ka si qëllim që të bëjë politikë, por që politikanët të sillen si Muratorë të Lirë. Mendojmë që luftërave dhe politikave të superfuqive ju ka kaluar koha. Ato vlera njerëzore, që ushtrohen e praktikohen vazhdimisht nëpër Odat Muratorike, ka ardhur koha që të behën pjesë vendimtare e vetive dhe e virtyeteve të politikanëve e diplomatëve tanë. Larg krijimit të

---

<sup>41</sup> me -izmat nënkuptojmë prapashtesat e fjalëve që shpjegojnë një teori apo ideologji si komunizmi, socializmi, nazizmi, fundamentalizmi, ekstremizmi, fanatizmi, racizmi etj.

---

imazheve armiqësore, larg duart e mendjet nga politikat militante e të gjithëpushtetshme, që nuk sjellin asnjë të mirë si në kontekstin rajonal ashtu dhe në atë botëror. Ta shohësh kundërshtarin si armik nuk është vetëm një gjë e kotë, por të kushton edhe shuma të mëdha parash dhe nuk sjell gjë tjetër veçse gjakderdhje. Dialogu vëllazëror, ta kuptosh tjetrin dhe të afërmin, të jesh tolerant e të kesh respekt ndaj të dobëtisë dhe të jesh human ndaj të gjithëve, këto janë detyrat, përgjegjësitë dhe qëllimet që duhet të ketë politikani modern.

Duhet t'i vendosim të gjitha shpresat, që Muratorët e Lirë amerikanë me përpjekjet e tyre t'i afrohen përherë e më shumë qëllimit madhor të njerëzimit, për të pasur një paqe mbarëbotërore. E them këtë, sepse nga numri ata janë organizata më e madhe muratorike që ekziston.

---

## Veprat e Muratorëve të Lirë

Në dialogun e tij të njohur “Ernst und Falk”, poeti gjerman i periudhës së përndritjes mendore Got’hold Efraim Lessing (Gotthold Ephraim Lessing) në një frazë shumë elegante thotë se qëllimi i vërtetë i Muratorisë së Lirë duhet të jetë që veprat e saja të mos jenë më të nevojshme.

Çfarë ka menduar Lesingu më këtë? Çdokush nga ne që merret paksa me historinë do të vejë re që janë tri dukuri kryesore të këtij lëmi: Tradita, evolucioni dhe revolucioni. Këto forma sociale të shoqërisë nuk janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra në kuptimin e tingëllimit. Tradita dhe evolucioni mund të shkojnë shumë mirë krahas për krahas njëri-tjetrit dhe të ashtuquajturat revolucione jo gjithmonë duhet të ndodhin duke rënë shumë në sy. Unë mendoj që në të tri këto rryma të historisë njerëzore gjenden të gjitha veprat e Muratorëve të Lirë dhe që në shekullin e 21-të është bërë praktikisht e pamundur t’i paraqesësh në një mënyrë gjithëpërfshirëse këto vepra dhe rezultate të panumërta e të larmishme, shpeshherë të padukshme, të Muratorëve të Lirë. Ndër të tjera kjo është e paarritshme sepse, shumëllojshmëria dhe sasia e këtyre veprave historike ta bën të pamundur konceptimin, formulimin dhe përshkrimin e një historie mbarëbotërore. Gjithashtu është e pamundur të rendisësh veprat e pafundme të bamirësisë, të artit, të shkencës e të rendimenteve sociale të Muratorëve të Lirë.

Unë do të përqendrohem tek shumë pak shembuj të veprave muratorike, shembuj që janë të njohur botërisht. Por, përpara se të filloj me to edhe një koment i vogël: historia e Muratorisë së Lirë është njëkohësisht edhe historia e anëtarëve të saj, pra një histori personale e individuale, dhe për ta gjetur të vërtetën e saj duhet të hulumtosh miliona biografi, sepse historinë nuk kanë bërë Odat apo Kryeodat, por anëtarët e tyre në çdo cep të rruzullit tokësor. Kjo

---

është e kuptueshme, vetëm kur dikush e pranon se ky është efekt i personaliteteve individuale dhe shumë pak i institucioneve, pra i Obediencave, Odave apo Kryeodave. Kundërshtarët e kësaj Lidhje nuk e pranojnë këtë fakt. Le t'ia nisim nga pikë-kthesa vendimtare e historisë së njerëzimit, me deklaratën e të drejtave të njeriut, e që s'do të lodheshim kurrë duke folur mbi të. Situata ishte si vijon: në Evropë gjëmonte lufta shtatëvjeçare ndërmjet Prusisë dhe Austrisë, Fridrih-u i II-të (Friedrich der II), pasi i kishte marrë Perandoreshës austriake Maria Terezias (Maria Theresia) Shlesien<sup>42</sup>, po përgatitej t'i jepte perandorisë habsburgiane goditjen vendimtare. Në të njëjtën kohë në kontinentin amerikan zhvillimet ishin në një stad vendimtar: Kolonitë angleze në Amerikën e Veriut u ngritën kundër vendit mëmë dhe krijuan 13 shtetet e para, shtetet e para anëtare të ShBA-së. Në kohën kur në të gjitha vendet dhe perandoritë e të gjithë rruzullit tokësor, mbretër e princër, perandorë e prijës, ushtronin forcën e tyre despotike mbi njerëzit e shtypur e të renduar, edhe pse njeriu kur lind ai lind i vetëm dhe ka vendin e tij të caktuar në këtë botë deri në ditën që vdes, ndodhi një mrekulli e vërtete kur në Amerikën e Veriut u hodhën themelet për mishërimin e vlerave e të drejtave njerëzore.

Në një dokument, që u nënshkrua nga burra, shumica e të cilëve ishin Muratorë të Lirë, përcaktohet për herë të parë në historinë e njerëzimit që një njeri që ka lindur i lirë edhe duhet të jetojë si i tillë, që çdo njeri në këtë planet e ka të drejtën të jetë i lumtur dhe se çdo njeri ka dinjitetin e tij. Me anë të kësaj deklaratë të pavarësisë iu hap rruga një zhvillimi në mbarë botën. 15 vjet më vonë, ishin francezët ata që këto të drejta të njeriut, jo vetëm që i pranuan e i përsëritën, por edhe i përforcuan edhe më shumë në deklaratën e tyre të të drejtave të njeriut. Edhe gjatë revolucionit të Francës, sidomos në fazat pozitive të tij, pas regjimit brutal të

---

<sup>42</sup> Schlesien është Krahinë në Evropën Qendrore që shtrihet në Poloni, Gjermani, Çeki

---

Robespierit (Robespierre), ishin Muratorët e Lirë si Mirabë (Mirabeau) që ndërmorën aksione politike vendimtare për Francën.

Në shekullin e 18-të Muratoria e Lirë u përhap në Evropë edhe në Amerikë dhe në shekullin e 19-të në Indi, Afrikë dhe në Australi. Tradita e Evropës kontinentale ndihmoi në përhapjen e dritës të periudhës së përndritjes mendore, ndërsa anglosaksonët dhe amerikanët futën në sistemet dhe mënyrat e tyre të jetës edhe një lloj influence të fuqishme fetare.

Veprat e Muratorëve të Lirë fillimisht përkufizohen rreth ambientit që i rrethon ata, por gjithashtu kanë ekzistuar personalitete të veçanta që i kanë bërë publik veprat e tyre, siç ishte rasti i periudhës zefiniste në Austri, ku idetë dhe nismat e Muratorëve të Lirë gjetën terrenin e përshtatshëm për një sërë reformash si: krijimin e spitalit të përgjithshëm në Vjenë, krijimin e parkut botanik të Vjenës, krijimin e kodit modern penal nën ndikimin e ideve të Çezare Bekaria<sup>43</sup>, patentën e tolerancës për protestantët, patentën e tolerancës për hebrenjtë, lirinë e shtypit, revizionimin dhe rinovimin e të gjitha ligjeve, reformën e tokës, reformën e manastireve dhe të kishave, përkujdesjen fetare për të gjitha shtresat e popullsisë, përkufizimin e shpenzimeve të pakuptimta gjatë funeraleve, masat e ndërmarra për pastrimin dhe higjienën brenda qyteteve, largimin e varrezave jashtë qyteteve, etj.

Ligjet zefiniste mund të zhvilloheshin e vendoseshin vetëm në një shoqëri që e kishte përqafuar frymën e përndritjes mendore, në një shoqëri që ishte influencuar fuqimisht nga veprat e Muratorëve të Lirë.

---

<sup>43</sup> Cesare Beccaria – filozof italian i periudhës së përndritjes mendore, reformator i kodit penal dhe filozof i së drejtës



---

Në Odat Evropiane të Muratorisë së Lirë ushtroheshin format e para të demokracisë dhe njëkohësisht kultura qytetare e shekullit të 19-të e gjet veten si në një laborator ku zhvilloheshin virtytet më të mira të njeriut, virtyte që jepnin shpresë për kohë më të ndritura. Kokat më të mira, politikanë, artistë, mjekë, shkencëtarë, muzikantë filluan të bëhen anëtarë të Odave.

Shteti italian, që ua shkëputi fuqive të huaja provincat e tija të veriut e të jugut, që zaptoi shtetin e kishës dhe shtyu pas Papët deri në Vatikan, nëpërmjet një lëvizje mjeshtërore nga të dyja krahët, nga veriu e nga jugu, u krijua si shtet nga Muratorët e Lirë, nga njëra anë nga revolucionari Garibaldi, nga ana tjetër nga Kavur (Camillo Benso, conte di Cavour), ministri obortar i Savojens (Savoyens). Krijimi i shtetit të ri të Italisë është gjithashtu një aksion muratorik. Por edhe këtu na duhet ta ripërsërisim se këto nuk ishim organizime të Kryeodës italiane, por ishin aksione individuale të anëtarëve të saj. Një jomurator nuk do të bënte dallime të mëdha në këtë mes, por ka një kuptim shumë të rëndësishëm, po të kuptohet mirë dallimi.

Pas Luftës së Parë Botërore ishin Muratorët e Lirë si gjermani Gustaf Shtreseman (Gustav Stresseman) e francezi Aristid Brië (Aristide Briand), që për herë të parë u munduan t'i përfundonin armiqësitë e trashëguara ndërmjet dy popujve dhe të përgatisnin terrenin për atë që ndodhi në vitin 1947, krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit e të Çelikut, Komunitet ky që hodhi themelet e Bashkimit Evropian.

Një ide tjetër paraprake për një Evropë moderne, ka qenë ideja e Unionit Panevropian, që u inaugurua nga Muratori i Lirë Kudenhove-Kalergi (Richard Nikolaus Coudenhove-Kalergi). Po t'ju hedhin një sy principeve kryesore të tre shekujve të fundit do të shohim se kudo shihet shumë qartë nënshkrimi i Muratorëve të Lirë. Por si çdo medalje që ka dy anë, nuk duhet ta anashkalojmë faktin, që Presidenti amerikan që urdhëroi hedhjen e bombave atomike në

---

Hiroshima e Nagasaki, Herri Truman (Harry Truman), ishte gjithashtu Murator i Lirë. Akoma debatohet rreth këtij vendimi. A ishte me të vërtetë i domosdoshëm ky aksion, aksion që i dha fund Luftës së Dytë Botërore dhe a i shkonte për shtati ky veprim një Muratori të Lirë? Veprat e Muratorëve të Lirë nuk janë as të fshehta e as të parëndësishme. Është pra e qartë se si në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me dy lloj “veprash” të Muratorëve të Lirë. Nga njëra anë qëndrojnë normat e moralit e të etikës të vetedukimit të Muratorit të Lirë, norma të cilat mësohen brenda mureve të Odës, e nga ana tjetër është vendi ku Muratori i Lirë është vazhdimisht aktiv siç është vendi i punës së tij apo vendi ku ai vepron në jetën e përditshme.

Në Amerikën e Jugut, e cila në fillim të kohës së re<sup>44</sup> u nda me një vendim të Papës Aleksandër i VI-të në një pjesë spanjolle dhe në një portugeze, periudha e përndritjes mendore u realizua në shekullin e 19-të nga muratorë të shkëlqyer: Simon Bolivari ishte çlirimtari i Amerikës së Jugut nga mbretëritë iberike, ai ishte krijuesi dhe konkivistadori i atyre territoreve që sot e kësaj ditë përbëjnë shtetet veriore të Amerikës Jugore.

Siç mund ta ketë vënë re lexuesi i vëmendshëm, deri më tani u treguan vetëm ngjarjet më të rëndësishme historike e politike, në të cilat Muratorët e Lirë kishin qenë aktivë. Fushat e shkencës, artit, letërsisë dhe të muzikës nuk u prekën fare. Megjithatë, rezultatet e punës së atyre burrave që janë marrë me këto fusha e që kanë bërë një punë të mrekullueshme, janë akoma më të rëndësishme e më të qëndrueshme sesa ato të politikanëve. Në një mënyrë shumë më të kuptueshme, veprat e tyre përfaqësojnë etikën dhe moralin e njerëzimit, vepra, të cilat pa frikë mund të quhen si veprat më të shquara të Muratorëve të Lirë. Se sa të ndryshme kanë qenë këto personalitete, e tregojnë emrat e mëposhtëm, emra të cilat janë marrë sa aty këtu nga hambari i Muratorëve të Lirë: Gëte (Goethe), Volter

---

<sup>44</sup> fundi i shek. 15, fillimi i shek. 16

---

(Voltaire), Aleksandër Fleming (Alexander Fleming), Xhiakomo Puçini (Giacomo Puccini), Johan Gotlib Fihte (Johan Gotlieb Fichte), Moxart (Wolfgang Amadeus Mozart), Jan Sibelius (Jean Sibelius), Xhorxh Uashington (George Washington), Tomas Xheferson (Thomas Jefferson), Xhuzepe Garibaldi (Giuseppe Garibaldi), Ferdinand Hanush (Ferdinand Hanusch), Henry Dunant e shumë e shumë të tjerë. Kanë qenë këto personalitete të rëndësishme, që e kanë bërë Muratorinë e Lirë një mbartëse të fuqishme të veprimtarisë mendore e shpirtërore.

Hapësirat e “Bamirësisë” shtrihen nga përkujdesja ndaj të varfërve, pleqve e jetimëve e deri në ndihmat humanitare ne raste katastrofash të ndryshme. Në shtetet tona moderne sociale, aktiviteteve të tilla nuk ju jepet më ndonjë rëndësi e madhe, sepse shumica mendojnë që duhet të jenë strukturat shtetërore ato që merren me këto pune. E vërteta është që jo gjithmonë ka qenë kështu. Për njerëzit shumë me i rëndësishëm ishte Plani Marshall, që u vu në jetë nga Muratori i Lirë amerikan Xhorxh Marshall (George C. Marshall) dhe që ishte diametralisht i kundërt me planin e Morgenthaut (Henry Morgenthau)<sup>45</sup>. Falë Planit Marshall u bë e mundur rimëkëmbja e Evropës pas Luftës së Dytë Botërore.

Le të kthehemi edhe njëherë tek Lesingu: ai ëndërronte për një shoqëri, ku veprat e Muratorëve të Lirë të mos ishin të nevojshme, që do të thotë se ai ëndërronte për një shoqëri të drejtë, një shoqëri ku do të mbizotërojë drejtësia. Në të njëjtën kohë ai gjithashtu mendonte: po të mos kish ekzistuar Muratoria e Lirë, ajo duhej të ish shpikur patjetër. Ai e dinte, që njeriu që në fillimet e tij nuk ka rritur brenda vetes vetëm lakminë për pushtet, zilinë e lakminë për pronën, por në të njëjtën kohë ai ka pasur një dëshirë të madhe nga brenda për paqe, drejtësi e harmoni. Si të parat edhe këto të dytat gjenden të mbjella në zemrën njeriut, ai e ka vetë në dorë se cilave ju jep përparësi.

---

<sup>45</sup> Plani i tij parashikonte që Gjermania të kthehej në një vend agrar e bujqësor

---

## Sinkretizmi si preferencë

Për t'ju afruar sa më pranë përmbajtjes shpirtërore e mendore të Muratorisë së Lirë, gjegjësisht për ta përshkruar atë, duhet që në radhë të parë të qartësohemi në vetvete se Muartoria e Lirë nuk është as shkollë filozofie, as sekt dhe as fe në vete. Sistemi i saj nuk është një sistem i mbyllur në vetvete, nuk përfaqëson ndonjë rrymë filozofike, por është një sistem tej e përtej i hapur, që ka rrënjë të shumëllojta, dhe që më poshtë po mundohemi ta shpjegojmë më në detaje:

Motivi më i lashtë njerëzor, që përdoret në Muratorinë e Lirë, është kulti i dritës. Kontrasti ndërmjet dritës dhe errësirës, ditës dhe natës, agimit dhe muzgut është një përjetim i lashtë i njeriut dhe formon një nga bazamentet e simbolikës muratorike. Që t'i mundësohet dritës që të shpalosë të gjithë shkëlqimin e saj, duhet që procesi i fillimit të ndodhë në të kundërtën e saj – pra, ndezja duhet bërë në errësirë. Muratorët e Lirë përdorin qirinjtë, për t'i dhënë formën e shkëlqimit e duhur simbolit të dritës. Vetë drita, e cila kishte rëndësinë e saj të veçantë në kultet e vjetra, ka marrë zhvillime e saja të veta në jetën e brendshme të Odës. Meqë e gjithë drita e universit tonë vjen nga dielli, simbole të tjera të trupave më të dukshëm qiellorë si dielli, hëna e yjet përfaqësojnë gjithashtu simbolikën e Odës Muratorike. Interesant është fakti, që ylli me pesë cepa nuk është simbol i asnjë trupi qiellor, por paraqet vetë formën muratorike të njeriut. Me anë të këtij simboli paraqitet pjesëmarrja e njeriut në gjithësinë kozmike. Pas kultit të dritës, është një burim tjetër i përmbajtjes shpirtërore e mendore muratorike, që duhet kërkuar në misteret e antikës. Me fjalën mister nënkuptojmë diçka sekrete, diçka enigmatike. Në Greqinë e Lashtë, që në kohët para-klasike e klasike, njiheshin pagëzimet në misteret e ndryshme. Lidhjet më të rëndësishme mistike kanë qenë ato të Eleusis dhe të Samotrakës.

---

Në një kohë që Zotave qiellorë të Olimpinit iu dhurohej vetëm një far besimi i kushtëzuar, misteret nga ana tjetër, nëpër sallonet e sallat nëntokësore, u ofronin vizitorëve të tyre (adeptët, neofitët) imazhe të ndryshme, imazhe të cilat zgjonin tek ta shpresën për një jetë të përhershme. Kjo mënyrë vetëm përforconte dëshirën dhe besimin e tyre për të mos vdekur kurrë.

Në këtë periudhë kohore shquhet fakti, që Zotat që nderoheshin nëpër këto mistere ishin në shumicën e rasteve femra dhe dhuratat që merrte i pagëzuari në fund të udhëtimit të tij nëntokësor, ishin një kallëz gruri dhe një formë e riprodhuar e organit gjeneral të femrës. Në këtë mënyrë vërtetohej rilindja e të pagëzuarit. I pagëzuari duhej të bënte disa udhëtime nëpër këto hapësira të ndërlikuara nëntokësore. Shpeshherë atyre ju lidheshin sytë, në të njëjtën kohë duhet t'ju "mbijetonin" rreziqeve që ju dilnin përpara gjatë këtyre udhëtimeve, si për shembull prova e ujit apo prova e zjarrit, të cilat gjenden edhe në operën "Fyelli Magjik" të Moxartit, dhe që kalohen nga çifti i të dashuruarve, Tamino e Pamina. Qëllimi kryesor i këtyre ritualeve ishte, që kandidatit të trembur e të çoroditur, t'i krijohej përshtypja e ringjalljes, përshtypja e një lindje të dytë në një ambient të sigurt e të përhershëm.

Edhe në Odat Muratorike bëhen udhëtime të tilla. Librat e mëdhenj të shpalljeve hyjnore fetare siç janë Bibla, Kurani, Tora, fjalimet e Budës apo Veden, kanë vendin e tyre të veçantë në hapësirën e Odave punuese. Ka Oda ku mund të gjenden të gjitha së bashku, dy tre prej tyre ose vetëm njëra nga këto, kjo varet në varësi të kulturës e vendit ku gjendet Oda.

Kjo do të thotë, që Muratorët e Lirë dinë t'i respektojnë dhe t'i vlerësojnë të gjitha traditat e shenjta të të gjithë popujve të botës. Nga ana tjetër kjo nuk do të thotë, që Muratori i Lirë duhet ta ndjejë veten të detyruar t'iu bashkëngjitet këtyre shkrimeve të shenjta. Çdo

---

Murator e ka vetë në dorë që të zgjedhë se cilit besim fetar ka dëshirë t'i përkasë. Në këtë mënyrë arritëm tek pyetja rreth imagjinatës mbi Zotin. Në Odat e kohës së re, veçanërisht në Odat që janë të pranuar dhe të njohura nga Kryeoda e Anglisë, është e detyrueshme përmendja e Mjeshtrit të Madh të Ndërtimit të të gjitha Botëve. Në të njëjtën kohë, të sapo-pranuarit i bëhet e qartë, që në këtë shprehje kemi të bëjmë me një simbol, dhe që ai duhet të ndjehet i lirë në imagjinatën dhe besimin e tij mbi Zotin.

Në këtë mënyrë, Oda as nuk stimulon dhe as nuk ndalon ndjenjat fetare dhe për të këto ndjenja qëndrojnë në të njëjtën lartësi me përdorimin e arsyes e të logjikës. Odat, të cilat e shohin përndritjen mendore si taban të tyre, janë në të njëjtën kohë të ndërgjegjshme, që si shpirti ashtu dhe mendja e imagjinata mbi Zotin janë pjesë të botëkuptimit të Muratorit të Lirë. Tipare të tjera konstruktive që nxjerrin në pah intelektin muratorik gjenden gjithashtu në filozofinë Greke: në mësimet mbi moralin e etikën të Aristotelit, në kërkimet e vazhdueshme të së vërtetës të Sokratit, në idetë qendrore të Platonit, veçanërisht tek përkufizimet mbi të mirën, mbi të vërtetën dhe mbi të bukurën.

Muratorit të Lirë i kërkohet që të gjendet në rrugën e vetë-njohjes, vetë-përmbajtjes dhe të vetë-përsosjes, rrugë kjo që kërkon mjeshtëri të lartë, mjeshtëri e cila të duhet si në jetën muratorike ashtu edhe në atë profane. Në këtë proces, që ne mund ta quajmë proces i perfeksionimit, mbizotëron ideja, që njeriu duhet të ballafaqohet me të gjitha fushat e shkencës, artit, çështjet sociale e ekonomike, duke pasur të vetmin qëllim, të ndërtojë sa më bukur që të jetë e mundur jetën e tij dhe si rrjedhojë e kësaj, ai në të njëjtën kohë do të ndikojë në ndërtimin po aq të bukur të mjedisit, shoqërisë, vendit e shtetit ku ai jeton.

---

Nga ambientet e punës të brigadave të ndërtimit që ndërtuan objekte të ndryshme në mesjetë dhe nga gurpunuesit e atëhershëm, vëllezërit e Odave morën veglat e tyre të punës, të cilat nuk i përdorin më në mënyrë operative, por vlerësojnë me nota shumë të larta domethënien dhe etikën e simbolizmit të tyre. Kështu ne gjejmë në Oda gurë në formën e një kubi, çekiç, plumbçe, metër, niveluese, kompasin dhe gonenë, të gjitha së bashku veglat e punës të atyre gurgdhendësve, që ndërtuan ndërtesat më të bukura të Mesjetës. Muratori i Lirë modern, është i mendimit që këto vegla në ditët e sotme duhet të përdoren për ndërtimin e një ndërtese të një lloji tjetër, për ndërtimin të ashtuquajturit “Tempulli i dashurisë së përgjithshme njerëzore”.

Kështu në hapësirën e Tempullit Muratorik gjenden jo vetëm principet kryesore të etikës edukuese, por njëkohësisht edhe ligji më i lartë i moralit, virtyti i bamirësisë ndaj të tjerëve. Në kapitullin “Thesaurus mundi” vumë në dukje, që pas mijëvjeçarëve të shumtë, në etikën natyrore të gjinisë njerëzore filluan të kristalizoheshin norma të ndryshme, më ndihmën e të cilave njeriu mundohet të luftojë sjelljet dhe veprimet e tij të këqija. Në një Odë është pothuajse njëjtë sikur të jesh në një muze ku është dokumentuar gjenealogjia e etikës njerëzore dhe njëkohësisht të kërkohet të bësh një jetë të drejtë dhe mundësisht ta përsosësh atë. Në të njëjtën kohë – dhe kjo është përparësia që të ofron ky konstruksion i hapur – nuk bëhet fjalë vetëm për një muze ku ruhet e kaluara, por për një vend pune që njëkohësisht i përkushtohet edhe të ardhmes.

---

## Virtytet Muratorike

Në rreshtat e mëposhtëm vëmendja jonë do të përqendrohet veçanërisht në mënyrat e sjelljes dhe në virtytet muratorike.

Krijimi i personalitetit muratorik fillon që në shkallën e nxënësis, i cili bën një punë intensive në procesin psikik të **njohjes së vetvetes**. Kjo do të thotë, që ai së pari mundohet të kuptojë se si ka rrjedhur jeta e tij deri më tani, fillon të hulumtojë kujtesën e tij dhe vëzhgon vazhdimisht vetveten. Ai është objekt dhe subjekt në të njëjtën kohë. Mundësisht ai do të arrijë të kuptojë, që vetëm thjeshtë nëpërmjet meditimit nuk do të arrijë të krijojë një pamje të përgjithshme mbi vetveten dhe do të vijë në përfundimin, që mjetet më të përshtatshme për njohjen e vetvetes janë gjykimi dhe vlerësimi i veprave dhe qëndrimeve të tija. Ai është i lirë të përdorë çfarëdo lloj ndihme që ka nevojë. Ndihma është e domosdoshme. Ai do të lexojë libra, nuk do të mbështetet vetëm në psikikën racionale të përndritjes mendore, ndoshta do të merret edhe me autorët modernë, ndoshta edhe me Sigmud Frojd (Freud) e me Erih From (Erich Fromm). Rezultatet më të mira do ti arrijë, në qoftë se do të diskutojë e bashkëpunojë me vëllezërit e tij.

Në rrethin e vëllezërve ai do të arrijë ta njohë vetveten, sepse personalitetet e ndryshme që përbëjnë Odën do të shërbejnë njëkohësisht si një pasqyrë për të. Kjo njohje e vetvetes megjithatë nuk është i vetmi qëllim në vetvete, por një gur themeli i atij procesi zhvillimor, proces në të cilin ai tashmë gjendet.

Nëpërmjet simboleve të Odës, atij do t'i ofrohet të bëjë një hap më përpara në këtë Lidhje: **Të përmbajë vetveten**. Vetëpërmbajtje nuk do të thotë vetëm që të mos përdorësh dhunën, por të vetëpërmbahesh edhe në fjalë, gjeste e veprime. Dëgjo, prit, hesht, kontrollo impulset, mënjano ndjenjat dhe mendimet negative ose



---

nëse nuk i mënjanon dot, të paktën përpunoji ato. Të gjitha këto, të cilat që nga kohët e lashta quhen vetëpërmajtje, janë veti të vyeshme për atë, veti të cilat kërkojnë përkujdesje të vazhdueshme.

Hapi i tretë është hapi i shndërrimit. Muratorët e Lirë e quajnë **përsosmëria** e njeriut. Tingëllon shumë euforike, por nuk është gjë tjetër veçse zhvillimi i mëtejshëm i dy hapave të mësipërm, njohjes së vetvetes dhe vetëpërmajtjes ose thënë ndryshe përsosmëria është zhvillimi shpirtëror e mendor dhe perfeksionimi i dy hapave të parë – praktikisht krijimi i njeriut human.

Qëllime të personalitetit muratorik janë **Mençuria, Fuqia, Bukuria**.

Jo vetëm në rrethin e kulturës tonë është e zakonshme që të moshuarve ose pleqve – sigurisht nëse i vlerësojmë për të tillë – t’ju atribuojmë **mençurinë**. Siç duket mençuria nuk u arritka lehtë. Nuk ekziston asnjë lloj disipline, asnjë lloj shkolle, asnjë lloj universiteti, asnjë program edukativ, ku mund të mësohet ajo. Por megjithatë arritja e saj është një qëllim i Muratorit të Lirë, një lloj imazhi ideal, sepse në të njëjtën kohë Muratori i Lirë mendon që për të ndërtuar Tempullin e Dashurisë së Përgjithshme Njerëzore do të ketë nevojë edhe për mençurinë. Mjetet që përdoren për këtë janë meditimi, dialogu, diskursi dhe diskutimi. Në shkollë dhe gjatë jetës kemi mësuar të vëmë në përdorim intelektin tonë dhe të shpresojmë që e bëjmë këtë gjë në mënyrë sa më optimale.

Është vërtetuar që është një përparësi e madhe nëse intelektu racional do të shkonte dorë për dorë me arsyen e renditur nën të, e cila zotëron edhe më shumë gjëra sesa kompetenca racionale, si për shembull gjendja emocionale konstante, normat e sjelljes, ndërgjegjia e pastër, vetëpërmajtja. Dallimi ndërmjet arsyes dhe intelektit është shpesh i vështirë por edhe pse të ndara nga njëra-tjetra duhet të

---

ndikojnë së bashku. Mençuria është produkti i një bashkëpunimi afatgjatë i këtyre të dyjave dhe në të vërtetë është produkti përfundimtar i një procesi të gjatë zhvillimi. Si rrjedhojë nuk mund të pritët që atë ta zotërojnë fëmijët apo të rinjtë.

Kur Muratori i Lirë flet për mençuri, e ka të qartë, që arritja e saj është një proces që zgjat gjithë jetën. Njeriu i ditëve të sotme, që me kënaqësi e quan veten njeri modern, si fjala mençuri si përmbajtja e kësaj fjale i duken të dala mode, po ashtu ndoshta edhe fjala virtyt i duket si e huaj.

Megjithatë njeriu i arsyeshëm e ka vërejtur, që mungesa e mençurisë në jetën e një individi apo në jetën e një shoqërie rezulton në fenomenet e njohura kaotike në të cilat ndodhemi aktualisht. Natyrisht që mençuria është një gjendje ideale, që ne njerëzit vetëm mund t'i afrohem pranë, por që kurrë nuk mund ta zotërojmë tërësisht. Ta kesh si qellim jetësor arritjen e mençurisë do të thotë të bësh me një objektiv të pazëvendësueshëm. Ky objektiv nuk e humb kurrë aktualitetin e tij, as në të kaluarën e as në të tashmen.

**Fuqia** nuk ka të bëjë aspak me forcën fizike apo dhunën, nuk ka nevojë për ngritje zëri, por nga ana tjetër ka një numër të madh formash se si mund të shprehet: durim, energji, forcë bindëse, qëndrueshmëri – mbi të gjitha ajo lloj qëndrueshmërie që garanton vazhdimësinë. Para së gjithash, fuqia njerëzore e tregon veten kur kundërshton kërkesat e paarsyeshme si dhe favorët në dëm të njeriut e të shoqërisë. Ajo e tregon veten kur njeriu është i sëmurë, në vuajtje, por njëkohësisht edhe në ndjenjat më të larta të njeriut siç janë miqësia dhe dashuria. Muratori i Lirë gjithashtu shpreson që të jetë i fortë edhe në momentet e vdekjes. Siç është përmendur në një kapitull tjetër, Muratori i Lirë debaton rreth vdekjes, qoftë kjo e tij apo e njerëzve të tjerë, dhe mund të thuhet që ky është një aspekt i rëndësishëm i punëve të tij.

---

Ia vlen të përmendet theksi i veçantë që Muratorët e Lirë i japin fuqisë. Fuqia nuk është vetëm një relik i ardhur nga Muratoria e Lirë operative, e që duhet patjetër të risillet në vëmendje, por është një pikë referimi se të gjitha aksionet që ndërmerren njeriu, kur dëshirohet që të jenë të suksesshme, duhet të kryhen me gjithë fuqinë. Kjo lloj fuqie, në asnjë moment nuk duhet të ngatërrohet me vrazhdësinë ose dhunën, por duhet të shikohet si një fuqi mendore e si energji shpirtërore.

**Bukuria** është ideali i tretë i Muratorit të Lirë – siç e kemi vënë re deri më tani, shprehjet dhe simbolet muratorike e përdorin shumë numrin 3 – dhe është më i vështiri për tu përshkruar e për tu arritur si qëllim.

Deri në mesin e shekullit të 19-të ka qenë relativisht e lehtë të flisje për bukurinë. Njëri nga filozofët që është marrë shumë me bukurinë ka qenë filozofi gjerman i periudhës së përndritjes mendore, Aleksandër Gotlib Baumgarten (Alexander Gottlieb Baumgarten). Në shekullin e kaluar më fenomenin e bukurisë është marrë filozofi tjetër gjerman Teodor W. Adorno (Theodor W. Adorno). Sot pothuajse duket e pavend të flasësh mbi estetikën e së bukurës, sepse tashmë në hapësirat e saj kemi futur edhe të shëmtuarën. Bukuria muratorike nënkupton estetikën përfundimtare të njeriut human që duhet arritur. Por, meqë Muratoria e Lirë nuk njih dogma, ky atëherë është një qëllim, që secili mund ose duhet t’ia vendosë vetes dhe ku secili do të kërkojë modelin më të përshtatshëm për veten e tij.

Këto tre virtyte Muratorike kanë diçka të veçantë në mesin e tyre, sepse nuk është e mundur të arrihet qëllimi final, duke përdorur vetëm njërin nga këto. Ndikimin më të mirë këto virtyte e arrijnë kur janë të gjitha së bashku dhe në këtë mënyrë ia mundësojnë Muratorit të Lirë që t’i afrohet sa më pranë idealit, që ai gjithë jetën ëndërron

---

që ta arrijë. Megjithatë, rrugës për atje ai është autonom dhe përgjegjës për veten e tij.

Duket qartë se Muratori i Lirë vazhdimisht mundohet që të përvetësojë një lloj mënyre pozitiviste jetese, mënyrë kjo e bazuar mbi harmoni e respekt. Një ndihmesë e madhe në këtë drejtim janë simbolet që gjenden brenda në tempull, simbole që prezantojnë vetitë dhe normat morale e etike të njeriut. Në tempullin muratorik nuk ka simbole që paraqesin ndonjë dhunë të ushtruar, nuk ka imazhe që tregojnë torturat dhe nuk ka figura, trupa apo fytyra që shprehin dhimbje (krahaso me simbolikën që gjendet ne kishë). Në tempullin muratorik nuk ka tabela me mëkatet e njeriut apo piktura me zjarret përvëluese të ferrit. Idealet dhe virtytet muratorike nuk janë të ndërlidhura me mësimet fetare, sepse Muratoria e Lirë nuk ka asgjë tjetër ndërmend, veçse të krijojë një terren sa më të harmonishëm për jetën e njeriut, jetë e cila gjendet vazhdimisht në një proces të vështirë edukimi.

Virtytet e lartpërmendura që i përkasin individualisht secilit Murator dhe që paraqesin qëllimet që ai dëshiron t'i arrijë gjatë procesit të formimit të personalitetit të tij, janë njëkohësisht edhe koncepte, karakteristika, objektiva e përvoja që ai kërkon t'i arrijë në jetën e përditshme dhe në shoqërinë ku jeton.

**Liria.** Një nga fenomenet më të shumëkuptimshme e më të kontestuara. Me fjalën liri, Muratori i Lirë nuk nënkupton të qenit i lirë “nga dikush apo diçka”, por ndjenjën e të qenit i lirë “për të bërë diçka”. Për Muratorin liria pa rregull është kaos dhe rregulli pa liri është diktaturë. Rregullin, të cilin Muratorët e Lirë e bëjnë vetë brenda Odës, është një lloj hierarkie që ai e pranon vullnetarisht. Liria është pandashmërisht e lidhur me mendimet Muratorike.

---

**Barazia.** Edhe ky koncept që njëherë e një kohë i përkiste parullave të Revolucionit Francez, së bashku me lirinë e vëllazërinë, është një koncept qendror i Muratorisë së Lirë.

Në princip të gjithë Muratorët e Lirë janë të barabartë ndërmjet tyre, pa marrë parasysh se në ç'moshë apo në ç'shkallë ndodhen. Të gjithë ndodhen – e parë kjo në aspektin figurativ – në të njëjtin nivel, dhe asnjëri prej tyre nuk merr përparësi ndaj ndonjë vëllai tjetër. Njëkohësisht një përparësi e tillë as nuk i jepet. Sa më shumë aftësi që të ketë një vëlla, aq më të mëdha janë detyrat e punët që ai merr mbi vete. Muratori i Lirë e shikon gjithë njerëzimin si një familje të vetme. Kundërshtarët e kësaj Lidhje janë të mendimit se barazia ndërmjet gjithë njerëzve është diçka jorealiste dhe jo e vërtetë. Muratori në anën tjetër i shikon të gjithë njerëzit – dhe jo vetëm vëllazërit e tij Muratorë – si të njëjtë me të. Secili njeri mbi këtë rruzull e ka të drejtën të ketë dinjitetin dhe lirinë e tij dhe njëkohësisht të shpresojë, që në një të ardhme sa më të shpejtë, të arrijë standarde të larta jetese si të gjithë njerëzit e tjerë.

**Vëllazëria.** Kjo shprehje, meqë bëhet fjalë vetëm për gjysmën e gjinisë së racës njerëzore, duhet të kuptohet drejt. Ajo fare lehtë mund të zëvendësohet nga shprehja “motëria”. Ka qenë dëshirë e lashtë e njerëzimit që të takoheshin vëllazërisht me njëri-tjetrin, që do të thotë të ishin si anëtarë të një familje. Kjo vëllazëri, që nëpërmjet pamjeve mitologjike edhe mund të denigrojë – le të kujtojmë Kabilin dhe Abelin, Romulusin dhe Remusin – është megjithatë shëmbëlltyra e një miqësie të vërtetë dhe për më shumë ajo simbolizon unitetin e ngushtë ndërmjet të gjithë njerëzve.

---

## Muratoria e Lirë si mënyrë e të jetuarit e të menduarit

Kush i afrohet Muratorisë së Lirë, nuk duhet të presë që të arrijë nëpërmjet saj avantazhe të jashtëzakonshme e përparësi materiale. Në çdo shoqëri tjetër, ai që dëshiron të bëhet anëtar i saj, më përpara bën njëherë llogaritë me veten, se ç'do të përfitojë nga ky anëtarësim për kontributin që do japë në këtë shoqatë. Kërkuesi ynë, të cilin e shoqëruam në një nga kapitujt e këtij libri, do të zhgënjehet rëndë, nëse ka menduar që me ndihmën e vëllezërve të tij, do të arrijë të zëndonjë pozicion të mirë apo të arrijë ndonjë preferencë të caktuar në jetën e përditshme. Meqë jeta e brendshme e Odës mbi të gjitha është e fokusuar në edukimin mendor e shpirtëror të njeriut, që do të thotë në vetedukimin e tij, është një tipar i veçantë, që secili vëlla do të gjejë në Muratorinë e Lirë, vetë ato gjëra që i përshtaten personalitetit të tij. Muratoria e Lirë kërkon nga ai angazhim të lartë njerëzor dhe në anën tjetër i mundëson atij të perfeksionojë vetitë e tij. Përfitimi që merr secili anëtar i kësaj Lidhje, nuk është asnjë lloj përfitimi material, por në të shumtën e rasteve është një pasurim i mrekullueshëm i mendjes e shpirtit, një përfitim për shoqërinë e miqësinë që ka gjetur dhe për botëkuptimin e thellë që ka arritur për botën e për mjedisin që e rrethon. Që ta përsërisim edhe njëherë, se s'mund ta themi aq herë sa duhet thënë, Oda nuk të ndërmjetëson asnjë lloj besimi fetar, nuk përfaqëson asnjë parti politike, por vetëm ndihmon Kërkuesit në një lloj të veçantë të të jetuarit e të të menduarit. Ky lloj arti i veçantë shpresoj që t'ju jetë bërë deri diku i njohur nga përmbajtja e këtij libri dhe gjithashtu duhet të jemi të qartë se një mënyrë e tillë e të jetuarit e të menduarit është shumë e përshtatshme për të rregulluar e sistemuar marrëdhëniet, shpeshherë kaotike, në të cilat gjenden popujt dhe shtetet e planetit tonë. Megjithëse që të arrihet një diçka e tillë do të jetë i nevojshëm një bashkëpunim sa më i ngushtë i vëllezërve Muratorë, që gjithashtu duhet të guxojnë që të hedhin hapa edhe jashtë Odave të tyre.

---

Aktualisht ka probleme shumë të mëdha, të cilat mund të kapërcehen vetëm nëpërmjet një punë shumë të madhe e njëkohësisht intensive. I pari është padyshim dallimi i madh që ekziston në mes të të pasurve dhe të varfërve në të gjitha kontinentet e planetit tonë dhe gjithashtu e rëndësishme e njëkohësisht i rrezikshme – urrejtja racore – dhe e treta, mostoleranca ndërmjet religjioneve të mëdha botërore, që në shumë raste rezulton si maskë e përpjekjeve politike e ekonomike.

Vetëm nëse principet kryesore të vetedukimit dhe kërkesa “mos bëj keq kurrë” përdoren në jetën e përditshme të bashkësive shoqërive dhe njëkohësisht zbatohen me rigorozitet, vetëm atëherë mund të kishim sukses, që principet e Muratorëve të Lirë t’i bënim një maksimë të përgjithshme të shoqërive tona.

---

## Literaturë Ndhmëse

Nga një larmi e gjerë tekstesh mbi Muratorinë e Lirë autori rekomandon botimet e mëposhtme, që pjesë-pjesë i ka përdorur si burim informacioni për këtë libër.

Titujt e mposhtëm janë lënë në gjuhën origjinale pasi nuk ekzistojnë të përkthyer në gjuhën shqipe.

*Abafi* (Aigner), L.: Geschichte der Freimaurerei in Österreich-Ungarn, 5 Bände (Budapest 1890 – 1899)

*Adler*, M.: Die Sohne der Finsternis (Jestetten 1975)

*Appel*, R./Möller, D.: Was ist Freimaurerei? (Hamburg 1975)

*Baresh*, K.: Katholische Kirche und Freimaurerei (Wien 1983)

*Bauer*, W. (Hrsg.): Lexikon der Symbole (Wiesbaden 1985)

*Bauernjöpel*, J.: Freimaurerhandschrift aus dem 18 Jahrhundert (Faksimile-Ausgabe Graz 1986)

*Biedermann*, H.: Das verlorene Meisterwort (Graz/Wien/Köln 1986)

*Binder*, D.: Die Diskrete Gesellschaft (Graz/Wien/Köln 1988)

*Bokor*, Ch.v.: Winkelmass und Zirkel (Wien-München 1980)

*Dierickx*, M.: Freimaurerei – Die Grosse Unbekannte (Hamburg 1975)

*Frick*, K. R. H.: Die Erleuchteten (Graz 1973)

*Frick*, K. R. H.: Licht und Finsternis 2 Bände (Graz 1975/78)

*Hendrikson*, K. H.: Freimaurerische Lebenskunst (Stuttgart 1991)

*Holtorf*, J.: Die verschwiegene Bruderschaft (München 1983)

*Kataloge* der Freimaurer-Museen Rosenau und Bayreuth

*Kloss*, G.: Geschichte der Freimaurerei in England, Irland und Schottland (Leipzig 1848, Nachdruck Graz 1971)

*Kloss*, G.: Geschichte der Freimaurerei in Frankreich, 2 Bände (Darmstadt 1852-53, Nachdruck Graz 1971)

*Kosellek*, R.: Kritik und Krise. Eine Studie zur Pathogenese der bürgerlichen Welt.

*Kues*, G/ *Scheichelbauer*, B.: 200 Jahre Freimaurer in Österreich (Wien 1959)



- 
- Lachmann, H./ Schiffmann, G. A.:* Hochgrade der Freimaurer (Braunschweig 1866 und Leipzig 1878 und Leipzig 1882, Nachdruck von drei Werke in einem Band Graz 1974)
- Lennhoff, E.:* Die Freimaurer (Wien/München 1981, Nachdruck der Ausgabe von 1929)
- Lennhoff, E/ Posner, O.:* Internationale Freimaurer-Lexikon (Graz 1965, Nachdruck der Ausgabe von 1932)
- Lessing, G. E.:* Ernst und Falk – Gespräche für Freimaurer (Hamburg 1981)
- Lindner, D.:* Ignaz von Born – Meister der Wahren Eintracht (Wien 1986)
- Lindner, E. J.:* Die königliche Kunst im Bild (Graz 1976)
- Mellor, A.:* Logen – Rituale- Hochgrade (Graz 1976)
- Mellor, A.:* Unsere getrennten Brüder Die Freimaurer (Graz 1964)
- Miers, H. E.:* Lexikon des Geheimwissens (Augsburg 1986)
- Neuberger, H.:* Freimaurerei und Nationalsozialismus, 2 Bände (Hamburg 1980)
- Oberheide, J.:* Logenläser (Graz 1983)
- Reinalter, H.:* Freimaurer und Geheimbünde im 18 Jahrhundert in Mitteleuropa (Frankfurt 1983)
- Rogalla von Bieberstein, J.:* Die These von der jüdisch-freimaurerischen Weltverschwörung (Bern 1976)
- Rosenstrauch, E.:* Freimaurerei im Josephinischen Wien (Wien 1975)
- Scheichelbauer, B.:* Die Johannisfreimaurerei (Wien 1953)
- Valmy, M.:* Die Freimaurer (München 1988)
- Vogel, Th.:* Die ungeschriebenen Gesetze der Freimaurerei (Frankfurt/Main 1950)
- Zirkel und Winkelmass,* Katalog zur Ausstellung „200 Jahre Grosse Landesloge der Freimaurerei“ (Wien 1984)
- Zörrer/Klein/Gallop:* Bruder Wolfgang Amadeus Mozart, Katalog des österreichischen Freimaurermuseums, Schloss Rosenau, Sonderausstellung 1990/91)

---

Aleksandër Gize (Alexander Giese), nga 1975 deri 1986 Kryemjeshër i Kryeodës së Austrisë, që kurrë nuk e ka mbajtur sekret anëtarësinë e tij në Lidhjen e Muratorisë së Lirë, e përshkruan këtë Lidhje jo vetëm nga këndvështrimi pozitiv por edhe nga ai negativ. Muratoria e Lirë në historinë e saj 300 vjeçare ka tërhequr rreth vetes me miliona burra. Artistë, dijetarë, shkencëtarë, nëpunës, politikanë dhe filozofë kanë kontribuar në formimin e përmbajtjes shpirtërore e mendore të kësaj Lidhje. Ky libër nuk merret shumë me përshkrimin e historisë dhe formave organizuese të Muratorisë së Lirë, por e përqendron vëmendjen në produktin final të punës së saj, produkt që duhet kuptuar si mënyrë e të jetuarit dhe të menduarit. Ky libër i ofron lexuesit kuptimin dhe rëndësinë e Muratorisë së Lirë. Gjendja aktuale e raporteve tona globale, ka nevojë urgjente për virtytet e Muratorëve të Lirë, të cilat janë Humaniteti dhe Toleranca.